



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

RAPORT VJETOR

Gjëndja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2017

Tiranë, 2018

Përmbajtja

Fjala e Kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë.....	9
HYRJE	12
PJESA I: Rregullimi në Tregun e Energjisë Elektrike.....	17
1.1 Tregu i Energjisë Elektrike	18
1.2 Prodhimi i Energjisë Elektrike	22
1.2.1 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike	22
1.2.2 Realizimi i Treguesve të Prodhimit dhe Menaxhimi i Rezervës Hidrike.....	35
1.2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë.	37
1.2.4 Prodhimi nga HEC-et Private/Koncesion të Energjisë Elektrike.....	38
1.2.5 Eficienca e Prodhimit të Energjisë Elektrike	43
1.3 Transmetimi i Energjisë Elektrike	44
1.3.1 Veprimtaria e OST sh.a.....	44
1.3.2 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit	45
1.3.3 Bilanci i Energjisë Elektrike të Transmetuar nga OST sh.a.	48
1.4 Gjendja e Përgjithshme e Sistemit të Energjisë Elektrike referuar Nenit 25 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.	52
1.5 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.).....	70
1.6 Konsumi i Energjisë Elektrike	76
1.6.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike	80
1.6.2 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike	82
1.7 Blerjet e Energjisë Elektrike në Treg të Parregulluar	84
PJESA II: Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror.....	94
2.1 Projekti TAP (Trans Adriatic Pipeline).....	95
2.2 Ecuria e deritanishme e projektit TAP-AG në Shqipëri.....	97
2.3 Gjendja aktuale për projektin TAP në Shqipëri deri në fund të vitit 2017	98
2.3.1 Disa të dhëna për projektin TAP	98
2.4 Progresi i punimeve të projektit TAP gjatë vitit 2017	99
2.5 Ecuria e ndërtimit në Shqipëri deri në datën 1 Janar 2018.....	99
2.6 Disa të dhëna për Projektin TAP pjesa që kalon në det (offshore)	99
2.7 TAP-i si Projekt Strategjik për Shqipërinë dhe Europën Jug-Lindore	100
2.8 Përfitimet e Shqipërisë nga TAP	100
2.9 Investimet Mjedisore dhe Sociale (SEI) ne Shqiperi.....	101

2.10 Mbështetje të tjera në Shqipëri.....	101
2.11 Aspektet Rregullore për Projektin TAP.....	102
2.12 Bashkëpunimi dhe Përrjashtimi – Çështjet Kryesore.....	103
2.13 Bashkëpunimi me IAP dhe mundësia e koordinimit të dy projekteve tepër të rëndësishëm për zhvillimin e infrastrukturës në vëndin tonë	104
2.14 Memorandumi i Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit.....	105
2.15 Data e Planifikimit të Fillimit të TAP-it (PCD).....	107
2.16 Vendimet e marra për aktet nënligjore dhe aktet rregullore	110
2.16.1 Çertifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (Albgaz)	110
2.16.2 Metodologjia e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.	111
2.16.3 Pagesa e regjistrimit dhe proçedimit të një aplikimi.	112
2.16.4 Rregullore për trajtimi e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licënuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.....	113
2.16.5 Rregullore për organizimin, funksionimin dhe proçedurat e ERE-s.....	113
2.16.6 Rregullore për mbrojtjen e informacionit konfidencial	113
2.16.7 Rregullore për proçedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror	113
2.16.8 Rregullore e proçedurave të transferimit të asetëve nga të licënuarit.....	114
2.16.9 Rregullat për çertifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror ...	114
2.16.10 Rregullore e proçedurave të paraqitjes së planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shërndarjes së gazit natyror.	115
2.16.11 Udhëzim mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror	115
2.16.12 Rregullore mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë.	116
2.16.13 Rregullore për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror.....	116
2.16.14 Rregullore mbi kushtet dhe proçedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje.	116
2.16.15 Licensë tip e aktiviteti të shpërndarjes së gazit natyror	117
2.16.16 Licensë tip e aktivitetit të transmetimit të gazit natyror	117
2.16.17 Liçensa e furnizimit të gazit natyror.....	117
2.16.18 Licensë tip e aktiviteti të tregtimit të gazit natyror	118
2.17 Metodologjia e Tarifave të Gazit Natyror për TAP AG.....	118
2.18 Metodologjia e Tarifave të Gazit Natyror për Albgaz (OST/OSHT)	119
2.19 Kodi i Rrjetit të TAP AG dhe Kodi i Rrjetit të Albgaz.....	119

2.20	Vëmëndjet kryesore që janë për sektorin e Gazit Natyror.....	120
2.21	Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare	121
PJESA III: Aktiviteti i Entit Rregullator të Energjisë		122
3.1	Mbi realizimin e detyrave të ERE-s për vitin 2017. (Rezoluta e Kuvendit)	123
3.2	Licencimi dhe Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike	131
3.2.1	Licencimet dhe Kërkesat e Trajtuarra gjatë Vitit 2017.....	131
3.3	Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike	133
3.3.1	Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike.	133
3.3.2	Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OSHEE sh.a.....	135
3.3.3	Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OST sh.a.	138
3.4	Aktiviteti i ERE-s në fushën e rregullimit të Tarifave dhe Çmimeve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror.....	143
3.4.1	Shtyrja e fuqisë juridike deri në 31.12.2017 të Vendimeve Nr .139, Nr. 145, Nr.146, Nr. 147, Nr. 148 datë 26.12.2014 dhe Vendimit Nr.128 datë 9.07.2016 të Bordit të ERE-s.	144
3.4.2	Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a.	147
3.4.3	Lënia në fuqi e Vendimit Nr.52 datë 06.04.2017 të Bordit të ERE-s”, mbi çmimet me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018	147
3.4.4	Prodhuesit me përparësi të energjise elektrike dhe impakti i tyre	149
3.4.5	Çmimi i përditësuar i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2017.	153
3.4.6	Çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet që shfrytëzojnë burimet e rinovueshme nga dielli dhe era për vitin 2017.	154
3.4.7	Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2018.	156
3.4.8	Miratimi i tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017	156
3.4.9	Lënia në fuqi e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror deri më 31.12.2017	157
3.4.10	Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite	158
3.4.11	Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, për vitin 2017	160
3.5	Puna e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit gjatë Vitit 2017.	162
3.5.1	Aktiviteti i ERE-s në zhvillimin e legjislacionit sekondar dhe ndryshimet e tjera ligjore të ndodhura gjatë vitit 2017	162
3.5.2	Legjislacioni sekondar i miratuar përgjatë vitit 2017	163
3.5.3	Kontrata/Marrëveshje tip të miratuara përgjatë vitit 2017.....	169
3.5.4	Vendimmarrje të tjera të ERE-s përgjatë vitit 2017	169

3.5.5 Vendime për të cilat është kërkuar rishikimi përgjatë vitit 2017	170
3.6 Proceset gjyqësore në të cilat ERE ka qenë palë gjatë vitit 2017	172
3.6.1 ERE në cilësinë e palës së paditur	172
3.6.2 Proceset Gjyqësore në të cilat ERE ka qenë palë e tretë gjatë vitit 2017.	174
3.7 Zhvillimi i seancave dëgjimore në ERE.....	175
3.8 Korrespondencat e trajtuara gjatë vitit 2017	175
3.8.1 Komunikime me Pjesëtarët e Tregut.	176
3.8.2 Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit.	176
3.9 Veprimtaria e ERE-s në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit.....	176
3.9.1 Ankesat për “Energji të pamatur“.....	178
3.9.2 Ankesat për mbifaturimin e energjisë elektrike.	179
3.9.3 Ankesat për “faturim aforfe”.	179
3.9.4 Faturimi i energjisë elektrike për “matje jashtë kushteve teknike”.	179
3.9.5 Ankesat mbi “kontratat fiktive“ dhe “faturimin fiktiv“.....	179
3.9.6 Ankesa “të ndryshme”.	180
3.9.7 Ankesa për “vlera referuese”	180
3.9.8 Përgjigje të ardhura nga OSHEE sh.a gjatë vitit 2017.	180
PJESA IV: Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s.....	182
4.1 Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s	184
Shtojca 1 Auditimi i Pasqyrave Financiare.....	185
Shtojca 2 Plan i Veprimeve 2018	203
Shtojca 3 Regjistri i Vendimeve të ERE-s për Vitin 2017	205

Tabela e Figurave

Figure 1 Organograma e ERE-s 2017	16
Figure 2 Skema e Fluksit të Energjisë Elektrike dhe Tregtare	19
Figure 3 Skema e Sistemit Elektroenergjetik (Burimi: ERE)	20
Figure 4 Skema Teknike e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar	21
Figure 5 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.).....	22
Figure 6 Prodhimi neto i të gjitha centraleve prodhuese gjatë vitit 2017 (MWh)	26
Figure 7 Prodhimi neto vendas për vitin 2017.....	26
Figure 8 Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2017 (MWh)	27
Figure 9 Prodhimi vendas për vitin 2017 krahasuar me periudhën 2007-2016	27
Figure 10 Prodhimi neto vendas për periudhën 2007-2017.....	28
Figure 11 Prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë për periudhën 1985 – 2017 (Burimi: OST sha, OSHEE sha)	28
Figure 12 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: OST sh.a.).....	29
Figure 13 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2017 (Burimi: KESH sh.a. , OST sh.a.)	30
Figure 14 Derdhjet nga HEC-et e KESH sha gjatë vitit 2017.....	30
Figure 15 Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2017) (Burimi: OST sh.a.)	31
Figure 16 Nivelin (m) i Liqenit të HEC të Fierzës gjatë vitit 2017. (Burimi OST sha, KESH sha).....	31
Figure 17 Nivelin i liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2017.	32
Figure 18 Nivelin (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2017.	33
Figure 19 Prurjet mesatare mujore (m ³ /sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2017 krahasuar me mesataren historike.	33
Figure 20 Rezerva Energjetike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2017 (Burimi: OST).....	34
Figure 21 Treguesit e Centraleve.....	37
Figure 22 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et Private/Koncesion për vitin 2017 (Burimi: OSHEE sh.a, OST sh.a.)	40
Figure 23 Prodhimi nga HEC –et që kanë filluar prodhimin gjatë 2017.....	42
Figure 24 Ecuria e Prodhimit nga HEC-et prodhues me përparësi (Burimi: ERE).	42
Figure 25 Të ardhurat e realizuara nga shitjet e prodhuesve me përparësi (Burimi: OSHEE sh.a).....	43
Figure 26 Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë.....	46
Figure 27 Sistemi i Transmetimit Shqiptar.....	47
Figure 28 Asetet kryesore të Sistemit të Transmetimit	48
Figure 29 Bilanci Energjetik i OST sh.a për vitin 2017 krahasuar me atë të vitit 2015,2016 (GWh).	49
Figure 30 Situata e Investimeve.....	50

Figure 31 Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2017	71
Figure 32 Sasia në Furnizim, Shitje dhe humbje të Energjisë Elektrike në Rajonet dhe Agjensite e Rrjetit të Shpërndarjes (Burimi: OSHEE sh.a).	72
Figure 33 Shpërndarja e Numrit të Klientëve	73
Figure 34 Të dhëna mbi asetet kryesore të OSHEE (Burimi: OSHEE).	74
Figure 35 Të dhënat mbi treguesit e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes gjatë vitit 2017.	75
Figure 36 Konsumi i përgjithshëm në vite.	76
Figure 37 Treguesit nga operatorët kryesorë të sistemit energjetik në Shqipëri 2017.	77
Figure 38 Bilanci Energjetik viti 2017.....	78
Figure 39 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës Import-Eksport në konsumin total të energjisë në Shqipëri.	79
Figure 40 Raportet e Faturimit sipas Kategorive të klientëve 2017.	80
Figure 41 Klientet Familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite.....	81
Figure 42 Konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2017.....	82
Figure 43 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2017.....	83
Figure 44 Profili dhe minimumi i ngarkesës në prill 2017 (MW)	83
Figure 45 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite (Burimi: OST sh.a.).ktiviteti i Shitjes së Energjisë Elektrike nga OSHEE sha	85
Figure 46 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2017.....	87
Figure 47 Niveli i Arkëtimeve Mujore në periudhën 2011-2017.	88
Figure 48 Ecuria treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatortit të Shpërndarjes (%)	89
Figure 49 Efektiviteti i shitjeve të OSHEE 2009-2017 (Burim: OSHEE).....	90
Figure 50 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjetik.....	91
Figure 51 Faturimi/Arkëtimi 2002-2017 me TVSH (Burimi: OSHEE sh.a.).....	91
Figure 52 Pasqyrimi i Statistikave botërore për Energjinë 2017.....	95
Figure 53 Projekti TAP dhe IAP	97
Figure 54 Korridori Jugor i Gazit (SGC) dhe projekti IAP	106
Figure 55 PROJEKTI- SCP-TANAP-TAP	106
Figure 56 Masterplani i Gazit.....	109
Figure 57 Disbalancat totale për vitin 2017 (MWh)	139
Figure 58 Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2017.....	141
Figure 59 Ecuria e kapitalit të vet për OSHEE sh.a (Burimi OSHEE sh.a).....	146
Figure 60 Prodhimi vjetor i Prodhuesve me Përparësi & HEC Ashta (MWh).....	150
Figure 61 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi (Burimi OSHEE sh.a.).....	150
Figure 62 Ecuria e çmimeve të miratuara për prodhuesit me përparësi	151

Figure 63 Peshat specifikat e prodhimit te prodhuesve me përparësi nga konsumit total (Burimi OST sh.a OSHEE sh.a ERE).....	151
Figure 64 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. (Burimi OSHEE sh.a.,ERE)	152
Figure 65 Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008-3M 2018.....	158
Figure 66 Çmimi mesatar i realizuar (Burimi ERE, OSHEE)	159
Figure 67 Çmimi i realizuar per kategorite e klienteve (Burimi ERE, OSHEE)	160
Figure 68 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo-familjar në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit ERRA për vitin 2017	161
Figure 69 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjar në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit ERRA për vitin 2017	161
Figure 70 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2017.....	178

Fjala e Kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë,

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Deputet,

Në emër të Entit Rregullator të Energjisë, ju paraqes Raportin Vjetor për aktivitetin e këtij institucioni gjatë vitit 2017 në fushën e rregullimit të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në vendin tonë.

Në këtë raport paraqitet në mënyrë të detajuar puna dhe aktiviteti i Entit Rregullator si dhe ofrohet një informacion i përditësuar mbi zbatimin e legjislacionit në fushën e energjisë dhe gazit natyror.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet realizimit të detyrave dhe objektivave të shprehura në rezolutën e Kuvendit për veperimtarinë e ERE gjatë vitit 2016.

Enti Rregullator përmes Bordit dhe personelit teknik, ka ushtruar autoritetin në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat sipas ligjeve që rregullojnë përkatësisht sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

Aktualisht Enti Rregullator i Energjisë (ERE) aktivitetin e tij rregullator e mbështet në Ligjin nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Ky institucion është në varësi të parlamentit shqiptar dhe ka pavarësi të plotë financiare nga buxheti i shtetit. Veç kësaj me shumë rëndësi në vazhdimësi është realizimi i pavarësisë organizative dhe funksionale të institucionit, e cila do të rrisi më shumë kërkesën për një kualifikim më të lartë profesional dhe përgjegjshmëri më të madhe në vendimmarrje.

Raporti jep një pasqyrë të plotë dhe të detajuar mbi gjëndjen në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në vendin tonë. Gjithashtu në përmbajtjen e tij jepet një informacion i plotë dhe i detajuar mbi aktivitetin e shoqërive të cilat operojnë në sektorin e energjisë elektrike dhe ato që operojnë në sektorin e gazit natyror.

Gjatë vitit 2017 sektori i energjisë demostroi një qëndrueshmëri në aktivitetin e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike duke mbajtur dhe ruajtur parametra optimal operimi fizik dhe rezultate shumë të mira financiare. Po ashtu dhe sektori i gazit natyror pati zhvillime të kënaqshme në strukturimin e tij dhe funksionimin normal.

Në Raportet Vjetore të Implementim-it të përgatitur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në pjesën Shqipëria -Konkluzione, ky organizëm ndër te tjera ka theksuar prioritet kyç për ERE si me poshtë:

Zgjerimi më tej i përgjegjësiave dhe kompetencave të Rregullatorit në kuadër të implemtimit të objektivave dhe parimeve të përcaktuara në Paketën e Tretë të Energjisë;

ERE duhet të forcojë më shumë pavarësinë e saj;

Pagat e stafit të ERE-s duhet ti korrespondojnë niveleve të pagave të kompanive të rregulluara dhe duhet të përcaktohet totalisht nga vet Rregullatorit.

Finalizimi i procesit të miratimit të ndryshimeve të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, përbën një hap të domosdoshëm për qëllimet e implementimit të pavarësisë financiare, e për të cilën do të vlerësonim me shumë rëndësi mbështetjen e mëtejshme të Kuvendit.

Duke konsideruar zhvillimet në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në përputhje me kërkesa më kualitative të cilat përputhen plotësisht me ato të bashkimit europian ku ndër të tjera ERE të zhvillohet si një institucion i pavarur me kapacitete të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme për tu përballur me sfidat e sektorit, është me rëndësi rishikimi i strukturës organizative të ERE-es, si dhe pavarësia operationale e stafit të saj.

Si një insitucion i krijuar me ligj, dhe në përputhje me besimin e dhënë nga organi më i lartë legjistaltiv, jemi përkushtuar në misionin tonë për të siguruar që shërbimet e rregulluara të ofrojnë shërbime të sigurta dhe të besueshme bazuar në kosto të drejta dhe të arsyeshme.

Në përmbushjen e misionit tonë, ne ushtorjmë veprimtarinë në një mënyrë të hapur dhe transparente duke synuar ekuilibrimin e interesave të konsumatorëve, shtetit dhe investitorëve në sektorët që ERE rregullon.

Për vitin e ardhshëm, objektivat e ERE-s janë orientuar në përputhje me sfidat që lidhen me vijimin e punës për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, ngritjes dhe bërjes efektive të bursës së energjisë, realizimi i mekanizmave të parashikura në kaudër të nismave rajonale konkretisht Western Balkans 6 (WB6).

Vitet e fundit siç edhe kemi raportuar më parë janë kryer një sërë investimesh me rëndësi për rrjetin e amortizuar kryesisht të shpërndarjes. Edhe

për vitin në vijim ERE do të ndjek me prioritet procesin që lidhet me shqyrtimin dhe miratimin e planit të investimeve në operatorët kryesorë, atë të shpërndarjes dhe në operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Në thelb të këtij procesi qëndron planifikimi me kujdes i investimeve të orientuara në uljen e kostove, në identifikimin e pjesëve të sistemit ku ndërhyrja është më e nevojshme për të vijuar me segmentet e tjera që lidhen edhe me kërkesat për një sistem të integruar në tregun rajonal.

Një nga prioritetet e ERE-s për vitin që mbyllëm por edhe në vijim mbetet reflektimi në legjislacionin aktual rregullator të ndryshimeve të cilat do të jenë në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Europian në fushën e energjisë. Kjo do të bëjë të mundur krijimin e një tregu konkurrues, eficient, që rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në vend dhe e integron atë në tregun rajonal.

Për këtë qëllim ERE ka vendosur një bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë, Ministrinë Përgjegjëse për Energjinë, dhe Autoritetin e Konkurrencës lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator në sektorin e energjisë, si dhe për çështje të tjera të rëndësishme të këtij sektori.

Në përfundim duke falenderuar të gjithë institucionet, organizmat me të cilat ERE bashkëpunon, shpresojmë që ky Raport Vjetor të shërbejë si një informacion i dobishëm, dhe i qartë i të dhënave jo vetëm për institucionin e Kuvendit, por edhe për të gjithë institucionet, organizmat, investitorët, konsumatorët dhe çdo person të interesuar në tregun e energjisë.

Duke ju falenderuar,

Kryetari

Petrit Ahmeti

HYRJE

Në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Enti Rregullator i Energjisë ka përgjegjësinë për të përgatitur dhe paraqitur në Kuvend çdo vit raportin mbi situatën e sektorit të energjisë dhe veprimtaritë e ERE-s për vitin paraardhës.

Përveç raportit vjetor dhe raportit financiar të rregullatorit, ky dokument gjithashtu përfshin raportin mbi gjendjen në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të Republikës së Shqipërisë në fushat apo çështjet nën juridiksionin e ERE-s.

Raporti për sektorin energjetik në Shqipëri përfshin një pasqyrim të situatës dhe aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, tregjet përkatëse, sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe gaz natyror, mbrojtjen e konsumatorëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Sa i përket strukturës dhe përmbajtjes, Raporti është gjithashtu në përputhje me përcaktimet e ligjeve të cituara më sipër si dhe me rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në përputhje me ligjet, të gjitha vendimet brenda kompetencës së Entit, miratohen nga Bordi i ERE-s. Në vitin 2017, Bordi ka marrë 214 vendime në 34 mbledhje të zhvilluara në përputhje me rregullat e organizimit të ERE-s. Këto vendime kanë qenë produkt i analizave gjatë trajtimit të çështjeve të tilla si në fushën e rregullimit të çmimeve, miratimit të rregulloreve për plotësimin e kuadrit rregullator, kërkesat për licencim, çertifikimin e OST dhe Alb gaz, si dhe çështje të tjera brenda juridiksionit të ERE-s.

Në vitin 2017, ERE vijoi të përmbush obligimet e saj që rrjedhin nga Ligji të cilat janë relevante për zbatimin e ligjit, dhe funksionimin e tregut të energjisë dhe gjithashtu ka luajtur rol mbështetës për institucionet e tjera në aktivitetet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Siguria e furnizimit me energji elektrike në vitin 2017 ka qenë në qendër të fokusit të punës të ERE-s dhe operatorëve që sigurojnë shërbimet publike në sektor. Kapacitetet energjetike vendase kanë kontribuar në sigurimin e furnizimit me energji elektrike, ndërsa për qëllime të sigurimit të furnizimit është siguruar gjithashtu energji nga blerjet e OSHEE në treg të parregulluar.

Konsumi total i energjisë elektrike për vitin 2017 është rritur me rreth 4.9 % krahasuar me vitin 2016. Konsumi i klientëve familjarë u rrit me rreth 2.6 %.

Në tregun e hapur, me çmimet e tregut, janë blerë rreth 39.6 % të energjisë elektrike të konsumuar në vend.

Së fundmi përmes plotësimit të kuadrit nënligjor dhe investimeve në sistemin e matjes është bërë e mundur shkëputja nga tregu i rregulluar i klientëve të lidhur në rrjetin 35kV. Është shumë e rëndësishme për të vijuar prokurimin dhe instalimin e pajisjeve matëse adekuate për liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike edhe për klientët e lidhur në nivele më të ulta tensioni.

OST sh.a ka vazhduar aktivitetin e saj duke synuar zhvillimin e sistemit dhe forcimin e kapaciteteve ndërkufitare dhe pjesëmarrjen në ankandet e koordinuara të kapaciteteve ndërkufitare sipas SEE CAO.

Në vitin 2017, treguesit teknik të cilësisë së furnizimit me energji elektrike u përmirësuan më tej.

Sa i takon çmimeve të energjisë elektrike në vitin 2017, referuar vendimit të ERE-s, janë ruajtur të pandryshuara çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor.

Këto vendime reflektonin nevojën për të siguruar një nivel të arsyetuar të shpërndarjes së kostove të energjisë elektrike dhe pagesat e përdorimit të sistemit, që të sigurojnë fonde të nevojshme për investime në kompanitë ekzistuese të energjisë, të nxisin investitorët dhe inkurajojnë një rritje në efikasitetin e energjisë.

Zhvillimi i tregut të gazit është kusht i rëndësishëm për të garantuar sigurinë afatgjatë të furnizimit me gaz natyror dhe diversifikimin e burimeve në vend.

Gjatë vitit 2017 është realizuar ndarja ligjore dhe pronësore e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe është punuar për të finalizuar edhe ndarjen ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjise Elektrike nga ai i Furnizimit të Shërbimit Universal. Ndarje e realizuar së fundmi me themelimin e tre shoqërive aksionere : Furnizuesi I Shërbimit Universal sh.a, Furnizuesi i Tregut të Lirë, sh.a dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

Zhvillimi i tregut të gazit është gjithashtu një nga sfidat e sektorit. Tubacioni i gazsjellësit TAP AG është projekti më i rëndësishëm për të cilin ka vijuar puna e ERE-s në bashkëpunim me dy rregullatorët Italian dhe Grek, vende ku ky gazsjellës kalon.

Me kryerjen e certifikimit të operatoreve të transmetimit në sektorët respektive, me po aq rëndësi është edhe monitorimi i vazhdueshëm i këtyre operatorëve për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga statusi i operatorit të certifikuar. Për këtë qëllim është vendosur nga ERE raportim periodik i operatorëve për implementimin e vendimeve të certifikimit.

Aktualisht në zbatim të detyrimeve që burojnë nga Traktati i Komunitetit të Energjisë jemi fokusuar në implementimin e Vendimeve të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë (PHLG) të Komunitetit të Energjisë, që kanë të bëjnë me kushtet për akses në rrjetet e transmetimit të gazit natyror, mbi përshtatjen e Rregullores së Komisionit (BE) nr. 2015/703 për krijimin e Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, mbi krijimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen në rrjet të gjeneruesve, mbi krijimin e kodit të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen në rrjet të sistemeve direkte të tensionit të lartë dhe moduleve të njësisve elektroenergetike të lidhur direkt si dhe mbi Kërkesat për Lidhje.

Nga EnC kërkohet që Rregulloret e përshtatura të transpozohen pa ndryshime në strukturë në mënyrë që ato të përputhen me Vendimet e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë (PHLG). Këto vendime do të plotësojnë më tej kuadrin rregullator në sektorin e energjisë elektrike

dhe gazit natyror. Paralelisht aktiviteti gjatë vitit 2017 dhe në vijim përgjatë 2018 do të fokusohet në implementimin e mekanizmave të WB6 përfshirë ndarjen e OST dhe ndarjen e operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike, tregu i ditës në avancë.

Ndryshimet e miratuara në Ligjin për Sektorin e Energjisë janë një hap i rëndësishëm që vendos bazat për themelimin e Bursës së energjisë elektrike shqiptare si shoqëri anonime e operatorit të sistemit të transmetimit (OST) dhe personave të tjerë juridikë.

Bordi i ERE-s

Bordi i ERE-s, në bazë të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ERE-s. Bordi i ERE-s përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar.

Gjatë vitit 2017 kanë ushtruar detyrën si anëtarë të Bordit të ERE-s:

Z. Petrit Ahmeti.....Kryetar

Zj. Entela Shehaj.....Anëtare

Z. Adriatik Bego.....Anëtar

Z. Maksim Shuli.....Anëtar

Z. Abaz Aliko.....Anëtar

Për sa përcahet në legjislacionin në fuqi në këtë raport Bordi edhe për vitin 2017 është mbështetur në punën e tij nga Këshilltari, Sekretari i Bordit dhe një personel teknik të organizuar në 4 drejtori si vijon:

Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut, me 7 punonjës.

Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me 5 punonjës

Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave të Energjisë Elektrike, me 5 punonjës.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrim Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë, me 8 punonjës.

Gjatë vitit 2017 sikurse edhe më parë është synuar forcimi i kapaciteteve administrative të ERE-s përmes kualifikimeve të ndryshme të mbështetura nga rregullatori dhe nga organizmat ndërkombëtare të tillë si:

ERRA - Energy Regulators Regional Association

ENC - Energy Community Secretariat

USAID - United States Agency for International Development

MEDREG - Mediterranean Energy Regulators

WB - World Bank

AEEG - Autorità per l'Energia Elettrica, il Gas ed i Servizi idrici in Italia

Organograma e ERE-s

Funksionimi i ERE dhe bashkërendimi i strukturave përbërëse të saj bëhet konform organogramës së mëposhtme.




Figure 1 Organograma e ERE-s 2017

PJESA I: Rregullimi në Tregun e Energjisë Elektrike

1.1 Tregu i Energjisë Elektrike

Për vitin 2017, Tregu i Energjisë Elektrike ka funksionuar bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016 i ndryshuar “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike. Për sa përçaktuar nga Këshilli i Ministrave ky vendim ka shërbyer si Model i Përkohshëm Tregu deri në zbatueshmërinë e VKM Nr.519 dt 13.07. 2016 “Për Miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”.Veç të tjerash, ky model, ka përçaktuar pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri (TEE), si dhe rolin dhe përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në treg të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë me qëllim reflektimin e kërkesave të këtij ligji ka vijuar punën për të miratuar aktet rregullatore nënligjore në zbatim të tij.

Për sa parashikuar në nenin 98 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe në VKM Nr.244 datë 30.03.2016 të ndryshuar, Operatori i Sistemit të Transmetimit ka propozuar në harmoni me Modelin e Tregut të Përkohshëm, Rregullat e Përkohshme të Tregut miratuar nga ERE me Vendimin Nr.139, datë 15.08.2016, të ndryshuar.

Gjithashtu, me Vendimin e ERE-s Nr.193, datë 27.11.2017 janë miratuar "Rregullat e përkohshme për mekanizimin balanues të energjisë elektrike", të cilat japin zgjidhje të pranueshme nga të gjitha palët përgjegjëse për balancimin dhe pjesëmarrësit e tregut në trajtimin e balancimit të sistemit elektro-energjitik Shqiptar.

Janë hedhur hapa konkrete për liberalizimin e Tregut të energjisë elektrike sa i përket krijimit të kushteve teknike dhe të kuadrit nënligjor e rregullator për daljen në treg të hapur edhe për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Po ashtu, gjatë vitit 2017, ERE ka certifikuar OST sha si operator të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike dhe ALBGAZ sha si Operator të Kombinuar të gazit natyror.

Me vendimin Nr.519 datë 13.07.2016, Këshilli i Ministrave në zbatim të nenit 97/3 të këtij ligji ka miratuar Modelin e Tregut në bazë të të cilit ,ERE me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 214 dt.28.12.2017 ka miratuar “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe marrëveshja e pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë”, të cilat me ndryshimet e fundit të Ligjit të Sektorit të Energjisë Elektrike krijon bazën e duhur ligjore për operimin e Bursës së Energjisë Elektrike në Shqipëri.

Në figurat në vijim paraqiten Skema e Fluksit të Energjisë Elektrike dhe Tregtare si dhe Skema e Sistemit Elektroenergetik Shqiptar.




Figure 2 Skema e Fluksit të Energjisë Elektrike dhe Tregtare

(Burimi: ERE Ligji Nr.43/2015 VKM Nr. 244, datë 30.03.2016 i ndryshuar)

SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK




Figure 3 Skema e Sistemit Elektroenergjetik (Burimi: ERE)

SKEMA TEKNIKE E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK SHQIPTAR




Figure 4 Skema Teknike e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar

1.2 Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike nga shoqëritë prodhuese realizohet si një aktivitet i licensuar nga ERE, në bazë të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

KESH sh.a, është shoqëria më e madhe prodhuese në Shqipëri me kapital tërësisht shtetëror e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik sipas VKM Nr.244 datë 30.03.2016, e cila për vitin 2017 ka shfrytëzuar hidrocentralet ekzistuese të kaskadës së lumit Drin.

Shoqëritë e tjera (Private/me Koncesion) prodhuese paraqiten në tabelat e mëposhtme shoqëruar me treguesit përkatës. Këto subjekte të licencuara në vite nga ERE shfrytëzojnë centralet ekzistuese, apo dhe të reja kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit të nënshkruara me Qeverinë Shqiptare dhe, një pjesë e vogël, shfrytëzojnë centrale deri në 2 MW, të privatizuar në kuadër të Ligjit Nr. 8527, datë 23.09.1999. Një numër i konsiderueshëm i shoqërive prodhuese është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes.

1.2.1 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga shoqëria aksionere KESH sh.a. me 100% të aksioneve shtetërore.

Përbërja e grupit të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a dhe fuqia e instaluar e secilit prej tyre, të cilët realizojnë prodhimin publik është paraqitur në tabelë. Fuqia e përgjithshme e instaluar arrin në 1,448 MW, nga të cilat fuqia e instaluar e HEC-ve është 1,350 MW dhe e TEC Vlorë 98 MW.

Karakteristikat e Centralit	Centralet Prodhuese Publike			
	HEC Fierzë	HEC Koman	HEC V.Dejës	TEC Vlorë
Nr. Agregateve.	4	4	5	2
Fuqia e Agregateve. MW	125	150	50	70+28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	98
Fuqia Totale MW	1 448			

Figure 5 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.)

Duke marrë parasysh edhe fuqinë e përgjithshme të instaluar të prodhuesve privat/koncesionar të energjisë elektrike prej 697 MW, fuqia e përgjithshme e instaluar (e licensuar) në vendin tonë rezulton 2,145 MW.

Prodhimi neto publik i energjisë elektrike në vitin 2017 u realizua 100% nga hidrocentralet (HEC-et).

Prodhimi neto vendas prej **4,525,173** MWh u realizua:

2,916,989 MWh nga centralet prodhuese hidro të KESH sh.a (prodhimi publik)
1,608,184 MWh nga centralet prodhuese hidro të tjerë.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2017 është rreth **1,917 MW** dhe prodhimi neto i tyre është **4,051,512 MWh**.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes (35,20,10,6 kV) gjatë vitit 2017 është rreth **228 MW** dhe prodhimi neto i tyre është **471,751 MWh**.

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna të gjithë centraleve, shoqërive, kapacitetit të instalimit në licensim dhe prodhimin neto për vitin 2017 të marra nga të dhënat e OST sh.a..

PRODHIMI GJATE VITIT 2017 NGA CENTRALET E LIDHURA NE RRJETIN E TRANSMETIMIT (MWh)				
HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2017
Hec "Fierze" me fuqi 500 MW	500.000	"KESH" sha	220 kV	872,472
Hec "Koman" me fuqi 600 MW	600.000		220 kV	1,363,759
Hec "V. Dejes" me fuqi 250 MW	250.000		220 kV	680,759
Tec Vlora me fuqi 97 MW	97.000	"KESH" sha	220 kV	-1,908
Hec "Ulez" me fuqi 25,2 MW	25.200	"Kurum International" sh.a.	110 kV	286,579
Hec "Shkopet" me fuqi 24 MW	24.000		110 kV	
Hec "Bistrica 1" me fuqi 22,5Mw	22.500		110 kV	
Hec "Bistrica 2" me fuqi 5 Mw	5.000		110 kV	
Hec "Ashta" me fuqi 48,2 MW	48.200	"Energji Ashta" shpk	110 kV	174,526
Hec "Peshqesh" me fuqi 27,94 MW; ,	27.940	"Ayen As Energji" sha	220 kV	79,578
Hec "Fangu" me fuqi 74.6 MW; ,	74.600		220 kV	47,048
Hec "Banje" me fuqi 73 MW	73.000	"Devoll Hydropower" sha	110 kV	140,866
Hec "Bishnica 2" me fuqi 2.5 MW	2.500	"HEC Bishnica 1,2 "shpk	110 kV	8,165
Hec "Dardhe" me fuqi 5,8 MW	5.800	"Wenerg " shpk	110 kV	11,329
Hec "Truen" me fuqi 2,5 MW	2.500	"TRUEN" shpk	110 kV	
Hec "Ternove" me fuqi 8.385 Mw	0.921	"TEODORI 2003" shpk	110 kV	3,304
Hec "Gjorice" me fuqi 4.18 Mw (+h/c ne prodhim)	29.610	"DITEKO" shpk	110 kV	67,253
Hec "Sllabinje" me fuqi 13,8 MW	13.800	"Power Elektrik Slabinje" shpk	110 kV	28,992
Hec "Bele 1" me fuqi 5 MW ;	5.000	"Euron Energy" shpk	110 kV	116,010
Hec "TopoJan 2" me fuqi 5,8 MW,	5.800			
Hec "Bele 2" me fuqi 11 MW ;	11.000	"Alb-Energy" shpk		
Hec "TopoJan 1" me fuqi 2,9 MW,	2.900	"Energjal" shpk		
Hec "Orgjost I Ri" me fuqi 4,8 MW	4.800			
Hec "Klos" me fuqi 2.6 MW;		"Energy partners Al" shpk	110 kV	13,075
Hec "Shkalle" me fuqi 1.3 MW;				
Hec "Cerunje-1" me fuqi 2.3 MW;	2.300			
Hec "Cerunje-2" me fuqi 2.8 MW;	2.800			
Hec "Rrupe" me fuqi 3.6 MW;	3.600			
Hec "Rapuni 1,2" me fuqi 4 dhe 4.1 MW	8.100	"C & S Construction Energy" shpk	110 kV	24,368
Hec "Rapuni 3,4" me fuqi 8.857 MW	8.850	"C & S Energy" shpk	110 kV	22,735
Hec "Llapaj" me fuqi 13.62 MW	13.620	"Gjo.Spa.POWER" shpk	110 kV	35,456
Hec "Lengarice" me fuqi 8.94 MW	8.940	"Lengarica & Energy" shpk	110 kV	12,165
Hec "Lura 1" me fuqi 6,54 MW	6.540	"Erdat Lura" shpk	110 kV	29,183
Hec "Lura 2" me fuqi 4,02 MW	4.020		110 kV	
Hec "Lura 3" me fuqi 5,66 MW	5.660		110 kV	
Hec "Malla" me fuqi 5.455 MW	5.455	"Gjure Rec" shpk	110 kV	11,002
Hec Prella me fuqi 14.97 MW	14.970	"Prella Energji"	110 kV	24,795
	1,917			4,051,512

PRODHIMI GJATE VITIT 2017 NGA CENTRALET E LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)				
HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2017
Hec "Lanabregas" me fuqi 5 MW	5.000	"Hec Lanabregas" sha	35	31,725
Hec "Lenie" me fuqi 400 kW	0.400	"EMIKEL 2003" sh.p.k	10kV	2,307
Hec "Çorovode" me fuqi 200 kW	0.200		10kV	563
Hec "Smokthine" me fuqi 9,2 MW	9.200	"Albania Green Energy" sh.p.k	35 kV	22,650
Hec "Bulqize" me fuqi 0,6 MW (Diber)	0.600	"Balkan Green Energy" shpk	10kV	1,336
Hec "Homesh" me fuqi 0,395 MW (Diber)	0.395		10kV	334
Hec "Zerqan" me fuqi 0,625 MW (Diber)	0.625		6kV	933
Hec "Arras" me fuqi 4,8 MW (Diber)	4.800		20kV	10,258
Hec "Orgjost" me fuqi 1,2 MW (Kukes)	1.200		10kV	4,771
Hec "Lekbibaj" me fuqi 1,4 MW (Tropoje)	1.400		10kV	4,654
Hec "Dukagjin" me fuqi 0,64 MW (Shkoder)	0.640		10kV	2,208
Hec "Marjan" me fuqi 0,2 MW (Korce)	0.200		10kV	489
Hec "Lozhan" me fuqi 0,1 MW (Korce)	0.100		10kV	0
Hec "Barmash" me fuqi 0,83 MW (Kolonje)	0.830		10kV	613
Hec "Treske 2" me fuqi 0,25 MW (Korce)	0.250		10kV	464
Hec "Nikolice" me fuqi 0,7 MW (Korce)	0.700		10kV	1,506
Hec "Funares" me fuqi 1,92 MW (Librazhd)	1.920		10kV	4,333
Hec "Lunik" me fuqi 0,2 MW (Librazhd)	0.200		10kV	574
Hec "Kerpice" me fuqi 0,42 MW (Gramsh)	0.420		6kV	576
Hec "Ujanik" me fuqi 0,63 MW (Skrapar)	0.630		10kV	746
Hec "Borsh" me fuqi 0,25 MW (Sarande)	0.250		6kV	478
Hec "Leshnice" me fuqi 0,38 MW (Sarande)	0.380		10/6kv	466
Hec "Velcan" me fuqi 1,2 MW (Korce)	1.200		10kV	2,683
Hec "Muhur" me fuqi 0,25 MW (Diber)	0.250		6kV	717
Hec "Rajan" me fuqi 1,02 MW (Kolonje)	1.020	10kV	1,322	
Hec "Lure" me fuqi 0,75 MW (Diber)	0.750	10kV	463	
Hec "Gjanç" me fuqi 2,96 MW	2.960	"Spahiu Gjanç" sh.p.k.	35 kV	3,762
Hec "Bogove" me fuqi 2,5 MW	2.500	"Wonder power" sha	35 kV	3,059
Hec "Xhyre" me fuqi 570 kW	0.570	"Amal" sh.p.k	10kV	1,413
Hec "Stranik" me fuqi 4.6 MW	4.600	"Hidroinvest 1" shpk	35kV	7,396
Hec "Zall Tore" me fuqi 3 MW	3.000		35kV	8,533
Hec "Klos" me fuqi 1,95 MW	1.950	"Malido-Energji" shpk	6kV	2,006
Hec "Borje" me fuqi 1.5 MW	1.500	"HIDROALBANIA Energji" shpk	35kV	17,276
Hec "Cernaleve" me fuqi 2.95 MW	2.950	"HIDROALBANIA Energji" shpk	35kV	7,331
Hec "Cernaleve 1" me fuqi 3.27 MW	3.270	"HIDROALBANIA Energji" shpk	35kV	8,078
Hec "Murdhar 1" me fuqi 2.68 MW	2.680	"HydroEnergy" shpk	10kV	7,544
Hec "Murdhar 2" me fuqi 1 MW	1.000		10kV	4,275
Hec "Dishnice" me fuqi 0.2 MW	0.200	"Dishnica Energy" shpk	10kV	441
hec "Lubonje" me fuqi 0.3 Mw	0.300	"Elektro Lubonje" shpk	10kV	192
Hec "Peshke" me fuqi 3.43 MW	3.430	"Koka & Ergi Energy Peshk" shpk	35kV	9,251
Hec "Labinot -Mal" me fuqi 0.25 MW	0.250	"Ansara Koncension" shpk	6kV	191
Hec "Pobreg" me fuqi 12,3 MW	12.300	"Energy Plus" shpk	35kV	36,976
Hec "Vlushe" me fuqi 14.2 MW	14.200	"Hec Vlushe" shpk	35kV	24,148
Hec "Belesova 1" me fuqi 0.150 MW	0.150	"Korkis 2009" shpk	6kV	60
Hec "Faqekuq 1,2" me fuqi (3 MW; 3.4 MW)	6.400	"HP OSTROVICA" shpk	35kV	11,037
Hec "Shemri" me fuqi 1 MW	1.000	"Erald Energjitik" shpk	10	1,271
Hec "Mgulle" me fuqi 0.28 MW	0.280		10kV	1,440
Hec "Kryezi 1" me fuqi 0.6 Mw	0.600	"Bekim Energjitik" shpk	10kV	2,401
Hec "Selishte" me fuqi 2 MW	2.000	"Selishte" shpk	35kV	4,738
Hec "Carshove" me fuqi 1.5 Mw	1.500	"ERMA MP" shpk	10kV	1,977
Hec "Ura e Dashit" me fuqi 1,2MW	1.200		10kV	6,720

Hec "Gizavesh" me fuqi 0.5 MW	0.500	"Dosku Energy" shpk	10kV	2,119
Hec "Koka 1" me fuqi 3,2 MW	3.200	"Snow Energy" shpk	35kV	3,977
Hec "Stravaj" me fuqi 3,6 MW	3.600	"Stravaj Energji" shpk	35kV	9,256
Hec "Picar 1" me fuqi 0,2 MW	0.200	"Peshku Picar 1" shpk	6kV	235
Hec "Vertop" me fuqi 1,52 Mw	1.520	"Hydro Salillari Energy" shpk	35kv	1,521
Hec "Martanesh" me fuqi 10,5 MW	10.500	"Albanian Power" shpk	35kV	11,627
Hec "Verba 1,2" me fuqi (2 MW, 3 MW)	5.000	"Hydro power Plant Of Korca" shpk	35kV	8,166
Hec "Fterra" me fuqi 1,08 MW	1.080	"Hidro Borshi" shpk	35kV	6,069
Hec "Ostren i Vogel" me fuqi 0,32 MW	0.320	"Lu & Co Eco Energy" shpk	10kV	734
Hec "Kozel" me fuqi 0,5 MW	0.500	"E.T.H.H." shpk	10kV	1,101
Hec "Helves 1" me fuqi 0,8 MW	0.800		10kV	1,697
Hec "Helves 2" me fuqi 0,5, MW	0.500		10kV	866
Hec "Qafezeze" me fuqi 0,4 MW	0.400	"Caushi Energji" shpk	10kV	1,545
Hec "Trebisht" me fuqi 1,775 MW	1.775	"SA.GLE.Kompani" shpk	10kV	3,134
Hec "Mollaj" me fuqi 0,6 MW	0.600	"Energji Xhaci" shpk	10kV	486
Hec "Tucep" me fuqi 0,4 MW	0.400	"Tucep" shpk	10kV	2,405
Hec "Treska4" me fuqi 3,6 MW	3.600	"Hec-Treske" shpk	35kV	6,478
Hec "Treska3" me fuqi 0,3 MW	0.300		35kV	76
Hec "Treska 2T" 5 me fuqi 0.62 MW	0.620		35kV	1,339
Hec "Sotire1 & 2" me fuqi 2,2 MW	2.200	"Hidro Energy Sotire" shpk	35kV	2,968
Hec "Shutine" me fuqi 2,4 MW	2.400	"Shutina energji" shpk	10kV	2,125
Hec "Cekrez 1,2" me fuqi (0,23 MW; 0.43 MW)	0.660	"Zall Herr Energji 2011" shpk	6kV	4,224
Hec "Qarr" me fuqi 1 MW	1.000	"Hec Qarr & Kaltanj" shpk	35kV	3,364
Hec "Bisak" me fuqi 1,3 MW	1.300	"Bardhgjana" shpk	6kv	2,426
Hec "Shales" me fuqi 1,08 MW	1.080	"Gjoka Konstruksion Energji" shpk	35kV	1,515
Hec "Strelce" me fuqi 1,174 MW	1.174		35kV	4,021
Hec "Shpelle" me fuqi 400 kW	0.400	"Sarolli" sh.p.k	10kV	1,117
Hec "Treska 1" me fuqi 130 kW	0.130	Star NRG sh.p.k	10kV	349
Hec "Bicaj" me fuqi 3,1 MW	3.100	"EN-KU" sh.p.k	10kV	0
Hec "Leskovik 1" me fuqi 1072 kW	1.072	"Maksi Elektrik" sh.p.k	10kV	314
Hec "Leskovik 2" me fuqi 1100 kW	1.100		10kV	458
Hec "Orenjë" me fuqi 875 kW	0.875	"Juana" sh.p.k	10kV	574
Hec "Tamarë" me fuqi 750 kW	0.750	"WTS Energji" shpk	10kV	649
Hec "Benë" me fuqi 1000 kW	1.000	"Marjakaj" shpk	6kV	1,204
Hec "Vithkuq" me fuqi 2,715 MW	2.715	"Favina 1" shpk	35/10kV	8,536
Hec "Selce" me fuqi 1600 kW	1.600	"Selca Energji" shpk	10kV	4,457
Hec "Kumbull- Merkurth" me fuqi 0.83 Mw	0.830	"DN & NAT Energy" shpk	6kV	1,445
Hec "Sasaj" me fuqi 8,6 MW	8.600	"Energjo - Sas" shpk	35kV	18,391
Hec "Tervol" me fuqi 10.6 MW	10.600	"Hec i Tervolit" shpk	35kV	25,678
Hec "Radove" me fuqi 2,5 MW	2.500	"MTC Energy" shpk	10kV	5,307
Hec "Gurshpat 1" me fuqi 0,84 MW,	0.840	"Gurshpat Energy" shpk	10kV	2,014
Hec "Gurshpat 2" me fuqi 0,83 MW	0.830		10kV	2,770
Hec "Bistrica 3" me fuqi 1,57 MW,	1.570	"Bistrica 3 Energy" shpk	6kv	8,346
Hec "Hurdhas 1" me fuqi 1,71MW,	1.710	"Komp Energji" shpk	6kV	3,063
Hec "Perrollaj" me fuqi 0,5 MW	0.500	"Fatlum" shpk	10kV	345
Hec "Koxheraj" me fuqi 0,62 MW	0.620	"Koxherri Energji" shpk	10kv	1,101
Hec "Kacni" me fuqi 3,87 MW	3.870	"Kisi-Bio-Energji" shpk	20kV	3,737
Hec "Lena 1" me fuqi 1,95 MW,;	1.950	"Gama Energy" shpk	35kv	5,371
Hec "Lena 2" me fuqi 2,3 MW	2.300		35kv	
Hec "Lena 2A" me fuqi 0,25 MW	0.250		35kv	
Hec "Driza" me fuqi 3,408 MW	3.408	"Mesopotam Energy" shpk	35kv	1,771
Hec Strelca 1,2,3 (1.504 MW, 0.325 MW, 3.52 MW)	5.349	"Strelca Energy" shpk	35kv	10,864
Hec "Ujanik 2" me fuqi 2,5 MW	2.500	"HP Ujaniku Energy" shpk	35kv	3,699

Hec "Nishove" me fuqi 1,36 MW	1.360	"Nishova Energy" shpk	35kv	358
Hec "Shtika" me fuqi 1,3 MW	1.300	"Perparimi SK" shpk	10kv	1,405
Hec "Ballenje" me fuqi 1,9 MW	1.900	"Ballenja Power Martanesh" shpk	35kv	1,943
Hec Gavran 1	0.998	"Gavran Energy" shpk	35kv	2,139
Hec Gavran 2	1.215	"Gavran Energy" shpk	35kV	756
Hec Kasollet e Selces 1	4.000	"Xhango Energji" shpk	35kV	1,145
Hec Kabash	5.800	"Energji Univers" shpk	35kV	74
Hec Lusën 1	0.315	"Eurobiznes" shpk	35kV	18
Hec Ura e Fanit	1.000	"Ayen As Energji" sha	35kV	194
	228			471,751
Central Fotovoltaik 1 MW (pa sistemuarne sistem)	1.000	"UKKO" sha (Ujsjell.Kanal.Korce)		

Figure 6 Prodhimi neto i të gjitha centraleve prodhuese gjatë vitit 2017 (MWh)

Në figurën më poshtë paraqitet prodhimi neto vendas për vitin 2017 duke evidentuar kontributin në prodhim të KESH sh.a., si prodhuesi i vetëm publik si dhe kontributet e prodhuesve të tjerë Privat/me Koncesion. Siç shihet, prodhimi publik vazhdon të ketë peshën kryesore në prodhimin vendas siç raportuar nga OST sh.a.




Figure 7 Prodhimi neto vendas për vitin 2017

Figura më poshtë detajon prodhimin neto vendas gjatë muajve të vitit 2017 duke paraqitur edhe nivelin e kontributit të të gjithë prodhuesve.




Figure 8 Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2017 (MWh)

Figurat më poshtë krahasojnë prodhimin gjatë vitit 2017 me rezultatet e prodhimit të periudhës 2007 – 2016.




Figure 9 Prodhimi vendas për vitin 2017 krahasuar me periudhën 2007-2016




Figure 10 Prodhimi neto vendas për periudhën 2007-2017

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2017 ka shënuar një prodhim më të ulët se mesatarja e periudhës 2008-2017 nga burimet vendase. Prodhimi maksimal mujor për vitin 2017, është shënuar në muajin dhjetor me 608,803 MWh. Ky prodhim është realizuar kryesisht nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. Prodhimi mujor minimal gjatë vitit 2017 është realizuar në muajin Shtator me 86,075 MWh.

Në grafikun e Figurës së mëposhtme vihet re se si pasojë e një viti relativisht të thatë nga pikpamja hidrologjike, prodhimi për vitin 2017 është **4,525 GWh** pra një prodhim nën mesataren shumë - vjeçare 1985 - 2017 me rreth **171 GWh**.




Figure 11 Prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë për periudhën 1985 – 2017 (Burimi: OST sha, OSHEE sha)

Prodhimi nga hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin ka peshën kryesore në prodhimin vendas dhe më poshtë paraqiten rezultatet historike të prodhimit nga tre hidrocentralet kryesore në administrimin e KESH sh.a..




Figure 12 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: OST sh.a.).

Diferencat ndërmjet prodhimeve maksimale e minimale rezultojn rreth 2.7 herë, duke shprehur në mënyrë të dukshme shkallën e lartë të riskut hidrogjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga sistemet Elektroenergjetike të mbështetur vetëm në HEC-e.

Më poshtë po detajojmë prodhimin mujor të energjisë elektrike nga hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin në administrim të KESH sha.




Figure 13 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2017 (Burimi: KESH sh.a. , OST sh.a.).

Sipas raportimeve të KESH sha, shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike duke marrë parasysh koeficientin e ngarkimit të agregatëve sipas tabelës së mëposhtme bëri të mundur që të shkarkohen sasi të vogla uji nga portat e hidrocentraleve, pa iu marrë më parë energjia.

	HEC Fierzë	HEC Koman	HEC VauDejës
Koeficienti mesatar i ngarkimit të agregatëve (%)	94	82	80

Figura më poshtë tregon shkarkimet nga hidrocentralet gjatë vitit 2017.

DERDHJET E UJIT NGA H/C-ET E KASKADES SE DRINIT GJATE VITIT 2017 (million m3)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershorr	Korrikk	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	2017
Fierzë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Koman	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	8	65	73
Vau Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	52	52

Figure 14 Derrdhjet nga HEC-et e KESH sha gjatë vitit 2017.

Baseni i HEC-it të Fierzës funksionon si rregullator vjetor i rezervës hidrike, ç’ka ndikon drejtpërsëdrejti dhe në shfrytëzimin e Kaskadës mbi lumin Drin (HEC-eve të Komanit, të Vaut të Dejës dhe të Ashtës), të cilët furnizohen kryesisht me ujë nga prurjet e rregulluara të HEC-it të Fierzës.

Në figurën 15, janë paraqitur në mënyrë grafike shkarkimet e ujit nga HEC-et e KESH sha të Kaskadës së lumit Drin, për secilin vit të periudhës 2002-2017.




Figure 15 Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2017) (Burimi: OST sh.a).

Më poshtë jepet niveli në metra i Liqenit të Fierzës për vitin 2017 në fund të çdo muaji.




Figure 16 Niveli (m) i Liqenit të HEC të Fierzës gjatë vitit 2017. (Burimi OST sha, KESH sha)

Të dhënat historike mbi nivelin e liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2017 paraqiten më poshtë duke evidentuar kuotat minimale e maksimale.

NIVELI I FIERZES 1991-2017												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1991	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1992	278.0	274.1	268.0	278.8	281.0	279.6	275.2	268.7	263.9	271.4	281.9	280.6
1993	275.2	265.3	264.7	278.5	280.5	277.3	271.0	261.1	253.6	249.9	255.6	270.2
1994	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1995	253.8	260.3	262.5	275.3	289.0	288.7	284.5	282.2	288.2	283.8	279.9	287.5
1996	287.1	288.7	286.5	294.7	295.8	293.1	287.6	282.2	285.1	284.3	289.2	291.3
1997	289.4	284.5	281.7	285.2	294.1	292.0	287.0	280.0	272.9	272.4	270.8	277.2
1998	273.7	270.0	265.2	278.9	288.1	287.4	281.8	277.6	276.0	277.1	279.0	277.1
1999	272.7	275.6	281.5	290.5	295.9	293.3	288.3	279.5	271.0	257.6	263.6	276.9
2000	276.4	276.7	276.8	286.9	286.6	280.1	273.5	267.5	261.6	248.4	249.3	252.1
2001	253.6	258.2	275.1	282.9	287.6	283.8	273.7	271.1	269.2	263.6	263.2	252.1
2002	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	267.8	274.3	286.1	285.3	284.0
Menaxhimi i rrymës së qarkut të shkurtër është i nevojshëm për të parandaluar nga dëmtimi të gjitha llojet e objekteve të gjenerimit, elementet e Sistemit të Transmetimit dhe pajisjeve të lidhura me të, dhe për të ruajtur sigurinë e personave, nëpërmjet shkyçjes së shpejtë dhe selektive të pjesës në qark të shkurtër. Pra, objektivi i menaxhimit të rrymës së qarkut të shkurtër është mbajta e ndikimit të rrymave të lidhjes së shkurtër në një nivel që siguron funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit, me anë të sistemit përkatës të mbrojtjes. Kjo nënkupton:

- Llogaritjen e saktë të rrymave të lidhjes së shkurtër nga ana e specialistëve të planifikimit të OST-së duke ndjekur parimet e standardizuara dhe sigurimin e të dhënave nga OST-të fqinje, OSHEE dhe Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit;
- Monitorimin e rrymave të lidhjes së shkurtër dhe marrjen e masave përmirësuese, parandaluese dhe kuruese në qoftë se kufijtë e sigurisë operative janë, ose kanë tendencë për t'u shkelur;
- Sigurimin e informacionit dhe të komunikimit me OST-të fqinje, OSHEE dhe Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit, të afektuar, në mënyrë që të jenë në gjëndje të marrin në konsideratë efektin e sistemeve të tjera të transmetimit dhe shpërndarjes.

Menaxhimi i fluksit të energjisë

Çdo element i Sistemit të Transmetimit ka kufijtë e sigurisë operative në drejtim të rrjedhës së energjisë. Këto kufizime janë të rëndësishme për mbrojtjen e pajisjeve dhe njerëzit në afërsi të një elementi të caktuar të Sistemit të Transmetimit, duke marrë parasysh

kufizimet teknike të materialeve të përdorura, me qëllim shmangien e dëmtimit apo vjetërimit e parakohshëm të pajisjes. Pra, menaxhimi i fluksit të energjisë ka të bëjë me krijimin apo përcaktimin e mjeteve operacionale për të mbajtur rrjedhën e energjisë brenda kufijve të sigurisë operative në çdo element të sistemit të transmetimit. Për të qenë në gjendje për të monitoruar dhe kontrolluar parametrat operacionale është e nevojshme që të ketë informacion të saktë mbi gjëndjen e Sistemit dhe gjithashtu të vlerësimit të gjëndjes së Sistemit. Për këtë, OST kontrollon parametrat operacionale brenda zonës së vet të përgjegjësisë dhe, në mënyrë të koordinuar, merr në konsideratë parametrat operative nga zona e observimit që përfshin pjesë të OST-ve fqinje. Kjo nënkupton të dhëna strukturore dhe në kohë reale të shkëmbimit të informacionit ndërmjet OST-ve në zonat e ndërthurura të observimit, dhe ndërmjet OST dhe OSSH në zonën e përgjegjësisë të OST-së. Për të qenë në gjendje për të përballuar avaritë në Sistem, nga ana e OST-së përgatiten veprimet përmirësuese individuale dhe të koordinuara, dhe zbatohen kur është e nevojshme, për të parandaluar shkeljen e limiteve të Sigurisë Operative dhe për të përballuar kthimin në normalitet në rastet e situatave alerte ose në emergjencë.

Analiza e kontigjencave dhe trajtimi

Me qëllim mbajtjen e sigurisë së operimit të Sistemit, bëhet analiza e kontigjencës (e ndodhjes së ngjarjeve të pa-parashikuara) që do të thotë kryerja e simulimit të stakimit të elementeve të Sistemit të Transmetimit. Kjo analizë kryhet duke përdorur modelin individual të OST-së dhe modelin e bashkuar të rrjetit, duke respektuar kufijtë e sigurisë operative dhe ndërkohë bëhet përgatitja për kryerjen e veprimeve përmirësuese para dhe pas incidentit, kur kërkohet nga rezultati i analizës.

Parimet kryesore që ndiqen në lidhje me analizën e kontigjencave, të cilat gjithashtu përshkruajnë qëllimet e përgjithshme dhe objektivat e analizës së kontigjencës në kohë reale dhe në fazën e planifikimit operativ janë:

- Sigurimi i parandalimit dhe/ose kurimit përpara i përket veprimeve përmirësuese, të kërkuara për të ruajtur sigurinë e operimit, për të gjitha kontingjencat e besueshme që ndikojnë në Sistemin e Transmetimit.
- Koordinimi i analizave dhe veprimeve përmirësuese, kurdo që është e nevojshme, për të siguruar rezultatin e dëshiruar - ruajtjen e sigurisë operative në Sistem dhe në Interkonjeksion.
- Mbështetja në të dhënat e duhura dhe informacionin në kohe reale dhe atë të bazuar në parashikimin e ngarkesave. Përdorimi i modelit të bashkuar të rrjetit rajonal, dhe shkëmbimi i të gjitha të dhënave të nevojshme dhe informacionit ndërmjet OST-së, OSSH-së dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit.
- Suportimi i përpunimit të dispozitave të standardeve pan-Europiane për analizat e kontigjencave për të ruajtur sigurinë e operimit duke maksimizuar përdorimin e Sistemit.

Mbrojtja

Pajisja e mbrojtjes është përdorur për të mbrojtur asetet e Sistemit të Transmetimit nga dëmtimet. Skemat e sistemit të mbrojtjes janë përdorur për të zbuluar kushtet anormale të

sistemit dhe ndërmarrin veprime korrigjuese të paracaktuara, për të ruajtur integritetin e sistemit, me një performancë të pranueshme të sistemit, në mënyrë të koordinuar. Funksionet për mbrojtjen e Sistemit analizohen duke u mbështetur në llogaritjet e rrjetit, duke konsideruar funksionimin korrekt dhe jo korrekt. Nëse parashikohen pasoja të papranueshme, funksionaliteti dhe redundanca e Skemës së Mbrojtjes së Sistemit përshtaten në përputhje me rrethanat për të përmbushur kërkesat e sigurisë operationale. Funksionaliteti dhe statusi i gjëndjes së sistemit monitorohen, komunikohen dhe koordinohen ndërmjet OST-ve fqinje dhe palëve të tjera të prekura nga sistemi i mbrojtjes.

Menaxhimi i Stabilitetit Dinamik

Qëllimi i Vlerësimit të Stabilitetit Dinamik (VSD) është për të siguruar ndërgjegjësimin e operatorit të OST-së në lidhje me gjëndjen aktuale dhe parashikimin në të ardhmen të situatës së Sistemit në lidhje me stabilitetin, në situatën (N) dhe në atë të mundshme (N-1). Përveç kësaj, VSD mbështet vendimet ndaj veprimeve më efektive dhe efikase përmirësuese, për parandalimin e incidenteve ose korrigjimin e pasojave të tyre, nëse ato ndodhin. Përdorimi i gjerë i VSD lejon aplikime të ndryshme, jo vetëm në kohë reale, por edhe në fazat e planifikimit operacional. Një theks është vënë në trajnimin e stafit operativ të OST duke bërë përdorimin e VSD, si dhe për mirëmbajtjen e vazhdueshme të modeleve dhe të simulatorit përkatës.

Trajnimi Operativ dhe Çertifikimi

Në përputhje me Udhëzimet e Praktikës së Mirë për Sigurinë Operationale, trajnimi është i nevojshëm në mënyrë që të garantojë se Operatorët e Sistemit dhe personeli tjetër operativ janë të aftë, të mirëtrajnuar, dhe se punonjësit që operojnë Sistemin në kohë reale janë të çertifikuar për të vepruar në mënyrë të sigurtë gjatë të gjitha situatave operationale.

Në këtë kontekst, OST ka filluar zbatimin e një trajnimi dhe procesi të gjerë çertifikimi, i cili do të mundësojë njohjen dhe reagimin ndaj kushteve operative jonormale në afatet kohore përkatëse dhe, kur është e përshtatshme, në mënyrë të koordinuar me OST-të e tjera. Për më tepër, zbatimi i standardeve operative mund të sigurohet nga zhvillimi i programeve që përfshijnë trajnimin fillestar, zhvillimin e vazhdueshëm të personelit dhe ri-vlerësimin e rregullt të çertifikimit.

Kodi i Operimit vendos detyrimin për OST-në që të ketë të aktivizuar programet e vazhdueshme zhvillimore për stafin e saj në dhomën e kontrollit dhe të bashkërendojë e bashkëpunojë në trajnimet ndër-sistimore për çështje të transmetimit rajonal. Stafi i trajnuar i OST-së do të jetë në gjëndje të veprojnë në mënyrë efikase në balancimin e Sistemit dhe në maksimizimin e mundësisë për transfertat ndërkufitare të cilat të dyja ofrojnë përfitime reale ekonomike për konsumatorët, mjaft më sinjifikative sesa rritja e kostos së investuar me shumë në trajnimin e stafit të OST-së në QDS. Për më tepër, duke investuar në trajnimin e stafit operativ të OST-së, do të zvogëlohet probabiliteti i avarive të mëdha me përhapje të gjerë të shoqëruara me ndërprerjen e furnizimit, të cilat nëse ndodhin mund të zgjasin për shumë orë apo edhe ditë, dhe për të cilat ka një kosto shumë të madhe ekonomiko sociale.

- b) Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë pesëvjeçare, dhe
- c) Niveli i pritshëm i kërkesës dhe perspektivën e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri në pesëmbëdhjetë vjeçare nga data e raportit

Mbi bazën e deklarimeve të pjesëmarrësve të tregut, bazën e të dhënave historike të OST-së, dhe duke konsideruar rritjen potenciale të gjenerimit të PPE + PVE dhe reduktimin e humbjeve jo teknike në rrjetin e shpërndarjes, është pranuar që rritja e pritshme e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST, të jetë e rendit 1.5-2%, dhe mbi këtë bazë, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i parametrave kryesorë energjistik dhe siguri i balancës së Sistemit për pesë vjeçarin, siç jepet në tabelat e mëposhtme:

Viti 2018		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	686	517	486	437	423	453	520	534	463	503	524	685	6,231
Konsumi per KK	GWh	65	60	85	95	95	95	75	80	85	85	85	95	1,000
Humbje + N.V.	GWh	16	15	14	13	13	13	14	15	13	13	14	16	169
Kerkesa totale	GWh	767	592	585	545	531	561	609	629	561	601	623	796	7,400
Prodhimi	GWh	507	357	399	401	383	381	348	368	345	378	371	536	4,774
KESH	GWh	387	251	267	265	244	276	285	305	270	284	272	414	3,521
PVE+PPE	GWh	120	105	132	136	139	105	63	63	75	93	99	122	1,253
Importi	GWh	260	235	186	144	149	180	260	260	216	223	252	260	2,626
OSHEE	GWh	223	202	149	108	112	144	208	208	180	186	216	216	2,152
FK → KK	GWh	37	34	37	36	37	36	52	52	36	37	36	44	475

Viti 2019		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	671	499	468	418	404	434	501	517	444	484	506	672	6,018
Konsumi per KK	GWh	95	90	115	125	125	125	105	110	115	115	115	125	1,360
Humbje + N.V.	GWh	16	15	14	13	13	13	15	15	13	14	14	15	170
Kerkesa totale	GWh	782	604	597	556	542	572	621	642	572	613	635	812	7,548
Prodhimi	GWh	520	405	450	400	410	395	370	380	365	405	415	515	5,030
KESH	GWh	380	280	295	235	250	260	280	290	280	310	295	375	3,530
PVE+PPE	GWh	140	125	155	165	160	135	90	90	85	95	120	140	1,500
Importi	GWh	262	199	147	156	132	177	251	262	207	208	220	297	2,518
OSHEE	GWh	182	124	67	81	57	97	161	172	122	123	130	202	1,518
FK → KK	GWh	80	75	80	75	75	80	90	90	85	85	90	95	1,000

Viti 2020		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	500	480	490	470	450	460	480	490	410	420	440	510	5,600
Konsumi per KK	GWh	281	122	105	83	90	110	138	150	160	192	194	302	1,928
Humbje + N.V.	GWh	17	15	14	14	13	13	15	15	13	13	14	16	172
Kerkesa totale	GWh	798	617	609	567	553	583	633	655	583	625	648	828	7,700
Prodhimi	GWh	570	455	500	450	455	430	415	425	420	455	460	565	5,600
KESH	GWh	380	280	295	250	255	260	280	290	280	310	295	375	3,550
PVE+PPE	GWh	190	175	205	200	200	170	135	135	140	145	165	190	2,050
Importi	GWh	228	162	109	117	98	153	218	230	163	170	188	263	2,100
OSHEE	GWh	128	67	9	22	3	53	108	120	58	65	78	148	860
FK → KK	GWh	100	95	100	95	95	100	110	110	105	105	110	115	1,240

Viti 2021		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	490	470	480	461	441	451	470	480	402	412	431	500	5.488
Konsumi per KK	GWh	323	140	121	96	103	127	159	172	185	221	223	347	2.217
Humbje + N.V.	GWh	20	15	14	14	13	13	15	15	13	13	14	16	179
Kerkesa totale	GWh	833	626	615	570	558	591	645	668	600	646	668	863	7.883
Prodhimi	GWh	624	464	489	440	441	434	439	454	434	475	484	625	5.801
KESH	GWh	380	275	290	250	255	260	280	290	280	310	295	375	3.540
PVE+PPE	GWh	244	189	199	190	186	174	159	164	154	165	189	250	2.261
Importi	GWh	209	162	126	130	117	157	206	214	166	171	184	239	2.082
OSHEE	GWh	89	47	6	15	2	37	76	84	41	46	54	104	602
FK → KK	GWh	120	115	120	115	115	120	130	130	125	125	130	135	1.480

Viti 2022		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	480	461	471	451	432	442	461	471	394	403	423	490	5.378
Konsumi per KK	GWh	354	167	150	124	131	153	184	198	208	246	250	382	2.547
Humbje + N.V.	GWh	20	15	14	14	13	13	15	15	13	13	14	16	179
Kerkesa totale	GWh	854	643	635	589	576	608	661	684	615	662	687	888	8.104
Prodhimi	GWh	647	483	509	459	459	451	455	470	449	492	503	650	6.026
KESH	GWh	380	275	290	250	255	260	280	290	280	310	295	375	3.540
PVE+PPE	GWh	267	208	219	209	204	191	175	180	169	182	208	275	2.486
Importi	GWh	207	160	126	130	117	157	206	214	166	171	184	239	2.078
OSHEE	GWh	89	45	6	15	2	37	76	84	41	46	54	104	600
FK → KK	GWh	118	115	120	115	115	120	130	130	125	125	130	135	1.478

ç) Kapaciteti shtesë prodhues i propozuar, i planifikuar apo në fazë ndërtimi.

Për këtë çështje informacioni është vetëm për ato centrale të cilat janë parashikuar të lidhen në rrjetin e transmetimit (janë në fazë ndërtimi apo kanë marrë miratimin paraprak për lidhjen me rrjetin e transmetimit), si më poshtë:

1. Kaskada e Lumit Devoll, (Moglica 171 MW);
2. HEC Kalivaç, 100 MW;
3. HEC Fang, 72 MW;
4. HEC Gostime, 21.5 MW;
5. HEC Qarishte, 37 MW;
6. HEC Sllabinjë 2D, 9.8 MW;
7. HEC Sllabinjë 2E, 5.2 MW;
8. HEC Llenga, 3.0 MW;
9. HEC Shpella Poshtë, 2.3 MW;
10. HEC Cemerice, 6.39 MW;
11. HEC Denas, 14.5 MW;
12. HEC Hotolisht, 7.77 MW;
13. HEC Orenje, 16.7 MW;
14. HEC Egnatia, 6.0 MW;
15. HEC Qafshulli, 5.97 MW;
16. HEC Lumzi, 11 MW;
17. HEC Kalivare, 5.46 MW;
18. HEC Stavec, 20.77 MW;
19. HEC Topojan, 10.2 MW;

20. HEC-et Seta 1,2,3,4, 14.9 MW;
21. HEC Lashkiza, 5.2 MW;
22. HEC German, 4.98 MW;
23. HEC Seka & Zais, 14.96 MW;
24. HEC Guri Zi, Shelli, Daznjane, 4.76 MW;
25. HEC Zalli Bulqizës, 6.47 MW;
26. HEC-et Zaje, Turaj, Xhaferaj, etj., 5.94 MW;
27. HEC-et Mati 1,2,3, 38 MW;

d) Parashikimi i investimeve, për jo më pak se pesë vitet e ardhshme, që planifikohen të realizohen nga OST apo çdo palë tjetër, lidhur me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkonjeksionit:

Nga pikpamja strategjike, projektet që përforcojnë lidhjet interkonjektive me rajonin, duke krijuar kushte më të mira për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajonin e Evropës Juglindore, janë:

➤ **Linja e Interkonjeksionit 400 kV Elbasan2 (AL) – Bitola (MK).**

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan2 - Bitola, afersisht 151 km, 56 km në territorin Shqiptar.
- Zgjerimin e nënstacionit 400 kV Elbasan2 me zbarrë dyfishe 400 kV, një dalje të re linje 400 kV dhe një shunt-reaktor 120 MVar.

Projekti do të ketë impakt të rëndësishëm në:

- Krijimin e mundësive tregtare për shkëmbime ekonomike të energjisë elektrike nëpërmjet vendeve të rajonit.
- Ndarjen e rezervës kapacitive që do të kontribuojë në një siguri më të madhe të funksionimit të sistemeve elektroenergjitike të Shqipërisë dhe Maqedonisë.
- Suportin reciprok në raste emergjente.
- Shfrytëzimin optimal të burimeve të rajonit që rezultojnë me kosto më të ulët të energjisë elektrike.
- Dispatchimin optimal të njësive gjeneruese.
- Besueshmëri më e lartë e sistemit elektroenergjitik.
- Reduktimin e kostos së gjenerimit.
- Reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit.

➤ **Linja 400 kV Elbasan2 – Fier**

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re 400 kV, Elbasan2 – Fier, rreth 70 km, dhe dy daljet 400 kV respektivisht në nënstacionet Elbasan2 dhe Fier.

- Zgjerimin e nënstacionit Fier me një transformim 400/220 kV dhe lidhjen e tij me rrjetin e transmetimit.

Ky projekt, si pjesë e projektit të mësipërm, do të ketë inpakt në:

- Rritjen e standardeve, cilësisë dhe efencës së sistemit të transmetimit në zonën qendrore dhe jugore të vendit;
- Reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, sidomos në rrjetin 220 kV;
- Zvogëlimin e energjisë së mosfurnizuar (ENS);
- Zvogëlimin e mbingarkimit të rrjetit 220 kV;
- Rritjen ekonomike në zonën qendrore dhe jugore si rezultat i një cilësie më të lartë furnizimi dhe reduktimit të ndërprerjeve të energjisë.

- Parimet e menaxhimit të kufizimit të kapaciteteve në linjat ekzistuese dhe ato të planifikuara të sistemit të transmetimit.

Me investimet e bëra gjatë viteve të fundit në sistemin e transmetimit është bërë e mundur plotësimi i kriterit të sigurisë N-1 në rrjetin e brendshëm të Sistemit për të gjitha regjimet e punës, dhe nuk kemi probleme të kufizimit të kapaciteteve transmetuese. Lidhur me menaxhimin e kapaciteteve ndërkufitare, në zbatim të rregullave të ENTSO-E, zbatohet procedura e mëposhtme.

Përcaktimi i kapacitetit transmetues ndërkufitar, NTC, aktualisht bëhet sipas Marrëveshjeve bilaterale ndërmjet OST-ve fqinje, dhe bazohet në Manualin Operacional të ENTSO-E, respektivisht në Politikën Nr. 4, dhe Aneksin e saj. Është e rëndësishme të theksohet dallimi i qartë ndërmjet vlerave tregtare dhe atyre fizike, pasi siç dihet, ekzistojnë dy sete përkufizimesh, një i lidhur me vlerat e programit (skedulimit) dhe tjetri me fluksin fizik të energjisë elektrike, që në shumicën e rasteve nuk përputhen kur merret në konsideratë një interkonjektor i veçuar nga pjesa tjetër e rrjetit. Kompleksiteti i anës fizike të fluksit të energjisë trajtohet nga OST-të, që janë përgjegjëse përkundrejt Autoriteteve përkatëse për kryerjen e kësaj detyre në mënyrë jo diskriminuese. Pjesëtarët e tregut nuk duhet të përfshihen në këtë proces.

Periudhat kohore të përcaktimit të kapacitetit transmetues ndërkufitar

Proçesi i përcaktimit të NTC prodhon rezultate për periudhat kohore: vjetore, mujore, një dite përpara (D-1) dhe brenda ditës.

Të dhënat për modelin individual të rrjetit

Sipas dispozitave të Kodit të Transmetimit, Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit i mundësojnë OST-së informacionin e nevojshëm për përcaktimin e kapacitetit transmetues. Ky informacion përfshin por nuk kufizohet në:

- Informacionin lidhur me të dhënat teknike;
- Informacionin lidhur me disponueshmërinë e pajisjeve dhe elementëve të rrjetit;
- Informacionin lidhur me skedulimin e njësive gjeneruese.

Për çdo periudhë kohore të përcaktimit të kapacitetit, çdo njësi gjeneruese apo ngarkese i mundëson OST-së të gjitha të dhënat e specifikuar, dhe ndërkohë Operatori i Sistemit

(specialistët e planifikimit të regjimit të punës) përgatisin me kujdesin e nevojshëm modelin e rrjetit të zonës tonë të kontrollit, të cilit i kontrollon konvergjenca para se t'i dërgohet OST-së koordinatorë të rajonit, në mënyrë që të mundësojë llogaritjen e flukseve të fuqisë aktive, reaktive dhe tensionit, në analizat e qëndrueshmërisë statike që duhet të përformohen.

Inputi kryesor për llogaritjen e NTC-së është dokumenti për përgatitjen e modelit rajonal të rrjetit “*SEE regional common grid model for different time horizons*” i përgatitur nga Grupi Rajonal i Europës Jug-Lindore nën Komitetin e Tregut të ENTSO-E. Ky dokument ofron dy elementë themelorë për procesin e llogaritjes së NTC:

- Tabela e harmonizuar e rastit bazë të shkëmbimit (BCE);
- Modeli i Bashkuar i Rrjetit Rajonal për periudha kohore të ndryshme.

OST-të e SEE përgatisin supozimet për Rastin Bazë të Shkëmbimit (BCE), të cilat janë parashikimet e skeduleve tregtare në modelin mujor dhe i nisin ato OST-së koordinatorë. Këto tabela përgatiten në bazë të historikut të fundit dhe eksperiencës së OST-ve. OST-ja koordinatorë pasi mbledh të gjitha tabelat e BCE-ve të OST-ve të rajonit SEE bën harmonizimin e saj. Totalët e shkëmbimeve të deklaruara në këto tabela vendosen më pas në modelet individuale të çdo OST-je.

Për çdo periudhë kohore të përcaktimit të kapacitetit, një Model i Bashkuar i Rrjetit Rajonal krijohet në nivel rajoni duke bashkuar inputet (modelet individuale) nga të gjithë Operatorët e Sistemit, nëpërmjet funksionit të OST-së koordinatorë. Funksioni i OST-së koordinatorë përformohet nga një OST e SEE në nivel mujor. Në kuadrin e grupit të punës RG SEE, Operatorët e Transmetimit kanë rënë dakord që aktiviteti i koordinimit rajonal të bëhet me rotacion me bazë mujore. Rolin e koordinatorit për skenarët referenca vjetore, dimër dhe verë, për zonën sinkrone të Europës Kontinentale, e kryen qendra e koordinimit të sigurisë RSCI CORESO.

Skenarët e Modelit të Bashkuar të Rrjetit

Të gjitha OST-ët e SEE emetojnë një skenar bazë për çdo periudhë kohore të përcaktimit të kapacitetit, i cili krijohet në Modelin e Bashkuar të Rrjetit.

Në rast të nevojës së përcaktimit të skenareve shtesë për periudha kohore, OST-ët fqinje duhet të bien dakort rreth periudhave karakteristike shtesë, duke konsideruar programin e mirëmbajtjes (remonteve) dhe angazhimin e gjeneratorëve, të cilët mund të ndikojnë në përcaktimin e vlerës së NTC-së.

Metodologjia e Kalkulimit të NTC-së

1. Metodologjia përmban paragrafët e mëposhtëm:
 - a. Përcaktimin e hapave të ndryshimit të gjenerimit “*Generation Shift Keys*”;
 - b. Përcaktimin e kufizimeve të sigurisë operative;
 - c. Përcaktimin e marzheve të sigurisë.
2. Çdo Operator Sistemi i rajonit do të përdorë metodologjinë e përshkruar në Manualin Operacional të ENSTO-E “P4-Polica 4: Koordinimi i Planifikimit Operacional”, Apendiksi 4.
3. Vlera e NTC-së, Kapaciteti Neto i Transmetimit përcaktohet si:

$$NTC = TTC - TRM$$

$$TTC = BCE + E$$

Ku:

BCE: Shkëmbimi në Rastin Bazë (shkëmbimi i skeduluar);

E: Maksimumi i ndryshimit (rritjes/uljes) së gjenerimit që i caktohet zonës së kontrollit të përfshirë në interkonjeksion duke parandaluar çdo violencë të principit të sigurisë N-1.

4. Kapaciteti total i transmetimit (TTC) përfaqëson vlerën maksimale të programit të shkëmbimit ndërmjet dy zonave (OST-ve), duke plotësuar standardet e sigurisë së punës të detyrueshme për çdo Sistem, nëse për periudhën për të cilën bëhet vlerësimi i TTC, kushtet e rritjes dhe modeli gjenerim – konsum, njihen mirë në avancë.
5. Marzhi i Sigurisë së Transmetimit (TRM) është një marzh sigurie që përfshin pasiguritë në vlerat e llogaritjes së TTC.
6. Kapaciteti tashmë i Alokuar (AAC) është totali i të drejtave të transmetimit të alokuara më parë, p.sh. në ankandin vjetor ose në ndonjë formë tjetër, varësisht nga metoda e alokimit.
7. Kapaciteti disponibël (ATC) është pjesa e NTC që mbetet e disponueshme, pas çdo faze alokimi, për aktivitete tregtare të mëtejshme. ATC jepet nga ekuacioni i mëposhtëm:
 $ATC = NTC - AAC;$ ku: AAC është kapaciteti tashmë i alokuar.

Metoda e Ndryshimit të Gjenerimit me Hap (me shkallë)

Gjeneratorët të cilët marrin pjesë në përcaktimin e NTC-së duhet të karakterizohen nga limitet e tyre maksimale dhe minimale. Metoda e ndryshimit të gjenerimit është në përputhje me mënyrën sesi ndryshimi global i shkëmbimit ndahet midis njësive të ndryshme gjeneruese.

Gjeneratorët e zgjedhur (për rastin tonë të gjitha njësitë gjeneruese të kaskadës së Drinit) përdoren për përcaktimin e NTC-së në mënyrën e mëposhtme: në zonën e një OST-je (gjeneratorët $i=1, n$) fuqia aktive e gjeneratorëve rritet, dhe në zonën e OST-së tjetër (gjeneratorët $j=1, m$) fuqia aktive e gjeneratorëve zvogëlohet me të njëjtën vlerë njëkohësisht. Të gjithë injektimet e zgjedhura modifikohen proporcionalisht me kapacitetin gjenerues të mbetur të disponueshëm.

Ndryshimi realizohet si më poshtë:

$$P_{new}^{inc} = P_i + \Delta E \cdot \frac{P_i^{max} - P_i}{\sum_n (P_i^{max} - P_i)} \quad P_{new}^{dec} = P_i + \Delta E \cdot \frac{P_i^{min} - P_i}{\sum_n (P_i^{min} - P_i)}$$

ku:

P_i Gjenerimi aktual i fuqisë aktive (MW);

P_{new}^{inc} Injektimi i ri i rritur, në iteracionin e radhës do të jetë P_i ;

P_{new}^{dec} Injektimi i ri i ulur, në iteracionin e radhës do të jetë P_i ;

ΔE Ndryshimi i gjenerimit, negative për rritjen dhe pozitive për uljen;

P_i^{\max} Maksimumi i gjenerimit të lejuar (MW);

P_i^{\min} Minimumi i gjenerimit të lejuar (MW);

Kushte shtesë: $|E| \leq (P_{\max} - P_i)$, dhe $|E| \leq (P_{\min} - P_i)$

Avantazhi i kësaj metode është se mbi-përdorimi i gjenerimit është i pamundur dhe kapacitetet e gjenerimit arrihen njëkohësisht. Gjithashtu, kjo metodë respekton limitet fizike ndërkohë që operohet rrjeti i transmetimit. Vlera e fundit e E_{\max} përcaktohet kur të gjithë gjeneratorët ose çdo element tjetër i rrjetit arrijn limitet e tij të operimit.

Kufizimet e Sigurisë Operacionale

Gjatë procesit të përcaktimit të kapaciteteve, OST do të respektojë së paku Kufizimet e Sigurisë Operative të mëposhtme, gjatë kontigjencave të ndryshme të përcaktuara nga Kodi i Sigurisë Operacionale:

- a) Limitet termike të elementeve kritikë të rrjetit;
- b) Limitet e Tensioneve, duke vendosur diapazone të tensioneve të lejueshme të nënstatcioneve;
- c) Limitet e Gjenerimit, duke siguruar disponueshmërinë e rezervës së gjenerimit në mënyrë që të arrihen kërkesat e përcaktuara nga Kodi i Sigurisë Operative.

Elementët kritikë të rrjetit, që janë si ato të Rrjetit Rajonal ashtu edhe ato të Rrjetit të Brendshëm, përcaktohen nga modeli i bashkuar rajonal, dhe përcaktohen si elementë me koeficient të ndjeshmërisë mbi 10%, pra dalja nga puna e një elementi kritik shkakton në të paktën një element tjetër të rrjetit të brendshëm ose të jashtëm, një ndryshim ngarkese prej 10% ose më shumë. Lista e elementëve kritike azhurnohet vazhdimisht me ndryshimin e kushteve të punës së çdo Sistemi, dhe i bëhet disponibël grupit të punës të menaxhimit të konxhestioneve të RG SEE.

Përcaktimi i Marzhit të Sigurisë (TRM)

Përcaktimi i madhësisë së Marzhit të Sigurisë bazohet në përjasje statistikore, duke marrë parasysh evidencat historike dhe parashikimet në të ardhmen. Marzhi i Sigurisë përfshin pa-siguritë e mëposhtme:

- a) Devijimet e paqëllimshme të flukseve fizike gjatë operimit, për shkak të funksionimit fizik të rregullimit fuqi-frekuencë;
- b) Shkëmbimet emergjente midis OST-ve për tu përballur në kohë reale me situata të disbalancave të papritura;
- c) Pasaktesitë, p.sh në mbledhjen e të dhënave dhe matjeve;
- ç) Pasaktësitë në rastin bazë të përdorur për llogaritje, si parashikimet e gjenerimit, konsumit, shkëmbimeve dhe topologjisë së rrjetit, etj.

Aktualisht, në Marrëveshjet Bilaterale, është pranuar që madhësia e marzhit TRM të jetë 100 MW në kufirin me Malin e Zi dhe Greqinë respektivisht, 50 MW në kufirin me Kosovën.

Harmonizimi i Rezultateve të Përcaktimit të Kapacitetit NTC

Vlera vjetore e NTC për çdo kufi dhe drejtim fluksi, llogaritet duke konsideruar vlerën minimale mujore që është përdorur, shfrytëzuar, në tre vitet e fundit, dhe rakordohet me OST-të fqinje respektive brenda muajit Nëntor të çdo viti.

Vlerat mujore të NTC, llogariten dhe harmonizohen me OST-të fqinje për çdo kufi veçmas, brenda datës 7 të çdo muaji, për muajin e ardhshëm. Për këtë ndiqet procedura e mëposhtme:

- 10 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen të dhënat, modeli nacional me të gjitha nyjet e nivelit 220/400 kV, ndërmjet OST-ve, në formatin e aprovuar UCT, përfshirë rezervën e fuqisë aktive për rritjen/uljen e gjenerimit, dhe të dhëna mbi programin e remonteve (elementët jashtë pune) për periudhën e konsideruar;
- 5 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, kryhen llogaritjet (simulimet) për vlerat e TTC/NTC, që kryhen me anë të analizatorit të rrjetit (softit TNA) me të cilin janë të pajisur të gjitha OST-të e rajonit;
- 2 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen vlerat e përcaktuara të TTC për çdo kufi, dhe fillon procesi i harmonizimit të tyre. Në rast mospërputhje të vlerave të llogaritura, dhe nëse palët nuk arrijnë të bindin njëra tjetrën, atëherë vlera më e vogël e TTC hyn automatikisht në fuqi.

Në rast të ndryshimeve të konsiderueshme të situatës së Sistemit në krahasim me situatën e parashikuar, kur janë llogaritur kapacitetet ndërkufitare, OST-të fqinje, pas shkëmbimit të të dhënave relevante të situatës së re, bëjnë ri-kalkulimin e kapacitetit ndërkufitar, dhe përcaktojnë bashkarisht vlerat e reja të NTC e respektivisht ato të ATC.

Alokimi i kapacitetit ndërkufitar për pjesëmarrësit e tregut në rajonin tonë bëhet nga Zyra e Ankandit të Koordinuar SEE CAO, në Podgoricë.

Përdorimi i këtyre kapaciteteve transmetuese është pjesë e tregut të energjisë, e nëse pjesëtarët e tregut janë të motivuar për t'i përdorur të dy drejtimet e fluksit ndërkufitar, atëherë kjo do të lehtësonte qarkullimin e fluksit ndërkufitar duke kontribuar në rritjen e nivelit të sigurisë operationale të punës së Sistemit Elektroenergjitik.

Si rregull, shumica e kapacitetit të shkëmbimit për të gjitha kufitë, shumëzohet me koeficientin 0.75, për të përcaktuar importin/eksportin total të një zone kontrolli, dhe që merret në konsideratë në procesin e skedulimit të gjenerimit për ditën në avancë.

- Modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, duke mundësuar marrjen e masave për menaxhimin e kërkesës.

Siç edhe është dhënë më sipër, bazuar në të dhënat e OST dhe realizimin real për vitin 2016 dhe 11- muajorin e vitit 2017, është kryer parashikimi i kërkesës për energji elektrike, mbulimi i saj nëpërmjet prodhimit vendas dhe importit për pesë vitet e ardhshme, 2018-2022. Të gjitha këto jepen të grupuara në tabelën e mëposhtme:

Viti	2018	2019	2020	2021	2022
Kërkesa për energji elektrike (GWh)	7400	7548	7700	7883	8104

Prodhimi Vendas (GWh)	4774	5030	5600	5801	6026
Importi (GWh)	2626	2518	2100	2082	2078

- Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian.

OST kryen studime të vazhdueshme si për zona të veçanta të rrjetit të transmetimit ashtu edhe të lidhjes së sistemit elektroenergjitik Shqiptar me sistemet e vendeve fqinje. Studimet më të rëndësishme dhe që kanë rëndësi të veçantë kryhen në bashkëpunim me institucionet studimore ndërkombëtare në kuadrin e WBIF.

Gjatë fazave të planifikimit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit me qëllim: (i) Rehabilitimin dhe Fuqizimin e rrjetit të transmetimit, (ii) Krijimin e nyjeve të reja lidhëse, (iii) përmirësimin e procesit të menaxhimit, kontrollit, matjes etj, OST merr në konsideratë zhvillimin kombëtar dhe rajonal, në përputhshmëri të plotë me direktivat e ENTSO-E (Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike).

Të gjitha projektet në proces implementimi dhe ato të planifikuara janë të lidhura me shërbimin e sistemit të transmetimit, i cili mund të kryhet plotësisht vetëm nëpërmjet realizimit të investimeve të nevojshme për fuqizimin dhe modernizimin e tij.

dh) Cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjetit

Përsa i përket mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit, OST në zbatim të Rregullores së shfrytëzimit teknik organizon monitorimin dhe kontrollin periodik të të gjithë elementëve të Sistemit të Transmetimit, duke hartuar planin e kontrollit dhe mirëmbajtjes, në të cilin detajohen veprimet që do të realizohen për kryerjen e remonteve për pajisjet e nënstacioneve dhe kontrollet periodike për linjat e transmetimit. Kontrollet periodike dhe skanimi me kamera termike i linjave të transmetimit dhe nënstacioneve kanë ndihmuar në identifikimin në kohë të problemeve të cilat pas punimeve riparuese dhe ndërhyrjeve jashtë radhe janë eliminuar në kohë të shkurtër duke bërë dhe parandalimin e dëmtimeve të pajisjeve. Kontrollet me qëllim parandalues të difekteve kanë ndikuar në rritjen e cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

Sa i përket pajisjeve transformuese që përbëjnë asetin kryesor në marrjen e kapaciteteve të prodhimit dhe transmetimit, defektet në to mund të sjellin probleme, të cilat lidhen me shpërndarjen e ngarkesës dhe mungesën e kapaciteteve rezervë. Në rastin e dëmtimeve të riparueshme, për zëvendësimin e transformatorëve kërkohet kohë e gjatë, e cila shoqërohet me humbje të medha financiare. Për këtë, për transformatorët 400 kV të sistemit të transmetimit OST merr masa për zbulimin e defekteve që në fillësë nëpërmjet vlerësimit të gjëndjes së transformatorit në kohë reale, duke mundësuar eliminimin e anomalive që në gjëndjen fillestare të shfaqjes së tyre.

Për një pasqyrë të cilësisë së punës së Sistemit të Transmetimit, më poshtë jepen tabelat për stakimin për avari për 11- mujorin e vitit 2017.

Emertimi	stakime gjithsej	tranzitore	qendru eshme	kushte atmosfer.	difekt linje	paisje primare	mbrojtja	SHAM SHAF	OSHEE, te tjere	shkaqe te panjohura	kohe zgjatja
Linja 400kV	27	10	17	14	0	2	0	0	10	1	51h 30'
Linja 220kV	83	45	38	49	22	3	2	0	7	0	176h 40'
Linja 110kV	231	130	101	119	41	12	34	2	20	3	290h
Linja gjithsej	341	185	156	182	63	17	36	2	37	4	

N/stacione	stakime gjithsej	tranzitore	qendru eshme	kushte atmosfer.	probleme vaji,gazi	paisje primare	mbrojtja	SHAM SHAF	personel	te ndryshme	kohe zgjatja
AUTO, TR	29	11	18	2	3	10	5	6	2	1	31h 40'

e) Masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike dhe

ë) masat e përshtatshme, në rast nevoje, të rritjes së sigorisë së furnizimit.

Masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve të furnizimit, si dhe masa të tjera në rast nevoje për të ruajtur sigurinë e punës së Sistemit përmblihen në të ashtuquajturat veprime përmirësuese, që paraqesin masat e zbatuara nga OST-ja, në mënyrë për të ruajtur sigurinë operationale. Në veçanti, veprimet përmirësuese shërbejnë për të përmbushur kriterin (N-1) dhe për të ruajtur limitet e sigorisë operationale. Ato kategorizohen si veprime përmirësuese para-avari (dmth parandaluese) ose pas-avari (dmth korrigjuese ose kurative) brenda zonës së kontrollit të OST-së ose ndërmjet OST-ve të ndërlidhura.

Veprimet përmirësuese parandaluese zbatohen normalisht në stadin e planifikimit operational ose të skedulimit, për të ruajtur gjëndjen normale të Sistemit në situatën e ardhshme operative, dhe për të parandaluar përhapjen e avarive jashtë zonës së përgjegjësisë të OST. Veprimet përmirësuese parandaluese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në sa më poshtë:

- Veprime të ri-dispeçimit (të aggregateve) ose të lejimit të tregtimit në kah të kundërt, kur është e mundur;
- Ndryshime në topologjinë e rrjetit;
- Komutime manuale të pajisjeve të energjisë reaktive (ancafkat e transformatorëve, reaktorët, bllloqet e kondensatorëve statikë, ose ndryshimin e nivelit të set-point të kontrolloreve të tyre;
- Kërkesës për suport shtesë të energjisë reaktive nga centralet;
- Mundësisë së skemave disponibël të sistemit të mbrojtjes (SHAM).

Veprimet përmirësuese korrigjuese janë veprime, të cilat zbatohen menjëherë ose relativisht shpejt pas ndodhjes së një emergjence, e cila çon në një gjëndje të ndryshme nga situata normale. Me veprimet korrigjuese Sistemi do të kthehet përsëri në gjëndje normale. Veprimet përmirësuese korrigjuese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në sa më poshtë:

- Veprime të ri-dispeçimit ose të tregtimit në kah të kundërt, duke përfshirë aktivizimin e rezervave të OST-së;
- Kontroll të pajisjeve të energjisë reaktive (ancafkat e transformatorëve, reaktorët, blloqet e kondensatorëve, etj);
- Menaxhim të tensionit me anë të gjenerim/absorbimit të energjisë reaktive nga centralet;
- Veprime të skemave të sistemit të mbrojtjes, p.sh. ndryshimi i topologjisë së rrjetit, kufizim i prodhimit apo i ngarkesës, në varësi të specifikimeve të mbrojtjes.

Plani i Sistemit të Mbrojtjes në rast të Situatës në Emergjencë

Siguria operationale nënkupton aftësinë për të siguruar funksionimin normal të Sistemit, për të kufizuar kohëzgjatjen dhe numrin e ç'rregullimeve, për të parandaluar shqetësime të mëdha, dhe për të kufizuar pasojat e një shqetësimi të madhë në rast se kjo ndodh, dhe gjithashtu me qëllim për të lehtësuar Rivendosjen e Sistemit pas një shqetësimi të madhë (black-out), për kthimin e Sistemit në funksionimin normal.

Plani i mbrojtjes së Sistemit është i lidhur me një gjëndje emergjente, me procesin relevant të informacionit dhe veprimeve përmirësuese dhe përbëhet nga një sërë masash të koordinuara, të cilat synojnë të mbajnë integritetin e Sistemit, në rast të kushteve që rezultojnë nga trazirat ekstreme.

Masat e Planit të Mbrojtjes së Sistemit

Masat e Planit të Mbrojtjes së Sistemit paraqiten si veprime emergjente përmirësuese. Në vijim, jepen shembuj të masave të aplikueshme të Planit të Mbrojtjes së Sistemit në rastet e kufizimeve për ngarkesën, frekuencën, flukset e energjisë dhe të tensionit.

Kufizime të ngarkesës/frekuencës

- Lëshimi ose ndalimi i njësive të prodhimit të energjisë;
- Rritja ose zvogëlimi (automatiksht ose me kërkesë) i nivelit të prodhimit të njësive gjeneruese;
- Përshtatja e mënyrës së kontrollit të LFC aktive;
- Përdorimi manual apo automatik i reduktimeve, shkarkimit të ngarkesës;
- Ndryshimet e pikave të punës të rregullatorëve të tensionit të transformatorëve në nivelin e shpërndarjes.

Kufizime të fluksit të energjisë

- Anullimi i remonteve të elementëve të rrjetit dhe vënia në punë sa më urgjentisht që të jetë e mundur;
- Stakimi automatik i njësisë (gjeneruese) që aktivizohet nga stakimi i një linje relevante të transmetimit;
- Tregtimi në kah të kundërt me zonat fqinje të përgjegjësisë;
- Ndërhyrja në skedulim;
- Ngrirja e shkëmbimeve të planifikuara;

- Reduktimi i programit të shkëmbimit;
- Reduktimi i kapaciteteve të interkonjeksionit;
- Shkarkimi manual i ngarkesës i objekteve me marrëveshje për ndërprerje;
- Shkarkimi automatik i objekteve me marrëveshje për ndërprerje, shkaktuar nga stakimi i një linje transmetimi;
- Shkarkimi i mëtejshëm i ngarkesës në varësi të situatës.

Kufizimet e tensionit

- Kërkesa për vlera maksimale apo minimale të gjenerimit të fuqisë aktive dhe reaktive;
 - Zvogëlimi i fuqisë aktive në favor të prodhimit shtesë të fuqisë reaktive;
 - Parandalimi i njërive me ofrimin, injektimin e energjisë reaktive shtesë;
 - Stopimi i optimizimit të tensionit dhe energjisë reaktive;
 - Ndalimi i mirëmbajtjes, dhe kycja e elementëve që më parë ishin në remont;
- Bllokimi i pozicionit të ancafkave në transformatorët me rregullim nën ngarkesë.

1.5 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.)

Shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i licencuar nga ERE sipas dispozitave të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi asetet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, ku kufiri i tij me sistemin e transmetimit është ai i përcaktuar në ligj.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes; përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike; mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar. Në përputhje me Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike, OSHEE sh.a. prokuron energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ERE dhe nëpërmjet platformës elektronike për procedurat e blerjes së energjisë.

Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe VKM Nr. 244, datë 30.3.2016, OSHEE sh. a ka vijuar të kryejë funksionin e Furnizuesit të Shërbimit Universal për nevojat e klienteve fundore që përfitojnë nga ky shërbim.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE sh.a.) është organizuar në 11 Zona Shpërndarje dhe 42 Agjenci .

Më poshtë paraqiten të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2017.

TREGUESIT E ENERGJISË SË FURNIZUAR,SHITUR DHE HUMBUR NË ÇDO RAJON E AGJENCI TË OSHEE sha PËR VITIN 2017 (MWh)						
Rajonet	Axhensite	Energjia e Blere MWh		Energjia e Shitur MWh		Energji e Humbur MWh
TIRANE	Tirana1	2,258,918	804,424	1,857,544	704,114	100,310
	Tirana2		820,031		655,059	164,972
	Tirana3		634,463		498,372	136,091
DURRES	Durres	847,610	386,737	622,670	308,878	77,858
	Kavaje		144,184		109,331	34,853
	Kruje		160,324		91,671	68,653
	Shijak		156,365		112,789	43,576
FIER	Ballsh	411,423	57,916	337,216	46,755	11,161
	Fier		286,530		237,947	48,583
	Patos		66,977		52,514	14,463
ELBASAN	Elbasan	392,706	290,502	315,148	238,496	52,006
	Gramsh		19,374		16,779	2,595
	Librazhd		49,581		36,569	13,011
	Peqin		33,250		23,304	9,946
KORÇE	Bilisht	306,555	36,477	241,298	29,517	6,960
	Kolonje		12,960		9,673	3,287
	Korce		181,520		142,354	39,167
	Pogradec		75,597		59,754	15,843
GJIROKASTER	Delvine	281,149	17,588	224,337	14,212	3,376
	Gjirokaster		100,810		80,934	19,877
	Permet		23,278		18,735	4,543
	Saranda		105,391		87,488	17,903
	Tepelene		34,082		22,968	11,114
SHKODER	Koplik	665,138	59,922	367,328	26,259	33,662
	Lezhe		160,460		94,162	66,299
	Puke		28,798		11,203	17,595
	Shkoder		415,958		235,705	180,253
BERAT	Berat	363,067	126,247	289,843	103,702	22,545
	Kuçove		47,209		38,476	8,734
	Lushnje		165,470		129,244	36,226
	Skrapar		24,141		18,422	5,719
KUKES	Has	158,746	26,566	68,767	11,095	15,471
	Kukes		82,097		44,133	37,963
	Tropoje		50,084		13,539	36,545
BURREL	Bulqize	341,839	48,070	217,245	41,521	6,550
	Diber(Peshkopi)		62,254		35,893	26,361
	Lac		146,504		90,049	56,454
	Mat (Burrel)		50,445		30,014	20,431
	Mirdite		34,566		19,767	14,799
VLORE	Himare	326,045	19,795	236,992	16,151	3,644
	Selenice		39,370		18,153	21,217
	Vlore		266,880		202,688	64,191
SHUMA			6,353,198		4,778,389	1,574,809

Figure 31 Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2017





Figure 32 Sasia në Furnizim, Shitje dhe humbje të Energjisë Elektrike në Rajonet dhe Agjensite e Rrjetit të Shpërndarjes (Burimi: OSHEE sh.a).




Figure 33 Shpërndarja e Numrit të Klientëve

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna mbi Linjat, Kabinat dhe Transformatorët në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2017.

NENSTACIONE ,KABINA DHE TRANSFORMATORE	
Numri i Nënstacioneve	175
Numri i transformatoreve ne nenstacione	323
Numri i Kabinave total	25,776
Numri i Transformatorëve TM /TU	25,995

Gjatesia Totale e rrjetit TM (km)	16,486
Linja 35 kV (km) Ajrore	1,127
Linja 35 Kv (km) Kablllore	14
Linja 20 Kv (km) Ajrore	161
Linja 20 Kv (km) Kablllore	1,841
Linja 10 Kv (km) Ajrore	7,494

Linja 10 Kv (km) Kablllore	241
Linja 6 Kv (km) Ajrore	5,318
Linja 6 Kv (km) Kablllore	290

Gjatesia Totale e rrjetit TU (km)	25,179
ajror me percjelles te xhveshur (km)	20,942
ajror me kabell ABC(km)	2,729
kabllor nentokesor (km)	1,508
Rrjeti shpërndarës 0.4 kV	28,800

KABINAT	SHPERNDARJA SIPAS TIPIT DHE PRONESISE SE KABINAVE (%)												
	METALIKE			MURATURE			BOX			SHTYLLLORE			TOTAL %
	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	
Gjithsej	1.5	1.1	0.0	13.0	14.7	13.2	0.1	0.2	4.6	29.7	21.5	0.3	100
Pronesi OSHEE	1.1	0.8	0.0	7.2	10.7	7.4	0.0	0.2	4.4	7.9	8.9	0.2	48.7
Pronesi Jo e OSHEE	0.4	0.3	0.0	5.8	4.0	5.8	0.1	0.1	0.3	21.8	12.6	0.1	51.3

Figure 34 Të dhëna mbi asetet kryesore të OSHEE (Burimi: OSHEE).

Treguesit e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për vitin 2017 paraqiten në tabelën në vijim:

TABELA PERMBLEDHESE ME TE DHENA TE OSHEE Sh.a VITI 2017			Progressive
A	Energji Totale ne OSHEE Sh.a (MWh)	A=A.1+A.2	6,498,515
A.1	Energji e transmetuar nepermjet OST per llogari te OSHEE Sh.a	A.1=Sum(A.1.1+A.1.5)	6,026,763
A.1.1	Nga KESH -Gen nepermjet OST		2,904,988
A.1.2	Nga OST si import i OSHEE Sh.a		2,539,417
A.1.3	Nga OST per llogari te klienteve te OSHEE Sh.a prodhuar nga HEC-et ne rrjetin e trans.		582,358
A.1.4	Nga TEC VLORA nepermjet OST		n/a
A.1.5	Nga Bistrica 1,2 nepermjet OST		n/a
A.2	Energji e transmetuar direkt ne rrjetin e OSHEE Sh.a	A.2=A.2.1+A.2.2	471,752
A.2.1	HEC Ulez,Lanabregas		31,724
A.2.2	Impjantet Private/me Koncesion		440,027
B	Energji Totale ne Rrjetin e Shperndarjes (MWh)	B=A-A.1.3	6,498,515
C	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (MWh)	C=C.1+C.2+C.3	1,716,517
C.1	Humbje Teknike njesite e TL (MWh)		141,707
C.2	Humbje Teknike ne Zona (MWh)		1,106,007
C.3	Humbje JoTeknike ne Zona (MWh)		468,802
C.1	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (%)	C.1= C / B	26.41%
C.1.1	Humbje Teknike njesite e TL (%)		2.18%
C.2.1	Humbje Teknike ne Zona (%)		17.41%
C.3.1	Humbje JoTeknike ne Zona (%)		7.21%
D	Energjia e shitur per te gjithë konsumatorët e OSHEE Sh.a	D=D.1+D.2+D.3+D.4	4,781,998
D.1	Shitur Klienteve Private (MWh)	D.1=D.1.1+D.1.2+D.1.3	1,584,743
D.1.1	Shitur nga rrjeti i Transmetimit per llogari te OSHEE Sh.a		-
D.1.2	Shitur per nevoja te veta te OSHEE Sh.a		7,129
D.1.3	Shitur Klienteve Private (pa ate per nevoja te veta dhe Ne TL)		1,577,614
D.2	Shitur Klienteve JoBuxhetore (MWh)		324,698
D.3	Shitur Klienteve Buxhetore (MWh)		217,141
D.4	Shitur Klienteve Familjare (MWh)	D.4=D.4.1+D.4.2+D.4.3	2,655,417
D.4.2	Shitur Klienteve Familjare (MWh)		2,581,632
D.4.3	Shitur Klienteve Familjare per Ambjentet e Perbashketa		73,785
E	Faturuar muaji Parardhes (000/leke)		63,594,597
F	Arketimet e muajit aktual (000 leke)	G=F.1+F.2+F.3+F.4	61,402,582
F.1	Arketuar per faturat korrente te vitit aktual		40,817,943
F.3	Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual		15,470,174
F.4	Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara		5,413,523
F.1	Arketimet e muajit aktual (%)	F.1=F / E	96.6%
F.1.1	Arketuar per faturat korrente te vitit aktual (%)	F.1.1=F.1/E	64.2%
F.1.3	Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual (%)	F.1.3=F.3/E	24.3%
F.1.4	Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara (%)	F.1.4=F.4/E	8.5%
G	Faturuar muaji Raportues (000/leke)		63,531,145
1	Nr. Konsumatoreve gjithsej (Nr.)		1,209,958
2	Fatura te emetuara me lexim konsumi (Nr.)		11,664,625
3	Sasia e energjise se faturuar me lexim konsumi (MWh)		4,777,087
4	Fatura te emetuara me lexim "0" (Nr.)		2,903,348
5	Nr.Faturave te emetuara pa lexim (energji e pa matur) (Nr.)		14
6	Sasia e energjise se faturuar si energji e pamatur (MWh)		1,301
7	Nr.Faturave te emetuara pa lexim (dem ekonomik) (Nr.)		3
8	Shuma e faturuar si dem ekonomik (000/leke)		(38,805)
9	Nr.Faturave per te cilat eshte arketuar kamat vonese (Nr.)		5,198,173
10	Vlera e Kamat vonesave te arketuara (000/leke)		1,101,386

Figure 35 Të dhënat mbi treguesit e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes gjatë vitit 2017.

Nga rezultatet e vitit 2017 evidentohet një performacë në rritje në drejtim të uljes së humbjeve dhe rritjes së nivelit të arkëtimeve. Në paragrafet e mëposhtme paraqiten analizat e këtyre rezultateve.

1.6 Konsumi i Energjisë Elektrike

Konsumi total vjetor i energjisë elektrike (duke përfshirë edhe konsumin e klientëve në treg të parregulluar) në Shqipëri për periudhën 2003 deri në 2017 paraqitet në mënyrë grafike me poshtë.




Figure 36 Konsumi i përgjithshëm në vite.

Siç vërehet në paraqitjen grafike rezulton një rritje e konsumit në krahasim me vitin 2016.

Në tabelat vijuese jepen treguesit e sintetizuar nga operatorët publik (OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.) të sistemit energjetik në Shqipëri.

TABELA PERMBLEDHËSE ME TË DHËNA TE OSHEE Sh.a VITI 2017			Progresive
A	Energji Totale ne OSHEE Sh.a (MWh)	A=A.1+A.2	6,498,515
A.1	Energji e transmetuar nepermjet OST per llogari te OSHEE Sh.a	A.1=Sum(A.11A.15)	6,026,763
A.1.1	Nga KESH-Gen nepermjet OST		2,904,988
A.1.2	Nga OST si import i OSHEE Sh.a		2,539,417
A.1.3	Nga OST per llogari te klienteve te OSHEE Sh.a prodhuar nga HEC-et ne rrjetin e trans.		582,358
A.1.4	Nga TEC VLORA nepermjet OST		n/a
A.1.5	Nga Bistrica 1,2 nepermjet OST		n/a
A.2	Energji e transmetuar direkt ne rrjetin e OSHEE Sh.a	A.2=A.2.1+A.2.2	471,752
A.2.1	HEC Ulez,Lanabregas		31,724
A.2.2	Impjantet Private/me Koncesion		440,027
B	Energji Totale ne Rrjetin e Shperndarjes (MWh)	B=A-A.1.3	6,498,515
C	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (MWh)	C=C.1+C.2+C.3	1,716,517
C.1	Humbje Teknikë njesite e TL (MWh)		141,707
C.2	Humbje Teknikë ne Zona (MWh)		1,106,007
C.3	Humbje Jo Teknikë ne Zona (MWh)		468,802
C.1	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (%)	C.1= C/B	26.41%
C.1.1	Humbje Teknikë njesite e TL (%)		2.18%
C.2.1	Humbje Teknikë ne Zona (%)		17.41%
C.3.1	Humbje Jo Teknikë ne Zona (%)		7.21%
D	Energjia e shitur per te gjithë konsumatorët e OSHEE Sh.a	D=D.1+D.2+D.3+D.4	4,781,998
D.1	Shitur Klienteve Private (MWh)	D.1=D.1.1+D.1.2+D.1.3	1,584,743
D.1.1	Shitur nga rrjeti i Transmetimit per llogari te OSHEE Sh.a		-
D.1.2	Shitur per nevoja te veta te OSHEE Sh.a		7,129
D.1.3	Shitur Klienteve Private (pa ate per nevoja te veta dhe Ne TL)		1,577,614
D.2	Shitur Klienteve JoBuxhetore (MWh)		324,698
D.3	Shitur Klienteve Buxhetore (MWh)		217,141
D.4	Shitur Klienteve Familjare (MWh)	D.4=D.4.1+D.4.2+D.4.3	2,655,417
D.4.2	Shitur Klienteve Familjare (MWh)		2,581,632
D.4.3	Shitur Klienteve Familjare per Ambientet e Perbashketa		73,785
E	Faturuar muaji Parardhes (000/leke)		63,594,597
F	Arketimet e muajit aktual (000 leke)	G=F.1+F.2+F.3+F.4	61,402,582
F.1	Arketuar per faturat korrente te vitit aktual		40,817,943
F.3	Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual		15,470,174
F.4	Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara		5,413,523
F.1	Arketimet e muajit aktual (%)	F.1=F/E	96.6%
F.1.1	Arketuar per faturat korrente te vitit aktual (%)	F.1.1=F.1/E	64.2%
F.1.3	Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual (%)	F.1.3=F.3/E	24.3%
F.1.4	Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara (%)	F.1.4=F.4/E	8.5%
G	Faturuar muaji Raportues (000/leke)		63,531,145

BILANCI OST sha 2017 (MWh)		
		2017
Dhënë nga KESH në transmetim	1	2,915,081
Dhënë nga HEC-et e vogla në transmetim	2	122,687
Dhënë nga HEC-et e lidhura në transmetim	3	407,832
Dhënë nga HEC Peshqesh	4	79,579
Dhënë nga HEC Banje	5	140,866
Dhënë nga HEC FANG		47,049
Dhënë nga HEC Ashta	6	174,527
Dhënë nga KURUM to Transmission (Ulez-Shkopet&Bistrica1,2)	7	286,579
Dhënë në interkoniuksion (-)	D	488,415
Marrë Dhëne në Interkoniuksion (+)	R	3,403,043
Balanca totale në Interkoniuksion	6=(R-D)	2,914,628
Totali në marrje në transmetim	7=(1+2+3+4+5+6+7+R)	7,577,242
Humbjet në transmetim (përfshirë dhe nevojat vetjake)	8	157,906
Humbjet në transmetim (%)	9=8/7	2.08
Totali në dhënie në transmetim	10=(7-8)	7,419,336
Dhënë në Interkoniuksion (-)	11=D	488,415
Dhënë për klientët e lidhur në transmetim		781,471
EL Kurum		242,873
Fushe Arrez		324
Titan		98,965
F.Kruje 220 kv		118,439
NST 220/6.3 Colacem		11,964
ACR		147,849
FECR		24,643
NST 220kV Mogjice		12,126
Hec Peshqesh		277
Hec Ashta		72
Hec BANJE		223
Hec FANG		24
Gjenerim KURUM		212
Tec Ballsh T1		48,814
Ferro Krom		74,666
Dhënë për sistemin e shpërndarjes së energjisë		6,149,450
Dhënë për sistemin e shpërndarjes së energjisë (niveli 110 kV)		4,945,007
Dhënë për sistemin e shpërndarjes së energjisë (niveli 35 kV)		773,948
Dhënë për sistemin e shpërndarjes së energjisë (Tension i mesëm)		430,495

Figure 37 Treguesit nga operatorët kryesore të sistemit energjetik në Shqipëri 2017.

Bazuar në të dhënat e mësipërme të tabelave dhe informacioneve periodike apo specifike të operatorëve të tregut të energjisë u ndërtua Bilanci Energjetik për vitin 2017 si më poshtë.

BILANCI ENERGETIK 2017 (MWh)												
	Neto KESH	Blerje ne Treg te hapur OSHEE	Neto (Selit)	HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OSHEE	HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OST	UKKO	Neto Ashta	Neto Banja	Neto KURUM	H/C Peshqesh	H/C Fangu	Prodhim neto vendas
	2,916,989		31,724	440,028	407,832		174,527	140,866	286,579	79,579	47,049	4,525,173
Ballanca e shkembimeve.	158,922											
Shitur OST per Humbje+konsum vetiak	-157,906											
Dhene Tec Vlora	-1,908	2,539,417										
Devijime nga Programi i Interkoneksionit	-1,265											
Energji per sherbime ndihmese+disbalancat (na OSHEE)	-14,317											
Diferenca (sherbime ndihmese e balancimi KESH-OSHEE)	4,471											
Energji per OSHEE sha	2,904,986	2,539,417	31,724	440,028	407,832	0	174,527					
								140,866	286,579	79,579	47,049	
				6,498,514								
	0			6,498,514								Energji e marrë nga interkoneksioni
												2,914,628
Shitur Kons Familjare	2,655,417		4,781,998									
Shitur Kons Jo Familjare	2,126,581											
Humbje tekn TL	141,707			6,498,514								
Humbje teknike ne zona	1,106,007		1,716,516									
Humbje Jo teknike ne zona	468,802											
Konsumi i OSHEE				6,498,514								
Konsumuar nga Klientet ne TL ("kualifikuar")				781,472								
Konsumuar nga TEC Vlora 2017				1,908								
Konsumuar nga OST (humbje +nevoja vetiake)				157,906								
KONSUMI TOTAL 2017				7,439,800								Konsumi total vendas
												7,439,800
												Burimi OST ,OSHEE sha

*Diferenca e energjisë balancuese KESH-OSHEE është objekt në shqyrtim nga ERE për zgjidhjen e mosmarrveshjes mes palëve.

Figure 38 Bilanci Energetik viti 2017.

PRODHIMI NETO NE SHQIPERI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Progresivi 2017
Prodhimi Neto KESH Gen.	477,984	292,224	298,093	363,534	200,024	399,225	151,908	97,095	50,691	235,551	91,369	259,293	2,916,991
Hec-et Private dhe Konc. (Rrjeti Shtetdardjes)	22,495	49,050	73,302	59,927	51,481	26,088	9,062	5,296	8,812	11,565	35,828	87,120	440,026
Hec-et Private dhe Konc. (Rrjeti Transmetimit)	19,301	47,302	66,771	58,359	51,523	25,641	7,627	3,057	5,174	10,914	27,156	85,007	407,832
HEC Ashta	24,792	20,138	18,974	21,156	12,011	19,584	7,406	3,572	3,402	12,590	6,731	24,170	174,526
Prodhimi Neto Hec Lanabregas	2,622	2,897	3,303	3,120	3,037	2,830	2,397	1,937	1,737	1,816	2,294	3,736	31,725
Prodhimi Neto (Hec Ulez,Shkopet,Bistrica 1,2)	21,378	28,017	43,116	38,597	25,991	18,026	12,908	11,367	10,678	11,159	15,316	50,026	286,579
Prodhimi Hec Peshqesh	5,980	13,496	13,238	8,529	5,688	2,791	1,571	800	1,568	3,238	4,204	18,475	79,578
Prodhimi Hec Fangu											181	46,867	47,048
Prodhimi Hec Banja	20,359	6,332	16,690	8,096	9,297	9,452	11,931	4,159	4,013	7,524	8,711	34,303	140,866
ENERGJIA NETO E PRODHUAR NE SHQIPERI	594,911	459,456	533,487	561,317	359,051	503,638	204,811	127,282	86,075	294,357	191,790	608,997	4,525,172
ENERGJI NGA INTERKONEKSIONI													
Energji ne dhene nga Interkoneksioni	86,276	51,274	52,903	74,794	18,594	77,019	1,030	1,229	1,863	35,846	4,743	82,844	488,415
Energji ne marrje nga Interkoneksioni	266,571	212,046	142,529	92,369	219,890	146,509	403,826	497,226	443,461	308,922	443,177	226,517	3,403,043
Ballanca Hyrje/Dalje nga Interkoneksioni	180,296	160,772	89,626	17,575	201,296	69,490	402,795	495,997	441,597	273,076	438,434	143,673	2,914,628
KONSUMI I ENERGJISE NE SHQIPERI													
Konsumuar nga OSHEE (SHITJE+HUMBJE)	715,886	562,270	545,214	493,731	475,055	485,386	529,805	543,145	451,103	482,629	546,256	668,034	6,498,515
Konsumuar nga OST (humbje+konsum vetiak)	16,207	12,302	13,897	13,615	12,001	13,364	12,532	13,886	10,460	10,709	11,783	17,149	157,906
Konsumuar nga TEC Vlora	195	157	171	149	161	147	154	153	149	156	152	164	1,908
Konsumuar nga Klientet e "Kualifikuar"	42,918	45,498	63,832	71,397	73,130	74,230	65,114	66,094	65,957	73,939	72,034	67,326	781,470
KONSUMUAR NE SHQIPERI	775,207	620,228	623,114	578,892	560,347	573,128	607,606	623,278	527,668	567,434	630,225	752,673	7,439,799
													Burimi OST ,OSHEE sha




Figure 39 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës Import-Eksport në konsumin total të energjisë në Shqipëri.

1.6.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike

Në figurën e mëposhtme paraqiten peshat specifike në faturim që zënë kategoritë e klientëve tariforë.





Figure 40 Raportet e Faturimit sipas Kategorive të klientëve 2017.





Figure 41 Klientet Familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite.

Klientet privatë zënë 32.89 % te faturimit total te OSHEE sh.a.,

Një peshë të rëndësishme në konsumin e energjisë elektrike zënë edhe konsumatorët buxhetorë dhe jo buxhetorë të cilët zënë rreth 11.46 % të faturimit total të OSHEE sh.a.,

Në vendin tonë konsumi familjar në raport me konsumin e përgjithshëm të faturuar për klientet tariforë për vitin 2017 përbën rreth 55.57 %,

Konsumi vetiak 0.07 %

1.6.2 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike

Nga studimi i profilit vjetor të konsumit të energjisë elektrike, tipari karakteristik i këtij profili është simetria thuasje e plotë e konsumit dimër – verë.

Ashtu sikurse në raportimet e viteve të mëparshme, edhe këtë vit vërehet i njëjti fenomen, ai e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje në dimër. Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht prej efektit të përdorimi ose mospërdorimit të ngrohjes me energji elektrike të banesës.

Gjatë stinës së verës, në muajt korrik dhe gusht tendenca e pikut është në rritje, i cili nga viti në vit po bëhet më evident dhe lidhet me përdorimin gjithnjë e në shkallë më të gjerë të pajisjeve klimatizuese.

Më poshtë paraqiten të dhënat e konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2017 krahasuar me të dhënat mesatare të periudhës 2007-2016.



Figure 42 Konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2017.

Në grafikun më poshtë jepet profili mesatar ditor me bazë orare të ngarkesës për vitin 2017.



Figure 43 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2017.

PIKU I NGARKESËS (1 424 MW) datë 12.01.2017 ora 19:00




Figure 44 Profili dhe minimumi i ngarkesës në prill 2017 (MW)

NGARKESA MINIMALE (408 MW) datë 22.04.2017 ora 05:00

1.7 Blerjet e Energjisë Elektrike në Treg të Parregulluar

Në zbatim të kërkesave të VKM Nr.244 datë 30.03.2016 i ndryshuar, rregullave të tregut dhe rregullores për shit-blerjen e energjisë elektrike, blerjet e energjisë elektrike në tregun e parregulluar, përfshire importet, janë kryer nga OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a në përmbushje të detyrimit të shërbimit publik për klientët tariforë dhe optimizimin e portofolit. Më poshtë po paraqesim një tabelë me të dhëna historike të blerjeve në tregun e parregulluar.

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
ENERGJI E BLERE NË TREG TË HAPUR NGA KESH & OSSH (GWh)	2072	937	567	365	633	2828	2417	1884	1911	3262	2538	1424	2814	1900	1092	2947

	SASIA MWh	Çmimi Euro/MWh	Vlera pa TVSH (Euro)
TOTAL BLERJE KESH SH.A.VITI 2017	407,970	58.63	23,918,934
TOTAL BLERJE OSHEE SH.A. VITI 2017	2,539,417	66.26	168,258,307
	2 947 387192		

Sqarojmë se KESH sha ka shitur dhe ka blerë energji për optimizim portofoli sipas të dhënave të tabelës së më poshtëme

Transaksione për optimizim portofoli të KESH gjatë 2017					
2017		MWh	Çmimi Euro/MWh	Vlera pa TVSH (Euro)	përfitimi nga transaksioni
Prill	shitur	15,120	46.72	706,352	144,961
	blerë	15,120	37.13	561,391	
Qershor	shitur	18,900	51.27	969,041	277,496
	blerë	18,450	37	691,545	
Tetor	shitur	17,850	66.69	1,190,469	242,805
	blerë	17,850	53.09	947,664	

Në grafikun e Figurës 45 është paraqitur balanca (hyrje – dalje) import-eksport e energjisë elektrike për periudhën 1986 – 2017.

Për periudhën 1986-2017, 10-vjeçarin e fundit, me përjashtim të vitit 2010 dhe 2016 vendi ynë rezulton të jetë një importues neto i energjisë elektrike. Sqarojmë se vlerat e paraqitura përfaqësojnë të gjitha flukset hyrëse e dalëse nga të gjithë aktorët e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.




Figure 45 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite (Burimi: OST sh.a.).ktiviteti i Shitjes së Energjisë Elektrike nga OSHEE sha


Gjatë vitit 2017 efektiviteti i shitjes të energjisë elektrike vazhdon në vlera të rritura në referencë gjithnjë të faktorëve përcaktues në nivelin e efijçencës së konsumit të energjisë elektrike të cilët janë:

1. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje.
2. Niveli i arkëtimeve të energjisë elektrike së faturuar.

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga Kompania për vitin 2017, arrijnë në 26.41%, duke shënuar një rënie të ndjeshme krahasuar edhe me vitin 2016.

Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga OSHEE sh.a. është 96.6 % kundrejt energjisë elektrike të faturuar për vitin 2017 (shih tabelën e Faturim Arkëtimeve më poshtë)

Kjo shifër përfshin edhe arkëtimet e prapambetura të periudhës 2007-2016 në vleftën **10 562 200 000 lekë**.







Figure 46 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2017.




Figure 47 Niveli i Arkëtimeve Mujore në periudhën 2011-2017.

PERFORMANCA E OPERATOTRIT TE SHPERNDARJES 2009-2017 (%)													
NIVELI I HUMBJEVE (%) 2009-2017													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
2009	40.75	37.05	38.05	32.93	33.44	30.75	32.60	30.20	25.34	30.67	33.44	36.89	
2010	38.62	35.41	36.90	31.37	35.17	31.45	26.94	29.69	21.47	20.61	22.16	29.05	
2011	55.55	38.00	36.95	23.11	24.85	21.29	21.88	19.41	22.95	25.15	32.20	35.70	
2012	35.72	59.16	55.23	45.41	38.87	39.77	45.51	45.51	42.09	35.53	41.89	49.32	
2013	51.12	48.71	48.29	39.66	39.52	40.33	43.33	38.50	35.08	45.98	48.08	53.04	
2014	47.00	42.14	42.78	35.69	36.85	34.10	36.59	36.36	31.67	34.52	32.88	37.54	
2015	36.68	31.82	32.88	30.54	31.24	28.60	30.62	29.29	25.30	29.92	30.82	34.50	
2016	34.69	29.00	29.93	26.07	26.97	24.35	25.97	25.15	22.12	27.11	29.30	30.99	
2017	33.50	27.63	28.66	25.81	25.88	28.31	24.69	23.29	19.79	23.76	23.55	27.90	26.41
Niveli i Arketimeve (%) 2009-2017													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
2009	69.32	85.95	74.38	86.58	86.31	76.37	75.40	72.46	83.20	80.82	61.77	70.01	
2010	55.37	66.28	86.63	89.46	86.70	79.42	74.84	124.98	84.20	70.81	56.15	66.48	
2011	67.26	57.61	87.66	71.61	96.73	73.00	65.00	81.00	66.00	63.86	51.47	87.30	
2012	59.80	79.20	78.50	78.00	94.70	83.50	91.60	102.90	74.00	98.00	72.60	78.00	
2013	61.40	63.70	86.20	80.70	79.10	69.60	87.90	90.10	78.50	84.30	89.00	102.00	
2014	84.90	77.10	85.90	85.50	81.90	80.20	86.70	83.60	102.60	101.00	101.90	141.00	
2015	112.70	120.50	103.70	86.60	95.70	97.10	98.40	104.70	95.30	100.30	92.20	100.70	
2016	92.10	87.00	95.60	90.10	99.10	92.00	94.20	96.70	91.50	96.70	90.30	96.70	
2017	85.20	87.60	105.70	94.50	105.70	91.80	104.80	97.40	94.60	103.80	92.70	100.10	96.6
Efektiviteti i shitjeve (%) 2009-2017													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
2009	41.1%	54.1%	46.1%	58.1%	57.4%	52.9%	50.8%	50.6%	62.1%	56.0%	41.1%	44.2%	
2010	34.0%	42.8%	54.7%	61.4%	56.2%	54.4%	54.7%	87.9%	66.1%	56.2%	43.7%	47.2%	
2011	29.9%	35.7%	55.3%	55.1%	72.7%	57.5%	50.8%	65.3%	50.9%	47.8%	34.9%	56.1%	
2012	38.4%	32.3%	35.1%	42.6%	57.9%	50.3%	49.9%	56.1%	42.9%	63.2%	42.2%	39.5%	
2013	30.0%	32.7%	44.6%	48.7%	47.8%	41.5%	49.8%	55.4%	51.0%	45.5%	46.2%	47.9%	
2014	45.0%	44.6%	49.2%	55.0%	51.7%	52.9%	55.0%	53.2%	70.1%	66.1%	68.4%	88.1%	
2015	71.4%	82.2%	69.6%	60.2%	65.8%	69.3%	68.3%	74.0%	71.2%	70.3%	63.8%	66.0%	
2016	60.2%	61.8%	67.0%	66.6%	72.4%	69.6%	69.7%	72.4%	71.3%	70.5%	63.8%	66.7%	
2017	56.7%	63.4%	75.4%	70.1%	78.3%	65.8%	78.9%	74.7%	75.9%	79.1%	70.9%	72.2%	71.1%

Figure 48 Ecuria treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatortit të Shpërndarjes (%)

Efektiviteti i shitjeve praktikisht përfaqeson energjinë që është shitur dhe arkëtuar.

Efektiviteti i shitjeve për periudhën 2009-2017 jepet në grafikun e mëposhtëm.




Figure 49 Efektiviteti i shitjeve të OSHEE 2009-2017 (Burim: OSHEE).




Figure 50 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergetik.

Në figurën 50 është paraqitur ecuria e humbjeve totale përfshirë ato në sistemin e transmetimit, gjatë periudhës 2002 – 2017, kurse në grafikun e figurës 51 është paraqitur marrëdhënia e faturim-arkëtimeve gjatë së njëjtës periudhë.




Figure 51 Faturimi/Arkëtimi 2002-2017 me TVSH (Burimi: OSHEE sh.a.).

SITUATA E INVESTIMEVE

PLANI I MIRATUAR NGA ERE I INVESTIMEVE TË OSHEE sha SIPAS ZËRAVE VITI 2017		
Nr.	Emertimi i Investimit	Viti 2017 (lekë)
I	Ndertim/rikonstruksion elektrik per Nenstacionet	833,635,887
II	Ndertim/Rikonstruksion linjash te TL	476,828,204
III	Blerje Paisje makineri per N/Stacione dhe likujdim avarish	200,000,000
IV	Ndertim rrjeti TM	78,233,000
V	Ndertim/Rikonstruksion Rrjeti TM /TU	6,795,838,054
VI	Ndertim/Rikonstruksion kabinash elektrike	1,163,205,727
VII	INVESTIMET PRIORITARE (Rrjet TU - ABC lines)	775,937,126
VIII	Teknologji Monitorimi	500,732,000
IX	INVESTIME NE MATJE	330,000,000
X	Vlera 10% qe do te paguhet nga OSHEE per investimet Bankes Boterore	214,000,000
XI	Kosto lokale per investimet e Bankes Boterore	747,856,573
	TOTALI	12,116,266,570

Janë realizuar një sërë investimesh në ndërtim rrjeti TM 20 kV, kabina elektrike të reja, rrjet TU me percjellësa ABC si dhe rikonstruksione të N/Stacioneve

Ecuria e investimeve në Rajonet OSHEE sha për vitin 2016 – 2017

Rajoni/Viti	2016		2017	
	Vlera e punimeve te kontraktuara (Leke)	Ecuria e punimeve (%)	Vlera e punimeve te Kontraktuara (Leke)	Ecuria punimeve (%)
Rajoni TIRANE	2,576,215,275	99%	842,655,859	68%
Rajoni ELBASAN	777,814,173	92%	424,136,262	91%
Rajoni BURREL	579,236,505	100%	535,724,625	80%
Rajoni SHKODER	1,297,910,175	100%	376,092,110	85%
Njesia KUKES	21,939,958	100%	42,271,043	100%
Rajoni BERAT	271,713,666	100%	55,609,647	100%
Rajoni DURRES	2,966,206,400	100%	2,942,676,124	74%
Rajoni KORCE	90,353,503	100%	233,233,035	71%
Rajoni GJIROKASTER	542,447,311	100%	522,331,016	64%
Rajoni FIER	552,773,850	99%	133,600,612	100%
Rajoni VLORË	795,330,401	100%	959,919,530	68%
Total	10,471,941,217		7,068,249,863	75%

- Informacioni i saktë mbi realizimin e investimeve të parashikuara si dhe kontabilizimit të tyre do të kryhet pas depozitimit të kopjes së audituar të pasqyrave financiare të vitit 2017 të OSHEE sha afati për të cilat është qershori 2018.
- Zbatimi i Investimeve të OSHEE sha në disa raste shtrihet në një periudhë kohore mbi një vit kalendarik.
- Nga informacioni paraprak financiar rezulton: investimet gjithsej për 2017 ishin 9,713,317 mijë leke nga të cilat 4,684,581 janë investime në proces

- Duhet të minimizohen ndryshimet në investimet e parashikuara dhe realizuar faktikisht.
- Nga studimi i raportimeve teknike rezulton se investimet e realizuara kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe furnizimit me energji elektrike.

PJESA II: Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror

2.1 Projekti TAP (Trans Adriatic Pipeline)

Projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) është një projekt madhor i cili është pjesë e sistemit të transmetimit të gazit të prodhuar nga vendburimi Shah Deniz 2 (SD 2) në Azerbajxhan drejt Tregut European të Gazit. Transportimi përmes Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë do të kryhet me anë të tubacionit South Caucasian Pipeline(SCP), ndërsa transportimi përmes Turqisë do të kryhet me anë të tubacionit TANAP (Trans Anadollian Pipeline) deri në kufirin Turko-Grek.

Transportimi i mëtejshëm do të kryhet me anë të tubacionit Trans Adriatic Pipeline (TAP). TAP do të shtrihet përmes Greqisë, Shqipërisë, në tabanin e detit Adriatik për tu bashkuar me Sistemin Italian të Transmetimit të Gazit në zonën e San Foca në Italinë Jugore çka mundëson lëvizjen e mëtejshme drejt tregjeve evropiane.

Dihet se territori ku do të merret kjo sasi gazi është nga më të mëdhatë e krahasuar me Evropën, Afrikën Veriore dhe Rusinë. Në pamjen e mëposhtme jepen rezervat që disponojnë këto rajone. (Trilion M³)



Figure 52 Pasqyrimi i Statistikave botërore për Energjinë 2017

Projekti fillimisht do të transportojë 10 bcm/vit, me mundësinë për zgjerimin më vonë të kapacitetit deri në 20 bcm/vit nëpërmjet shtimit të stacioneve të reja të kompresorëve. TAP është i projektuar gjithashtu që të mundësojnë rrjedhjen fizike të gazit në drejtim të kundërt.


Projekti TAP është zhvilluar nga kompania TAP AG. Aksionerët fillestarë të kompanisë kanë qenë: kompania Zvicerane Axpo (42.5%), kompania Norvegjeze Statoil (42.5 %) dhe kompania Gjermane E.ON Ruhrgas (15%). Statoil është gjithashtu aksionere (25,5 %) në Konsorciumin Shah Deniz që është kompania që shfrytëzon SD2.

Në 30 korrik 2013 struktura e aksionereve të TAP ndryshoi si vijon; BP (20%), SOCAR (20%), Statoil (20%), Fluxys (16%), Total (10%), E.ON (9%) dhe Axpo (5%)

Ka pasur përsëri ndryshim aksioneresh për të cilin janë njoftuar të gjithë palët e interesuara përfshi edhe tre autoritetet kombëtare, ajo Greke, Italiane dhe Shqiptare.

Disa ndryshime në pronësinë e TAP AG - sidomos, dalje e përgjithshme e Total Gas Transport Ventures S.A.S. dhe E.ON (përmes Global Commodities SE), dalja e Statoil ASA si aksionerëve dhe hyrjen e Enagás Internacional SLU dhe SNAM S.p.A (Itali). Gjatë vitit 2017 nuk ka patur ndryshime në aksionerët e këtij projekti. Aksionerët aktualë paraqiten sipas tabelën dhe grafikën e mëposhtme:

Aksionerët	Aksionerët përpara ndryshimit të parashikuar në 23 Korrik 2013	Aksionerët aktualë Për 2016	Ndryshimi
AzTAP (më parë e njohur si SOCAR GAS Pipelines GmbH)	20%	20%	0%
BP Gas Marketing Ltd	20%	20%	0%
SNAM S.p.A(Itali)	0%	20%	+20%
Fluxys Europe BV	16%	19%	+3%
Enagás Internacional S.L.U	0%	16%	+16%
Axpo Holding AG	5%	5%	0%
Total Gas Transport Ventures SAS	10%	0%	-10%
E.ON,Global Commodities SE	9%	0%	-9%
Statoil ASA	20%	0%	-20%



Aksionerët aktualë të TAP

2.2 Ecuria e deritanishme e projektit TAP-AG në Shqipëri

2.2.1 Faktet dhe Shifra deri në fund të vitit 2017

Viti 2017-të ka qene një vit ku puna për projektin TAP është intensifikuar se tepërmi dhe ku rezultatet kanë qënë konkrete dhe të dukshme. Ne jemi vëndi i parë që filluam punimet e TAP-it duke u krahasuar me dy vendet fqinje Italinë dhe Greqinë. Vëndi jonë është nga vëndet e para që ka implementuar paketën e tretë të enegjisë pa aplikuar më parë paketën e parë dhe të dytë, kjo është një sukses i jashtëzakonshëm për ne, dhe kjo ka bërë që ne, ti paraprijmë shumë problemeve komplekse që ndodhemi në zbatim të reformës në sektorin e enegjisë dhe të gazit. Pa aplikim të paketës tretë të enegjisë nuk do të kishim projekt të gazit, nuk do të kishim zbatim të projektit TAP në shqipëri, kështu u shpreh Drejtori i Sekretariatit të Enegjisë në Vienë, zoti Janez Kopac. Kjo është arritur të bëhet falë një pune të madhe të gjitha institucioneve përgjegjëse për koordinimin dhe kryerjen në kohë të gjitha kërkesat e Direktivës dhe Rregullores së gazit të Bashkimit European. Njëkohësisht ne jemi vëndi i parë që bëmë çertifikimin e TAP, të një projekti ndërkombëtar, si një vënd kandidat për në BE(vënde të Komunitetit të Enegjisë), pa sjellë asnjë pengesë edhe partnerëve tanë Italisë dhe Greqisë, vënde të cilat janë antare të BE.

Enti Rregullator i Enegjisë së Shqiperise së bashku me Entin Rregullator të Greqisë dhe Italisë, janë në koherencë të plotë në marrëdhënien e përditëshme me projektin dhe kanë marrë vendime të përbashkëta në lidhje me projektin TAP-AG. Këto vendime janë marë në përputhje të plotë me Direktivën e Parlamentit European dhe të Këshillit, 2009/73/EC, Rregullores (EC) N0.715/2009 , të Vendimit të Këshillit Ministreial No.D/2011/02/MC-EnC, si dhe ligjit “Për Gazin Natyror” Nr.102/2015, i cili tashmë ka reflektuar të gjitha kërkesat e Bashkimit European dhe të Vendimit të Këshillit Ministreial No.D/2011/02/MC-EnC. Më poshtë paraqitet në mënyrë skematike rrjeti ekzistues dhe ai që do të ndërtohet, ku duket qartë që vëndi jonë mer një rëndësi të veçantë në rajon duke patur parasysh që ne kemi edhe mundësi potenciale për zhvillimin e projekteve rajonale të ruajtjes nëntokësore të gazit(storage).



Figure 53 Projekti TAP dhe IAP

2.3 Gjëndja aktuale për projektin TAP në Shqipëri deri në fund të vitit 2017

2.3.1 Disa të dhëna për projektin TAP

- Rreth 215 km është gjatësia e përgjithshme e tubacionit në tokë në vëndin tonë
- Ky tubacion fillon në Bilisht Qendër në rajonin e Korçës në kufirin Grek-Shqiptar
- Vazhdon dhe zbret në zonën bregdetare në veri të Fierit, në bregun e detit Seman
- Infrastruktura tjetër është e lidhur me gazsjellësin: stacion i kompresimit në Topojë afërsi të Fierit (stacion tjetër kompresimi planifikohet në afërsi të Bilishtit për 20 miliard metra kub bcm), 8 blloqe stacione valvulash (BVS) dhe një stacion valvulash në tokë, të gjitha këto për të shtuar sigurinë e këtij projekti
- Rrugët e aksesueshme: më shumë se 175 km rrugë të cilat janë bërë (në dy faza)
- Ura: më shumë se 40 ura janë bërë riparime dhe 2 ura janë ndërtuar të reja
- Projekti përshkon rreth 555 rrugë të kryqezuara, 514 lumenj dhe 1 hekurrudhe (kryqëzime kryesore dhe sekondare)

Pika më e lartë ku do të kalojë tubacioni: 1800 m, zona e Potom në malet Shqiptare

TAP do të kalojë në territorin shqiptar në 9 male më të larta se 500 m, që do të thotë ka shkallë të lartë vështirësie në krahasim me vëndin fqinjë Greqinë

Pjerësia më e thellë: Deri në një kënd 40°, një projekt tejet i vështirë për tu aplikuar, por deri tani mjaft i sukseshëm në realizimin e tij

Pjesa më e madhe në det e thellësisë ku do të kalojë tubacioni do të jetë: 820 m në ngushticën e Otrantos në Detin Adriatik

Kosto totale e projektit TAP: 4.5 Miliard Euro, në pjesën shqiptare 1.5 miliard euro

TAP mund të rritet kapaciteti deri në 20 miliard metra kub plus duke qënë se ndodhen rezerva gazi të mjaftueshme në rajonin e Kaspikut

TAP është në gjendje që me shtesën e kapacitetit nga 10 në 20 miliard metra kub gaz në kostot marxhinale shtesë kur furnizimet e reja të vendosen në dispozicion

Konfigurimi aktual prej 10 miliard metra kub merr në konsideratë skenarin 20 miliard metra kub, përkatësisht:

- Diametrat e gazsjellësit në det do të jetë 36'' dhe në tokë do të jetë 48''
- Madhësia dhe vendndodhja e Stacioneve të Bllokimit të Valvulave (BVS) do të jetë pjesë për sigurinë e tubacionit të transmetimit

Për 20 miliard metra kub (bcm) që i nevojiten TAP në të ardhmen do të kemi edhe:

- Shtimin e kapacitetit në dy stacionet ekzistuese të kompresimit dhe Terminali për Marrjen e Gazsjellësit
- Dy stacione të reja kompresimi në Bilisht, Shqipëri dhe Serres, Greqi

2.4 Progresi i punimeve të projektit TAP gjatë vitit 2017

- TAP është plotësisht i licencuar sipas standarteve kombëtare dhe standarteve ndërkombëtare të mjedisit dhe sigurisë dhe po ecën me një rritëm të jashtëzakonshëm.
- Pothuajse një km/ditë po ndërtohet dhe më shumë se 60% e projektit është gati pothuajse e përfunduar në Shqipëri.
- Pjesët Lindore dhe Perëndimore në tokë të gazsjellësit në Shqipëri pothuajse kanë përfunduar. Punët e ndërtimit po ecin në mënyrë të shpejtë në mes të zonës malore.
- Stacioni i kompresimit ACS03 në Fier dhe stacioni i matjes ACS02 në Bilisht po ashtu janë nën ndërtim. Progresi i ndërtimit në Stacionet e Kompresimit ACS03 është 13.4%, ndërsa në Stacionet e Matjes ACS02 është 17.9%.

2.5 Ecuria e ndërtimit në Shqipëri deri në datën 1 Janar 2018

- Rreth 168 km e pastruar, hapur transheja dhe gati për shtrirje tubacioni
- Afërsisht 162 km e rrethuar, janë bërë punime rrethimi për zhvillimin e projektit
- Pothuajse 156 km e lidhur, çdo gjë e përfunduar brënda standarteve
- Mbi 133 km zonë e mbrojtur, si një zonë me rëndësi të veçantë
- 100% tuba të dorrëzuar (në mes të – Qershor 2017).
- Faza e I rë aksesit në rrugë & ura të përfunduara deri në fund të vitit 2016
- Faza e II e ndërtimit të rrugëve, 78% e përfunduar, gjatë vitit 2017

2.6 Disa të dhëna për Projektin TAP pjesa që kalon në det (offshore)

Pjesa nën det e TAP do të kalojë në Detin Adriatik në ngushticën e Otrantos midis bregdetit Shqiptar në jug-perëndim të Fierit dhe Bregdetit Italian në veri të San Foca.

- Gjatësia – 105 km
- Thellësia e ujit – 820 m
- Kapaciteti i Projektimit – 20 miliard metra kub (bcm)
- Diametri i jashtëm i tubit – 36’’

- Trashësia e murit të çelikut – 20-34mm (në varësi të thellësisë së ujit)
- Beton i veshur në thellësi të ujit më pak se 300m për mbrojtje mekanike

2.7 TAP-i si Projekt Strategjik për Shqipërinë dhe Europën Jug-Lindore

- TAP do të shtojë sigurinë në furnizim me 10 bcma(miliard meter kub) për gazin e ri që vjen nga fushat e Detit Kaspik dhe rruga e re e cila hap Korridorin Jugor të Gazit.
- TAP do të shtojë sigurinë e energjisë dhe shumëllojshmërinë për Europën dhe e kanë gazin natyror si karburantin më të pastër fosil që vazhdon të luajë një rol kryesor në sigurimin e përzierjes së energjisë së qëndrueshme.
- Gazsjellësi është projektuar që të shtojë kapacitetin deri në 20 bcma në një fazë të dytë duke i dhënë mundësinë Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor që të kenë akses te gazi i cili vjen nga deti Kaspik dhe mundëson gazifikimin e ekonomive të tyre.
- TAP është një projekt me rëndësi të madhe strategjike, tregëtare, dhe gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor dhe Europë. Projekti e bën Shqipërinë pjesë të infrastrukturës së gazit duke rritur sigurinë energjitike në vend.
- Gazi natyror i ofruar dhe mundësuar nga TAP do të kontribuojë në dekarbonizimin e ekonomive në vend, veçanërisht në Europën Jug-Lindore dhe Ballkanin Perëndimor, ku sektori i energjisë është shumë i varur nga përdorimi i lëndëve djegëse fosile për gjenerimin e energjisë.
- Tre (3) pikat e lidhjes janë rënë dakord përgjatë 215 km të rrugës TAP në territorin e Shqipërisë që do të përdoren për furnizimin e rrjetit lokal të gazit dhe ndërlidhësit me vendet e tjera. Pikat e lidhjes në Fier me investimet e TAP, në Kuçovë dhe Korçë me investitorët
- TAP do të jetë mundësia për shpërndarjen e gazit natyror në Shqipëri, duke përmirësuar sigurinë e energjisë në vend, shumëllojshmërinë e burimeve të energjisë dhe zhvillimin e rrjetit dhe tregut të gazit në vend.

2.8 Përfitimet e Shqipërisë nga TAP

- TAP është Investimi Direkt më i madh i Huaj (FDI) që po ndërtohet në Shqipëri me një investim total €1.5bn, dhe një **votë konfidence për Shqipërinë** nga investitorët kryesorë të huaj.
- TAP është një nga projektet kryesore me një impakt të konsiderueshëm në **rritjen ekonomike në Shqipëri** dhe me një potencial të preکشëm dhe mundësi për zhvillimin ekonomik të vendit.
- Porti i Durrësit ka kaluar aktivitetin më intensiv të viteve të fundit nga i cili janë shpërndarë 13,000 tuba.

- Punësimi në vend dhe furnizimet po përjetojnë një rritje. Në mënyrë specifike në zonën e Shqipërisë, TAP ka punuar me një numër të madh kompanish në vend për furnizimin dhe shërbimin e materialeve.
- Aktualisht, rreth 2,500 punonjës janë punësuar për projektin, 85 % e tyre nga komuniteti në vend.
- TAP po bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Kulturës për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në Shqipëri. Një numër i madh ekspertësh arkeologjike janë angazhuar në projektin e ndërtimit. Nën monitorimin e tyre, shumë zbulime janë nxjerrë dhe i janë shpërndarë autoriteteve kompetente arkeologjike në Shqipëri.

2.9 Investimet Mjedisore dhe Sociale (SEI) ne Shqiperi

- Bazuar ne Marreveshjen e Krahasimit (Benchmark) me TAP, Shqipëria ka siguruar një total prej 14 MLN Euro për investimet mjedisore dhe sociale të cilat do të financohen direkt nga TAP për përfitime afatgjata të komunitetit në vend ku kalon gazsjellësi.
- Është identifikuar një total prej përafërsisht 10,5 milion euro nga 14 milion (përfshirë 35 projekte të miratuara dhe 5 të cilat do të zhvillohen por që akoma nuk janë miratuar)
- Gjendja aktuale e Projekteve SEI (Investimet Mjedisore dhe Sociale):
 - 40 projekte të cilat janë identifikuar deri më tani. Zonat ku është ndërhyrë përfshijë Infrastrukturën, Edukimin, Bujqësinë, Ndërgjegjësimi i Sigurisë dhe Asistenca e Emergjencës;
 - 11 projekte të përfunduara deri tani me një vlerë prej 1,5 milion euro (projekte të cilat përfshijnë shkolla rehabilitimi, mobilim, dhe ngrohje, ndërtimin e pikave të vrojtimit të cilat mbështesin turizmin në Skrapar, Fushatën e Sigurisë në Rrugë, një urrë me dy korsi, pajisjet zjarrfikëse dhe ndihmat e tjera të emergjencës), mbështetje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit iniciativën për “Pastrimin e Shqipërisë”, etj;
 - 14 projekte të cilat janë në faza të ndryshme zbatimi me një vlerë prej 4 milion Euro;
 - 10 projekte të cilat janë miratuar dhe do të fillojnë të zbatohen me një vlerë prej 3 milion Euro;
 - 5 projekte të cilat zhvillohen dhe shume shpejt do të miratohen me një vlerë 2 milion euro;

2.10 Mbështetje të tjera në Shqipëri

- TAP është angazhuar shumë për të mbështetur përmirësimin e infrastruktures dhe zhvillimin e tregut te gazit ne Shqiperi.
- Për përmirësimin e infrastrukturës TAP është angazhuar me një fond prej 5 MLN Euro, fillimisht i përdorur për përmirësimin e rrugëve të vendit.

- TAP po mbështet Qeverinë Shqiptare për Zhvillimin e Tregut të Gazit dhe forcimin e kapacitetit për OST (Albgaz) të themeluar së fundmi në vend. Një total prej 6,7 MLN Euro kanë shkuar për këtë qëllim.
- Përveç kësaj, do të ofrohet për kompaninë Albgaz në Kredi ‘a Contingency Loan’ prej 6,3 MLN Euro, duke i dhënë mundësi kompanisë që të rritë ndërtimin e kapaciteteve dhe të jetë në gjendje të kryejë punimet e performancës për gazsjellësin TAP gjatë fazës së funksionimit.

2.11 Aspektet Rregullatore për Projektin TAP

Aplikimi i TAP për Përjashtimet:

- Përcaktimi i Aksesit të Palëve të Treta (TPA) për kapacitetin fillestar (10bcm/y)
- Përjashtimi nga tarifa rregullatore mbi kapacitetin fillestar dhe kapacitetin e zgjerimit. Kodi i Tarifave i miratuar nga autoritetet rregullatore
- Përjashtimi nga veçimi i pronësisë. TAP është certifikuar si Operator i Pavarur i Transmetimit (ITO) para ndërtimit, dhe më konkretisht:
- Vendimi i Përjashtimit është i mbështetur në paragrafin 4.5 të FJO (Opinion Final i Përbashkët) i cili përjashton TAP-AG nga dispozitat e pronësisë, si përcaktohet në nenin 9(1) të Direktivës së Gazit.
- I gjithë investimi që do të kryhet për këtë projekt do të përshkojë gjashtë shtete me një gjatësi tubacioni 3500 km.
- Final Joint Opinion i qershorit 2013 përcaktonte se Vendimi Përjashtues do të humbte efektin dhe vlefshmërinë e tij nëse ndërtimi nuk do të fillonte brenda 3 viteve (pra, brenda Qershorit 2016) dhe nëse nuk fillonte veprimtaria operationale brenda 6 viteve të ardhshme. Gjithsesi, Komisioni i BE-se do të mund të aprovonte një shtyrje në rastin e ndonjë vonese të shkaktuar nga pengesa madhore përtej fuqisë së TAP-it. (e bazuar në nenin 36.9 të Direktivës 79/2003/EC).
- Në vendimin e Komisionit Europian të majit 2013 parashikohej se roli TAP-it është vetëm një nga elementet në vazhden e investimeve që nevojiten të kryhen për të siguruar prodhimin e Gazit të Shah Deniz 2 dhe transportimin e gazit për në BE. Veçanërisht, vendimi parashikonte se TAP-i nuk ka asnjë influencë mbi zhvillimin e mëtejshëm të procesit; pra, asnjë influencë mbi fushën e gazit të Shah Deniz 2, infrastrukturën e transportit nga Azerbajxhanipër në Gjeorgji, si dhe infrastrukturën e transportit përgjatë Turqisë.
- Në kohën që është marrë Vendimi Përjashtues për TAP-in, duke patur parasysh edhe kërkesën për shtyrje nga Konsorciumi nëpërmjet TAP-it dhe të miratuar nga tre Autoritetet, Janari vitit 2020-s deri në Dhjetor të vitit 2020, është vlerësuar si periudha kohore kur gazi do të hyjë në sistemin transportit të TAP-it.
- Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, ka marrë vendim për amendim, në zbatim të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Ministrave të datës

13 korrik 2009; Rregullores 715/2009/EC të Parlamentit European dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009, Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; Vendimit të Komisionit European C(2013) 2949 të datës 16 Maj 2013; ”Opinionit të Përbashkët Përfundimtar të Rregullatorëve të Energjisë ‘mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtim (Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin në Itali) AEEGSI, Enti Rregullator i Energjisë Shqipëri (ERE) dhe Autoriteti Rregullator Greqi (RAE), në vijim të Final Joint Opinion; Vendimit të Bordit Nr. 12, datë 14.02.2014 “Për Miratimin e Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion në kuadër të procedurës së përjashtimit të Gazësjesellësit TAP.Kjo ishte një shtesë ose një amendim që u realizua në sajë të një diskutimi të gjatë midis tre Autoriteteve rregullatore të Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, sigurisht që ky diskutim i gjërë është bërë në përputhje të ndryshimeve të fundit të bëra nga Komisioni European në kuadër të transparencës.

2.12 Bashkëpunimi dhe Përjashtimi – Çështjet Kryesore

- Bashkëpunim i Shkëlqyer midis autoriteteve rregullatore të tre vëndeve; Itali, Greqi dhe Shqipëri
- Përjashtimet e bëra për projektin TAP janë të vlefshme për 25 vjet nga Data e Vendosijes në Funksion (në vitin 2020)
- Rreth 10 miliard metra kub në vit do të përdoren për të sjellë volumet e gazit SD në tregjet Europiane, nga këto një sasi gazi është e garantuar për vëndin tonë nëpërmjet MoM
- Kapaciteti mbi 10 miliard metra kub në vit do të ofrohet për tregun. Çdo dy vjet do të kryhet testimi i tregut(Market Test), mundësi për të përfituar më tepër sipas nevojave që ka vëndi
- Detyrimet për të ofruar produktet afatshkurtra:
5% e Kapacitetit Fillestar dhe 10 % e Kapacitetit Shtesë
- Rrjedha virtuale e kundërt ‘*Virtual reverse flow*’ do të ofrohet në treg me 5% të tarifës përkatëse të fluksit për të ardhmen ‘*of the relevant forward flow tariff*’.

Çertifikimi i Operatorit të Pavarur të Transmetimit (ITO)

Aplikimi i TAP për çertifikimin e Operatorin e Pavarur të Transmetimit (ITO) para ndërtimit dhe janë kryer me sukses veprimet e mëposhtëme:

- Është bërë ndarja ligjore dhe funksionale
- Është miratuar Programi Rregullator i Pajtushmërisë

- Udhëzimet për pajtueshmëri të plotë me modelin e Operatorit të Pavarur të Transmetimit me fillimin e operimit



Çertifikimi një nga proceset më të vështira sepse kërkon implementimin e paketës tretë të energjisë në zbatim të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të të Ministrave të datës 13 korrik 2009; Rregullores 715/2009/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009, Ligjit nr.102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’. Ndër Çështjet Kryesore ishin:

- Bashkëpunim i shkëlqyer midis autoriteteve rregullatore, Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, Komisionit Europian dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për të gjitha problemet që na dilnin në veprimtarinë tonë
- Rregjimi rregullator i përshtatur i TAP parandalon konfliktin e interesave midis TAP dhe aksionereve
- ERE zbatoj në kohë Paketën e Tretë, një nga pikat kryesore të suksesit të këtij projekti
- Një Këshill Mbikqyrës duhet të jenë në funksion gjatë vendosjes në veprim operacional, por jo gjatë fazës së ndërtimit, për këtë po punohet
- Lejohen shërbimet dhe stafi nga aksioneret kryesore për projektin gjatë ndërtimit
- Vendimi i certifikimit nuk e limiton mundësinë e aksionereve për të vendosur strukturën e financimit e cila është e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit

2.13 Bashkëpunimi me IAP dhe mundësia e koordinimit të dy projekteve tepër të rëndësishëm për zhvillimin e infrastrukturës në vëndin tonë

Gazsjellësi Jonian Adriatik (IAP)

Është zhvilluar në mënyrë të pavarur nga Plinacro, BH-gaz, Ministria e Energjisë në Shqipëri dhe Malin e Zi, disa të dhëna rreth këtij projekti po i paraqesim më poshtë:

- Kapaciteti i transmetimit është rreth 5- miliard metra kub, gazsjellës me dy drejtime
- Gjatësia e përgjithshme e këtij tubacioni është ~500 km, ~600 Mio. EUR
- Lidh tregjet e pa gazifikuara të Kroacisë Jugore, Shqipërisë(Kosovës nëpërmjet pikes së lidhjes në Kukës) dhe Malit të Zi (mundësia për një degëzim në Bosnje dhe Hercegovinë)

Në muajin Gusht 2016, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi dhe Socar nënshruan një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) për projektin IAP.

Projekti IAP përmes planeve të veprimit së bashku me vëndet do të mund të kenë kapacitet përdorimi të gazit si më poshtë*:

- Rreth 1 miliard meter kub për Shqipërinë
- Rreth 0.5 miliard meter kub për Malin e Zi
- Rreth 1 miliard meter kub për Bosnjën dhe Hercegovinën
- Rreth 2.5 miliard meter kub për Kroacinë e Veriut ose 0.2 miliard metra kub për Kroacinë e Jugut

2.14 Memorandumi i Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit

- **Memorandumi i Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit (MOUCs)** midis TAP dhe IAP është promovues, për bashkëpunim në fushat teknike, politike dhe tregëtare.
 - Plinacro (Kroaci) Shkurt 2011
 - BH-Gaz (Bosnjë –Hercegovinë) Prill 2011
 - MoE Mali i Zi Maj 2011
 - METE Shqipëri Korrik 2011
 - Plinovodi (Slloveni) Shtator 2011

Memorandumi i Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit i krijuar si një Grup i Përbashkët Pune si forum ku mund të takohen palët dhe të punojnë së bashku mbi çështje me interesa të përbashkëta. Disa takime të Grupeve të Përbashkëta TAP-IAP që janë mbajtur deri tani.

- Në muajin Maj 2013, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Mali i Zi nënshkruan një **Memorandum Mirëkuptimi MoU** për të mbështetur TAP dhe IAP.
- Mbështetje e fortë politike për projektin TAP dhe IAP në rajon si tregohet nga deklarata të shumta të mbështetjes politike: Dubrovnik (Gusht 2016 –IAP nënshkrim i Memorandimit të Mirëkuptimit), Tiranë (Maj 2013), Bruksel (Maj 2013).




Figure 54 Korridori Jugor i Gazit (SGC) dhe projekti IAP




Figure 55 PROJEKTI- SCP-TANAP-TAP

2.15 Data e Planifikimit të Fillimit të TAP-it (PCD).

Projekti TAP-AG ka një ecure shumë të mire i cili përputhet me grafikun e miratuar (Road Map) nga konsorciumi në lidhje me prodhimin e gazit nga vëndburimi i Shah Denizit, por gjithashtu edhe veprimeve të mëtejshme deri në fund të vitit 2017.

Përsa i përket TAP-it, procedura për të përcaktuar PCD-n përshkruhet në Marrëveshjen për Përcaktimin e Tarifave (TDA) të korrikut 2013, ku palët që kanë rënë dakord janë BP Exploration (Shah Deniz) Limited (për llogari të South Gas Corridor), SOCAR dhe TAP AG. Në TDA është sanksionuar e drejta e SDC-se për të përcaktuar PCD brenda parametrave të përcaktuar. Deri tani nuk ka ndryshime rreth këtyre vendimeve të mara.

TAP-i nuk është një infrastrukturë ekzistuese, dhe si një projekt gazsjellësi ndërkufitar dhe i vetë qëndrueshëm ende për tu ndërtuar, TAP-i nuk do të marrë aktivitetet e OST-se, para datës në të cilën gazsjellësi TAP do të përfundojë dhe do të jetë në gjendje të marrë, transportoj dhe të dërgoj Gazin Natyror, ashtu si është përcaktuar në Commercial Operacioni Data (COD) në FJO.

Në Gusht 2013, të tre Rregullatorët Kombëtare u njoftuan nëpërmjet një shkrese të hartuar nga TAP-i ku përmbledhej TDA-ja (Marrëveshja e Përcaktimit të Tarifave), përfshirë edhe parimet e 'funneling mechsansim'. Proçesi për të përcaktuar PCD është gjithashtu i përfshirë në versionin Final të Kodit të Tarifës së TAP-it, i cili u miratua nga Rregullatorët Kombëtare në Nëntor të 2013-ës. Deri tani të gjitha sa thamë më sipër janë të konsoliduara dhe nuk ka asnjë ndryshim.

ALBGAZ Sh.a (Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror)

Gazi natyror ka qënë dhe është një element i rëndësishëm për furnizimin e tregut shqiptar me energji dhe diversifikimin e burimeve të energjisë, por kontributi i tij i deritanishëm është shumë i ulët për shkak të niveleve minimale të prodhimit si rrjedhojë e përfundimit të shfrytëzimit të rezervave nga vëndburimet ekzistuese si dhe mungesën e investimeve për zbulimin dhe shfrytëzimin e vëndburimeve të reja. Shqipëria ka rezerva të konsiderueshme të gazit, si në tokë dhe në det të cilat kanë inkurajuar investitorët e huaj, për të filluar kërkimin për zona të pazbuluara të gazit të cilat besojmë se do të konkretizohen në vitet në vijim. Përfundimi i gazsjellesit TAP në vitin 2020 do të krijojë mundësi për shfrytëzim të gazit natyror, fillimisht për qëllime industriale dhe në vijim për konsumatorët familjare. AlbgaZ Sha, tashmë funksionon si një operator i kombinuar i gazit natyror duke kryer veprimtarinë e operatorit të sistemit të transmetimit (OSTg) dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes së gazit natyror (OSSHg). Shoqëria realizon objektin e veprimtarisë së saj sipas Ligjit Nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror". Në më pak se një vit nga funksionimi i AlbgaZ Sha, janë miratuar një sërë aktesh nënligjore si, çertifikimi, metodologjitë e tarifave dhe liçensimi i AlbgaZ Sha. Progresi në këtë sektor theksohet edhe në raportin vjetor 2017 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Me anë të VKM Nr. 848, datë 07.12.2016, për “Krijimin e Shoqërisë Albgaz Sh.A. dhe për Caktimin e Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve të Shoqërive Albpetrol Sh.a. dhe Albgaz Sh.a.”, Këshilli i Ministrave, ka krijuar autoritetin publik që është përgjegjës për trasmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë. Albgaz Sh.a u themelua në Janar të vitit 2017. **Albgaz Sh.a. është një shoqëri aksionere me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti shqiptar.**

Konsumatorët e gazit janë kryesisht kompanitë e prodhimit të naftës dhe disa konsumatorë industriale. Prodhimi i Gazit Natyror është i përqëndruar në jug të vëndit (kryesisht në qytetin e Fierit). Kompania Albpetrol Sh.a është prodhuesi dhe konsumatori kryesor i gazit natyror vendas në Shqipëri. Aktiviteti për transportimin dhe shpërndarjen e gazit natyror aktualisht kryhet nëpërmjet infrastrukturës ekzistuese (tejet të amortizuar) të gazit. Përfitues kryesor i zhvillimit të tregut të gazit është ekonomia e vëndit në tërësi, gjithashtu industria, përmes zhvillimit të sektorit të energjisë nëpërmjet termocentraleve me gaz, me synimin diversifikimi i burimeve primare energjitike dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të vëndit.

Masterplani i Gazit

Tani vëndi jonë ka Mastërplanin e Gazit që u miratua në dhjetor 2016. Rrjeti i propozuar i transmetimit të gazit përbëhet nga pesë linja(degëzime) kryesore(fig):

1. Linja e Veriut, duke filluar nga pika e kyçjes me TAP (pranë Fierit) deri në pikën e kalimit kufitar MNE,
2. Linja e Elbasanit, duke filluar nga pika lidhëse me TAP (afër Fierit) dhe duke shkuar në Elbasan,
3. Linja e Jugut, duke shërbyer në zonat e Fierit, Vlorës, Ballshit, Tepelenës dhe Gjirokastrës,
4. Linja e Lindjes, që lidh zonat e Korçës, Pogradecit dhe FYRoM,
5. Linja e Kosovës, duke filluar nga Miloti dhe duke përfunduar në pikën kufitare Shqipëri - Kosovë pranë Kukësit.



Figure 56 Masterplani i Gazit

Harta e degëzimeve(linjave)në vëndin tonë

I rëndësishëm është Projekti ndërkufitarë që do të bëjë lidhjen me gazsjellësin Jonian-Adriatik (IAP), ndërtimi i tubacionit që do të lidhë Shqipërinë me Kosovën (ALKOGAP).

Projektet prioritare të Republikës së Shqipërisë të identifikuara në Mastërplanin e Gazit

Pas miratimit të Mastërplanit të Gazit të Shqipërisë në dhjetor 2016, puna ka vazhduar më tej me identifikimin e projekteve prioritare të cilat janë:

- Projekti i parë prioritar: PIP1 - Tubacioni i Transmetimit nga TAP CP në TC Vlorë, për vendosjen në punë të këtij TEC-i
- PIP2 - Tubacioni i Transmisionit nga TAP CP1 në Fier dhe Ballsh, si një zone me industri të zhvilluar
- PIP3 - Tubacionet e Transmisionit nga IAP në Tiranë dhe Durrës, si zona ku ka aktivitet edhe industria edhe konsumatori familjar
- Synimi tjetër, ndonëse më afatgjatë, është rrjeti i shpërndarjes për konsum familjar/rezidencial, kryesisht për zonat me temperature të ulët.

2.16 Vendimet e marra për aktet nënligjore dhe aktet rregullatore

Vendime të marra nga BORDI I ERE-s

2.16.1 Çertifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (Albgaz)

Vendimi më i rëndësishëm gjatë vitit 2017, është çertifikimi i Albgaz si operator i kombinuar për transmetim dhe shpërndarje në *përputhje të plotë me*, Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Ministrave të datës 13 korrik 2009; Rregullores 715/2009/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009 dhe të Ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”

Është ERE ajo që përcakton kërkesat për aplikim për çertifikim të Operatorit të Kombinuar, përfshirë dokumentacionin e nevojshëm që provon përmbushjen e kushteve të ligjit. Aplikimi për çertifikim paraqitet nga Operatorit i Kombinuar, në përputhje me kërkesat e miratuara nga ERE. “Rregullat për çertifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 05.08.2015 dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, kanë përcaktuar të dhënat, dokumentat, dhe informacionin mbështetës që të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe çertifikimin. Në nenin 11, përcaktohet se ERE duhet të çertifikojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të gazit natyror, bazuar në procedurat e vendosura në këtë rregullore. Shoqëria Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a., me shkresën nr. 3 prot., datë 20.02.2017, ka paraqitur kërkesën, për çertifikimin në aktivitetin si Operator i Kombinuar, bazuar në nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Kjo kërkesë është shoqëruar me informacionin e nevojshëm, të përcaktuar në “Rregullat për çertifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 05.08.2015 dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, si dhe pikës 7, të VKM nr. 848, datë 07.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz Sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të Sektorit të Gazit Natyror”, e cila përcakton se: menjëherë mbas hyrjes në fuqi të këtij vendimi Albgaz sh.a., aplikon në ERE për çertifikim në bazë të neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015. Referuar kërkesës për çertifikim si dhe analizës dhe vlerësimit të dokumentacionit të depozituar, për këtë qëllim nga Albgaz sh.a. në ERE, Bordi në mbledhjen e tij të datës 02.03.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi aplikimin e Albgaz sh.a., për çertifikimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, ka marrë vendimin nr. 35, datë 02.03.2017, vendosi të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për çertifikimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të ALBGAS sh.a. Në vijim, Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 82, datë 26.05.2017, “Mbi çertifikimin paraprak të Shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAS sh.a.”, Vendosi: 1- Miratimin paraprak të çertifikimit të Operatorit të Kombinuar të gazit natyror Albgaz sh.a. në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe nenin 9, pika

6, të Direktivës 73/2009 EC. 2- Brenda 3 muajve pas miratimit të Vendimit të Çertifikimit, ALBGAZ sh.a. të caktojë Zyrtarin e Përputhshmërisë subjekt i miratimit nga ERE, si dhe duhet që të hartojë dhe t'i dorëzojë ERE-s, Raportin e përcaktuar sipas Programit të Përputhshmërisë rregullatore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i Vendimit të Çertifikimit, të ALBGAZ sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të Direktivës nr.73/2009 të Komisionit Evropian “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe nenit 47 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Në datën 29 Shtator 2017, Sekretariati morri një Opinion për Vendimin Paraprak nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë (këtu dhe më poshtë “ECRB”), siç kërkohet sipas Nenit 3(1) të Rregullores së Gazit. Sekretariati bie dakord me ERE që në parim albgaz e përmbush kërkesën për zotërim të aseteve. megjithatë, sekretariati kërkon që ere në vendimin përfundimtar të përfshijë detyrimin e shoqërisë Albgaaz sh.a. për ti raportuar çdo muaj ERE ecurinë e procedurës për regjistrimin e aseteve të transmetimit, dhe ta përfundojë procedurën brenda gjashtë muajsh pas çertifikimit, si dhe një sërë rekomandimesh të cilat u panë të domosdoshme për tu evidentuar si detyrime për shoqërinë Albgaaz në vendimin përfundimtar të çertifikimit. Në përfundim Sekretariati mbështeti çertifikimin e Albgaaz në përputhje me Vendimin Paraprak të ERE-s. Së fundmi me vendimin e Bordit të ERE, Nr. 179, Datë 08.11.2017 u vendos për çertifikimin përfundimtar të shoqërisë Albgaaz sh.a. Në vijim të procesit të çertifikimit pas kërkesës së shoqërisë Albgaaz sh.a., bordi i ERE me vendimet respektivisht nr.187 dhe 188 datë 10.11.2017, miratoi kërkesat për: licensimin e shoqërisë Albgaaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror; licensimin e shoqërisë Albgaaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror

2.16.2 Metodologjia e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

ERE në zbatim të nenit 16 pika 1; nenit 32 pika 1 dhe nenit 33, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, është autoriteti përgjegjës për hartimin, miratimin dhe publikimin e metodologjive për përcaktimin e tarifave të aksesit në rrjetet e gazit natyror, mbi bazën e parimeve të vendosjes së këtyre tarifave.

Në përmbushje të këtij detyrimi ERE nisi hartimin e draft metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror. Ky draft u hartua në bashkëpunim me Shoqërinë konsulente Becker Buttner Held (BBH) me të cilën u bë edhe shkëmbimi i eksperiencës lidhur me përshtatshmërinë e metodologjisë që duhet të aplikohet në kushtet aktuale të rrjetit tonë të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, si dhe komponentët e të ardhurave të kërkuara për të dy aktivitetet. Me anë të Vendimit nr.142, të Bordit të ERE-s, u filluan procedurat për miratimin e tij. Në vijim ERE në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s, publikoi draft – metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes të gazit natyror në faqen zyrtare të ERE-s. Po ashtu me shkresën nr. 648 Prot., datë 04.10.2017, u njoftuan Albgaaz sh.a., Albpetrol sh.a., MIE, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti i Konkurrencës në lidhje me këtë vendimarrje si dhe u kërkua opinioni i tyre mbi këtë draft- Metodologji. Gjithashtu dërgoi për publikim në median e shkruar njoftimin e datës

02.10.2017, me anë të të cilit u ftuan palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre. Në datën 13.09.2017, ky draft u dërgua gjithashtu për marrje opinionit Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Më pas në vijim të procesit të mbledhjes së komenteve nga palët rezultoi se u paraqitën opinione dhe komente nga Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 394/1 Prot., të datës 12.10.2017; nga ALBGAS sh.a. me shkresën nr.129 Prot., datë 30.10.2017 dhe në formë elektronike janë praqitur komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Pasi u shqyrtuan komentet dhe opinionet e palëve të interesit, ato u pranuan kryesisht dhe u përpunuan në Draft – Metodologji. Po ashtu në relacionin që u prezantua në Bord, mbi miratimin e kësaj Metodologjie u përfshinë të gjitha spjegimet e dhëna nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për çdo koment që nuk u pranua të përfshihej nga ERE në draft-Metodologji. Kjo metodologji u miratua me vendimin e Bordit të ERE nr. 178, datë 08.11.2017. Miratimi i kësaj metodologjie ishte parakusht i vendosur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për të dhënë dakortësinë në lidhje me miratimin përfundimtar të çertifikimit të Albgas sh.a.. Pikërisht në të tilla rrethana ERE arriti të repsektojë afatet dhe të përmbushë kushtet e paracaktuara në vendimin paraprak të çertifikimit të shoqërisë Albgas por edhe ato të parashikuara në ligjin 102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror”.

Qëllimi i kësaj metodologjie është vendosja e rregullave për llogaritjen e tarifave të aksesit dhe përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit në Shqipëri si dhe tarifave të shërbimeve të ofruara nga operatori i rrjetit të gazit, siç parashikohet në nenin 32, pika 1 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” (tarifat e rrjetit). Tarifat e rrjetit do të vendosen nga operatori i rrjetit të gazit në përputhje me këtë metodologji. Kjo metodologji nuk trajton tarifën e aksesit dhe përdorimit të TAP (Trans Adriatic Pipeline).

2.16.3 Pagesa e regjistrimit dhe proçedimit të një aplikimi.

Janë miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 97, Datë 04.07.2017 rregullat për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e liçensave në sektorin e gazit natyror. Janë miratuar edhe pagesa e regjistrimit dhe proçedimit të një aplikimi në sektorin e gazit natyror në aneksin A të kësaj rregulloreje. Kjo Rregullore përcakton proçedurat e liçensimit për kryerjen e aktiviteteve sikurse përcaktuar në Ligjin Nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror", duke specifikuar termat dhe kushtet për dhënien, ndryshimin e një Liçense, si dhe autoritetin e ERE për përcaktimin e pagesave për t'u kryer për çdo lloj Aplikimi për Liçensë. ERE publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e proçedurave “Për shqyrtimin dhe miratimin e draft-rregullores për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e liçensave në sektorin e gazit natyror”. ERE dërgoi draft – “Rregulloren për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Gazit Natyror”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: MEI, Autoritetit i Konkurrencës, Albpetrol dhe ISHTI. Autoriteti i Konkurrencës është shprehur se draft – “Rregullorja për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e liçensave në sektorin e gazit natyror”, nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për

mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjithashtu edhe ENC me anë të komunikimit elektronik ka përcjellë propozimet në lidhje me draft-“Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Gazit Natyror” të cilat pasi janë shqyrtuar rast pas rasti, janë reflektuar në këtë draft

2.16.4 Rregullore për trajtimi e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të liçensuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror

Është miratuar me vendimin e Bordit të ERE, Nr. 114, Datë 08.07.2016 “Rregullore për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të liçensuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet dhe procedurat, për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin mes të liçensuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror dhe trajtimin e ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

2.16.5 Rregullore për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s

Është miratuar me vendimin e Bordit të ERE, Nr. 96, Datë 17.06.2016 “Rregullore për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”. Qëllimi i kësaj rregulloreje, është të sigurojë procedura transparente në ushtrimin e funksioneve të ERE-s, duke garantuar një trajtim të barabartë në dhënien e liçensave dhe çertifikimeve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit, vendosjen e tarifave dhe çmimeve të të liçensuarve në aktivitetet e rregulluara, zgjidhjes së konflikteve midis të liçensuarve dhe midis të liçensuarve dhe Klienteve, hartimit dhe miratimit të akteve nenligjore në zbatim të Ligjit Nr.43/2015, Për Sektorin e Energjisë Elektrike, dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Per sektorin e gazit natyror”. Konsultuar me palët e interesit.

2.16.6 Rregullore për mbrojtjen e informacionit konfidencial

Ka filluar procedura për miratimin e këtij akti me vendimin e Bordit të ERE Nr. 17, Datë 10.01.2018. Ky draft është hartuar në respektim të parashikimeve të dispozitave të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, duke dhënë orientim të përgjithshëm në lidhje me llojin e informacionit tregtar që mund të cilësohet konfidencial si dhe rrethanat apo llojin e informacionit që për shkak të parashikimeve të ligjit përjashtohet nga konfidencialiteti. Mbas mbylljes së procedurave të konsultimeve me institucionet dhe palët e interesuara, është realizuar edhe miratimi i kësaj rregullore.

2.16.7 Rregullore për procedurat e heqjes së liçensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror

Është miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr.58, datë 18.04.2017 “Rregullore për procedurat e heqjes së liçensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”. Kjo

rregullore përcakton procedurat që aplikohen për heqjen e një liçense të dhënë sipas Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, në përputhje me “Rregullorja e Organizimit dhe funksionimit të ERE” dhe “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike”, “Rregullat dhe Procedurat për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesëshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror”. ERE dërgoi draft – “Rregulloren për procedurat e heqjes së liçensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: OST sh.a, KESH sh.a, OSHEE sh.a, FIAA, AREA, Autoritetit i Konkurrencës, AEES, Albpetrol, Shoqatës së Prodhuesve të Vegjël të Energjisë, Shoqërisë Phoenix Petroleum sh.p.k. dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Shoqëria OSHEE sh.a. ka përcjellë në ERE sugjerimet dhe komentet në lidhje me draft – “Rregulloren për procedurat e heqjes së liçensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”. Shoqëria OST sh.a. ka përcjellë në ERE sugjerimet dhe komentet në lidhje me draft – “Rregulloren për procedurat e heqjes së liçensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”. Me korrespondencë elektronike edhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka përcjellë në ERE komentet mbi draft rregulloren për procedurat e heqjes së liçensave në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

2.16.8 Rregullore e procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit

Është miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 119, Datë 21.07.2016. Kjo rregullore përcakton procedurat që aplikohen nga ERE si dhe parimet për shqyrtimin e çdo kërkesë për shitje, dhënie me qera, transferimi, hipotekim, barrë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licensuarit sipas Ligjit Nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe sipas Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Pas miratimit të fillim procedurave për miratimin e rregullores si më sipër, në zbatim të detyrimeve të ERE u është bërë me dije të gjitha palëve të interesuara përmbajtja e këtij drafti dhe janë ftuar të japin komentet mbi draftin apo sugjerime mbi përmirësimin e tij. Mbas mbylljes së procedurave të konsultimeve me institucionet dhe palët e interesuara, është realizuar edhe miratimi i kësaj rregullore.

2.16.9 Rregullat për çertifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror

Është miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 100, Datë 05.08.2015. Qëllimi i kësaj rregulloreje është sigurimi i një procesi Çertifikimi transparent, të plotë, të besueshëm dhe koherent me çdo ndryshim eventual i cili garanton përputhshmërinë me kushtet që sigurojnë pavarësinë dhe ndarjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror, që garanton ndarjen e plotë nga aktivitetet e tjera të sektorit të gazit natyror si dhe energjise elektrike, në funksion të zhvillimit të sektorit Gazit Natyror në përputhje me rekomandimet e paketës së tretë legislative të BE, si dhe garantimin e rolit mbikëqyrës të ERE mbi aktivitetin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror. Ky akt është konsultuar dhe diskutuar gjerësisht me palët e interesit si dhe ndjekur hap Pas hapi, deri në miratimit e tij nga

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Pas miratimit të kësaj rregulloreje dhe në zbatim të dispozitave të parashikuara në të, ERE vijoi me Vendimin e Bordit Nr. 36 Datë 31. 03. 2016 , i cili vendosi për miratimin e çertifikimit përfundimtar të Tap Ag si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror dhe me Vendim të Bordit Nr. 179 Datë 08.11.2017, vendosi miratimin e çertifikimit të kompanisë kombtare Albgaz.

2.16.10 Rregullore e procedurave të paraqitjes së planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shërndarjes së gazit natyror.

Është miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 18, Datë 10.01.2018. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë përmbajtjen dhe afatin e dorëzimit në kohë në ERE, të planit të investimeve të OST dhe OSSH (Albgaz si operator i kombinuar), si dhe vlerësimin dhe analizën e kriterëve të aplikueshme dhe miratimin e tyre (ose rishikimin) nga ERE, për të siguruar që planet e investimit të jenë në përputhje me parimet e planifikimit me kosto më të ulët, rregullat dhe kërkesat e zbatueshme për sigurinë e operimit të rrjetit, cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e furnizimit si dhe kërkesat e ENTSO-G lidhur me planifikimin e zhvillimit të rrjetit. ERE publikoi në media njoftimin për fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit të operatorëve të transmetimit dhe të shërndarjes së gazit natyror, si dhe ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe shoqëria Albgaz sh.a. shoqëria Albgaz sh.a me shkresën nr. 174 Prot., datë 29.12.2017, (protokolluar në ERE me nr. 775/1, datë 03.01.2018), ka përcjellë në ERE komente mbi Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit të operatorëve të transmetimit dhe të shërndarjes së gazit natyror”, të cilat u morën në kondideratë dhe u reflektuan në rregullore.

2.16.11 Udhëzim mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror

Është miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 34, Datë 02.03.2017. Udhëzimi mbi Kriteret për Përcaktimin e Aksesit në Hapësirat e Depozitimit të Gazit Natyror përcakton kriteret sipas të cilave vendoset regjimi i negociuar ose i rregulluar i aksesit për çdo hapësirë depozitimi të gazit natyror në Shqipëri. Qëllimi i këtij Udhëzimi është të sigurojë një treg transparent dhe që funksionon mirë për depozitimin e Gazit Natyror në Shqipëri, po ashtu të ofrojë fleksibilitet dhe mjete për sigurinë e furnizimit për përdoruesit e rrjetit në mënyrë që të furnizojnë konsumatorët e tyre në Shqipëri, gjë që do të kontribuojë në një treg të integruar dhe konkurues të gazit natyror në Komunitetin e Energjisë. ERE dërgoi draft Udhëzimin mbi “Kriteret për Përcaktimin e Aksesit në Hapësirat e Depozitimit të Gazit Natyror”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: MEI, A.K., Albpetrol sh.a, ISHTI, Phoenix Petroleum sh.p.k dhe ANIO Oil & Gas sh.a. ISHTI shprehet se është dakord në parim për miratimin e projekt udhëzimit duke e vlerësuar atë në përputhje me normat dhe standardet Europiane. • Autoriteti i Konkurrencës u shpreh se Projekt udhëzuesi në parim nuk bie në kundërshtim me ligjin nr .9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

2.16.12 Rregullore mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë.

Ka filluar procedura e miratimit, me vendimin e Bordit të ERE Nr. 206, Datë 18.12.2017. Këto rregulla kanë për qëllim të sigurojnë një proces të drejtë dhe efektiv të shërbimit të furnizimit të klienteve të gazit natyror, përmes vendosjes së kushteve të përgjithshme, në shërbimin e furnizimit të ofruar nga të Liçencuarit në Aktivitetin e Furnizimit në Sektorin e Gazit Natyror. Drafti do të konsultohet gjerësisht me palët e interesit.

2.16.13 Rregullore për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror.

Ka filluar procedura e miratimit, me vendimin e Bordit të ERE Nr. 192, Datë 24.11.2017. Rregullat përcaktojnë kushtet dhe procedurat për ndryshimin e furnizuesve të gazit natyror, të cilët furnizojnë klientin në bazë të një kontrate për furnizim si dhe të drejtat dhe detyrimet e furnizuesve të gazit natyror, klientit dhe operatorit të sistemit në kuadër të procedurës së ndryshimit të furnizuesit. Objekti i kësaj rregullore janë vendosja e rregullave për palët në kontratë, për ndryshimin e furnizuesit të gazit natyror dhe garantimin e të drejtës së klientit për të kërkuar ndryshimin e furnizuesit. Mbas mbylljes së procedurave të konsultimeve me institucionet dhe palët e interesuara, është realizuar edhe miratimi i kësaj rregullore.

2.16.14 Rregullore mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje.

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 95, Datë 04.07.2017. Qëllimi i kësaj rregullore është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent për të gjithë të liçensuarit në sektorin e Gazit Natyror, për të cilët ERE nis procedurën për vendosjen e gjobave për shkeljet e konstatuara sipas parashikimeve të Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. ERE aplikon procedura të njëjta për të liçensuarit në sektorin e gazit natyror në rastet e vendosjes së gjobave. Me Vendimin me nr. 170, datë 31.10.2016, ERE filloi procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draft “Rregullores për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror”. ERE dërgoi draft – “Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror”, për marrje mendimi, pranë subjekteve MEI, Autoritetit i Konkurrencës, Albpetrol, Phoenix Petroleum dhe ANIO Oil & Gas sh.a. Autoriteti i Konkurrencës është shprehur se draft – “Rregullorja për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror”, nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës.” MEI ka përcjellë në ERE dakortësinë e saj lidhur me draft – “Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror”. Mbas mbylljes së procedurave të konsultimeve me institucionet dhe palët e interesuara, është realizuar edhe miratimi i kësaj rregullore.

2.16.15 Licensë tip e aktiviteti të shpërndarjes së gazit natyror

Miraturar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 7, Datë 10.01.2018. Me vendimin nr. 161, datë 12.10.2017, ERE ka filluar procedurat për miratimin e Liçencës së Shpërndarjes së Gazit Natyror. Ka vijuar me publikimin me media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e Liçencës së Shpërndarjes së Gazit Natyror. ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga MIE, MFE, Autoriteti i Konkurrencës, Albgaz sh.a dhe Albpetrol sh.a. Drafti është përcjellë për komente edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë draft-liçencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Albgaz sh.a.. komentet e të cilave janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE.

2.16.16 Licensë tip e aktivitetit të transmetimit të gazit natyror

Miraturar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 8, Datë 10.01.2018. Me vendimin nr. 153, datë 28.09.2017, ERE ka filluar procedura për miratimin e Liçencës Tip të Transmetimit të Gazit Natyror. ERE ka vijuar me publikimin në media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e liçencës Tip të Transmetimit të Gazit Natyror. ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Albgaz sh.a, Albpetrol sh.a. edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë draft-liçencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, komentet e të cilave janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE. Mbas mbylljes së procedurave të konsultimeve me institucionet dhe palët e interesuara, është realizuar edhe miratimi i kësaj rregullore.

2.16.17 Liçensa e furnizimit të gazit natyror

Në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015 *”Për Sektorin e Gazit Natyror”*, Bordi i ERE me vendimin nr. 162, datë 12.10.2017, filloi procedurën për miratimin e Liçencës së furnizimit të Gazit Natyror. Në vijim të kësaj vendimarrje ERE ka vijuar me publikimin me media të njoftimit nr.100/52 Prot., datë 17.10.2017, për fillimin e procedurës për miratimin e liçencës së furnizimit të Gazit Natyror dhe me shkresën nr. 684 Prot., datë 20.10.2017 ka kërkuar komente dhe opinione nga MIE, MFE, Autoriteti i Konkurrencës, Albgaz sh.a dhe Albpetrol sh.a. Drafti është përcjellë elektronikisht edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë draft-liçencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, komentet e të cilat janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE në draft -liçencë. Mbas mbylljes së procedurave të konsultimeve me institucionet dhe palët e interesuara, është realizuar edhe miratimi i kësaj rregullore.

2.16.18 Licensë tip e aktiviteti të tregimit të gazit natyror

Me vendimin nr. 163, datë 12.10.2017, ERE ka filluar procedurën për miratimin e Liçencës tip të tregimit të gazit natyror. ERE ka vijuar me publikimin me media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e liçencës tip të tregimit të gazit natyror. ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga MIE, MFE, Autoriteti i Konkurrencës, Albgaz sh.a dhe Albpetrol sh.a. Drafti është përcjellë elektronikisht edhe pranë ENC. Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë draft-liçencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, komentet e të cilave janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE në draft –liçencë. Mbas mbylljes së procedurave të konsultimeve me institucionet dhe palët e interesuara, është realizuar edhe miratimi i kësaj rregullore.

2.17 Metodologjia e Tarifave të Gazit Natyror për TAP AG

Enti Rregullator i Energjisë miratoi Metodologjinë e Tarifave për Gazin me anë të Vendimit Nr. 127, datë 7.11.2013 , “Mbi miratimin e Metodologjisë së Tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”

Në datën 8 Nëntor 2013, tre Rregullatorët e Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAE) dhe Italisë (Aeeg) aprovuan Kodin e Tarifave të propozuar nga kompania TAP AG për TAP, tubacionin e gazit që do të sjellë gazin e Azerbajxhanit në Itali, nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë.

Kodi i Tarifave për TAP përshkruan metodologjitë e përdorura për përcaktimin e termave dhe kushteve të çmimeve që do të aplikohen për TAP do të aplikohen si për kapacitetet subjekt i aksesit të detyrueshëm të palëve të treta, edhe për kapacitetet e përjashtuara nga këto kërkesa.

Metodologjia e tarifave e propozuar nga TAP AG është transparente dhe jo diskriminuese. Kodi i Tarifave parashikon një zvogëlim të tarifës në rast të rritjes së kapacitetit të rezervuar në të ardhmen. Nga ana tjetër, në përputhje me Opinionin Final të Përbashkët, struktura e tarifave merr në konsideratë nivelin e ndryshëm të riskut ndërmjet investimit në kapacitetin fillestar dhe investimit për zgjerim në të ardhmen.

Metodologjia e Tarifave ka pësuar një sërë ndryshimesh që prej versionit të saj fillestar në sajë të komenteve të bëra prej të tre Rregullatorëve në mënyrë që dokumenti të reflektojë parimet bazë të përmendura në Final Joint Opinion. Versioni përfundimtar i metodologjisë së Tarifave është paraqitur në ERE për miratim në datën 14 tetor 2013.

Në përmbajtjen e kësaj metodologjie zbatohen kërkesat themelore të përcaktuara në Opinionin e Përbashkët në lidhje me tarifën; reflektimi në tarifë i kostove efikase, që ato të jenë transparente dhe jo diskriminuese; mekanizmi që tarifën të jenë zbritëse në vijim të rritjes së kapaciteteve transportuese që do të përdoren; marrja në konsideratë e nivelit të ndryshëm

të riskut të investimit fillestar dhe zgjerimit të mëtejshëm; tarifa të njëjta për të njëjtin produkt pavarësisht nëse ai është i ofruar prej kapacitetit të përjashtuar nga aksesit i palëve të treta apo prej kapacitetit jo të përjashtuar.

2.18 Metodologjia e Tarifave të Gazit Natyror për Albgaz (OST/OSHT)

Me miratimin e ligjit Nr.102/2015 “Për Gazin Natyror”, ministria ka në proces miratimi Modelin e Tregut të Gazit Natyror dhe ERE ka miratuar Metodologjinë e Tarifave të Gazit Natyror. Aktualisht me Vendim të Bordit Nr.178 Datë 08.11.2017 kemi miratuar “Metodologjinë e Tarifave të Gazit” me kompaninë Becker Buttner Held (bbh), e cila është një kompani e specializuar në këtë fushë. Kjo metodologji ishte kusht kryesor për çertifikimin e kompanisë Albgaz sh.a, kusht që u plotësoi në përputhje me respektimin e Direktivës dhe Rregullores së Komisionit Europian. Pas çertifikimit nga ERE u bë edhe liçensimi i kësaj kompanie e cila duhet të integrohet sa më shpejt të jetë e mundur në tregun e gazit që do të fillojë së shpejti në vëndin tonë.

2.19 Kodi i Rrjetit të TAP AG dhe Kodi i Rrjetit të Albgaz

Enti Rregullator i Energjisë është duke punuar së bashku me TAP AG, Baringa Partners një kompani Angleze e specializuar për problemet e gazit, si dhe përfaqësuesit e autoriteteve të rregullatorit të Italisë dhe Greqisë, për përfundimin sa më shpejtë të jetë e mundur të Kodit të Rrjetit (Network Code).

Pikat kyçe të diskutimit në takimet midis TAP, përfaqësuesve të Autoriteteve Kombëtare Rregulatore të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë, SDC gjatë viteve 2015- 2016- 2017, mbas një seri takimesh me përfaqësuesit e rregullatorëve(NRA-ve) në grupin e punës, me takimet e mëparshme që ndodhën më qershor 2015, tetor 2015, dhjetor 2015, prill 2016, tetor 2016, prill 2017 dhe korrik 2017.

Qëllimi i këtyre takimeve ka qënë:

- Të paraqesë një draft ligjor të punës të Kodit të Rrjetit të TAP-AG dhe të diskutojë fillimin e procesit të konsultimit publik
- Të marrin udhëzime dhe të diskutojnë bashkarisht midis tre rregullatorëve të tre shteteve, Itali, Greqi dhe Shqipërisë për të gjitha problemet që kanë të bëjnë me këtë Kod.

Përfaqësuesit e Ekipit të Shah Deniz kanë marrë pjesë kryesisht në takimet si vëzhgues dhe për të siguruar të dhëna, aty ku kërkohej, nga perspektiva e interoperabilitetit me projektet në rrjedhën e sipërme të zinxhirit të gazit Shah Deniz.

Kjo ka qënë shumë e rëndësishme sepse paralel kësaj ERE po merret me Kodin e Rrjetit të Albgaz-it, shumë i nevojshëm për paraprirjen e proceseve të fillimit të operacioneve të TAP AG në vëndin tonë.

Duhet të theksoj se kodi i rregullimit si i TAP AG ashtu edhe i Albgaz, është një punë voluminoze dhe shumë specifike për kushtet në të cilën ndodhemi. Në përbërje të tyre përfshihen:

Kapitujt e Kapaciteteve të prodhimit, Kapaciteteve të bukingut, nominimet, balancimet dhe alokimet, menaxhimi i konxheksioneve, tregu sekondar, konsumi vetjak i gazit dhe konsumi për prodhim energji elektrike, humbjet e gazit, sistemi i matjes, mirëmbajtja, kuadri rregullator dhe dispozitat e ndryshme për penalitetet.

2.20 Vëmëndjet kryesore që janë për sektorin e Gazit Natyror

Me miratimin e ligjit të ri të gazit No.102/2015, “Për Gazin Natyror” vëndi jonë ka implementuar “Paketën e Trete të Energjisë” dhe është kështu një nga vendet e para që po aplikojnë këtë paketë, kur më parë nuk kishin arritur të implementonin “Paketën e Dyte të Energjisë”.

Në këto kushte del në mënyrë emergjente aplikimi i kësaj pakete e cila kërkon një angazhim total jo vetëm të Entit Rregullator të Energjisë, por edhe institucioneve të tjera që kanë lidhje me këtë problem.

Janë në rrugën e zgjidhjes disa probleme të domosdoshme që do shpejtojnë procesin e përgatitjes sa më shpejt të jetë e mundur dhe konkretisht:

U krijua me vendim qeverie Albgaz(OST-G/DSO-G), kjo ishte mjaft urgjente sepse koha për operim e operacioneve të TAP AG po ngushtohet dhe krijimi i sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit ishte në kufijtë maksimalë

Albgaz-i tashmë është certifikuar nga ERE, në përputhje me ligjin kombëtar të gazit natyror, sepse ajo është tashmë Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe të Shpërndarjes të Gazit në vëndin tonë. Mbas certifikimit Albgaz-i u liçensua edhe për transmetim edhe për shpërndarje të gazit natyror.

Për të gjitha këto, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, ka zbatuar Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Ministrave të datës 13 korrik 2009; Rregullores 715/2009/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009 dhe të Ligjit Nr.102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’

Tashmë është e ditur që vëndi ynë ka ratifikuar Traktatin e Krijimit të Komunitetit të Energjisë dhe është pale kontraktuese e detyruar të ndër marrë të gjitha hapat për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky Traktat.

Jemi duke punuar për përshtatjen e legjislacionit të Albgaz-it, në përputhje me Direktivën e gazit 2009/73/EC të Këshillit dhe Parlamentit Evropian date 13 Korrik 2009, të Rregullores(CE) nr. 715/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit date 13 Korrik 2009 dhe të ligjit të ri të gazit Nr. 102/2015.

Përfundimi i miratimit të tyre do të shërbejë për plotësimin e kuadrit të legjislacionit sekondar të domosdoshëm për aktivitetin e Albgaz-it, si opertor i transmetimit dhe

shpërndarjes së gazit Natyror. Kjo do të shërbejë gjithashtu sepse tani që është bërë çertifikimi i Albagaz-it janë dhënë dhe liçensat e aktivitetit të operatorit të transmetimit dhe shpërndarjes së Albagaz, tani kjo kompani duhet të integrohet në tregun e gazit sepse:

- TAP-i tashmë ka avancuar shumë në punimet e ndërtimit në territorin e vendit tone. Brenda vitit 2019 ai do të ketë përfunduar ndërtimin e tij dhe do të jetë i gatshëm për transportin e gazit drejt Italisë, por edhe për nevojat e vendit tonë. Është në të mirë të vëndit tonë që OST-ja e re e gazit të bëhet funksionale menjëherë, pasi duhet të futet në marrëdhënie kontraktuale me TAP-AG për punime ndihmëse.
- Këto marrëdhënie TAP-AG ndërkohë po i ndërton me vëndet fqinje si Greqia dhe Italia.
- Jo me vone se fillimi i operacioneve të TAP-it, do të behet një Testim i Tregut (MARKET TEST), për alokimin e kapaciteteve. Me pas do të kete testime tregu cdo dy vjet sipas FJO të miratuar nga tre autoritetet e Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë.

2.21 Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare

Enti Rregullator i Energjisë ka një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me Energjinë Elektrike dhe Gazin Natyror.

Në jemi shumë aktiv në ECRB (Energy Community Regulatory Board), në ACER (Agency for the Cooperation of Energy Regulators), që të dyja këto institucione janë pranë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vienë. Jemi anëtar dhe bashkëpunojmë ngushtë me IGU (International Gas Union) ku marim pjesë në të gjitha takimet që organizohen si për Gazin Natyror, Gazin Natyror të Lëngëzuar (LNG), gazin Natyror të Kompresuar (CNP).

Në kuadër të bashkëpunimit shumë-palësh mes Enteve Rregullatore pjesëmarrëse të MEDREG (Shoqata e Rregullatorëve të Mesdheut) ERE është shumë aktive.

PJESA III: Aktiviteti i Entit Rregullator të Energjisë

3.1 Mbi realizimin e detyrave të ERE-s për vitin 2017. (Rezoluta e Kuvendit)

Në kuadër të zbatimit të detyrave që i ngarkojnë ligjet për energjinë elektrike dhe gazit natyror si dhe detyrat që rrjedhin nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, ERE ka organizuar punën dhe mobilizimin e stafit për të arritur përmbushjen e të gjitha detyrave. Në analizë të detyrave rezultoi sa vijon:

1. Në lidhje me kërkesën për miratimin e tarifave të reja ku t'i kushtojë një vëmendje të veçantë, nga njëra anë, mbrojtjes së konsumatorëve për tarifa dhe çmime sa më të drejta e të përballueshme dhe, nga ana tjetër, rritjes së cilësisë së shërbimit dhe performancës së kompanisë sqarojme se:

ERE me Vendimin me nr. 52, datë 06.04.2017, vendosi “Lënien në fuqi të Vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017”.

Kjo vendimarrje u realizua në kuadër të një procesi që përfshin:

- Analiza e informacioneve të marra në lidhje me të ardhurat e kërkuara nga ana e shoqërive. Analiza ka konsistuar në krahasimin e të ardhurave të kërkuara, të miratuara nga Bordi i ERE-s për vitin 2015 dhe atyre faktike për të njëjtën periudhë, shpenzimet faktike të viti 2016 si dhe ato të pritshme për vitin 2017 sipas aplikimeve dhe informacioneve shtesë. Nga këto analiza dhe vlerësime të përgjithshme rezultoi se, shoqëritë KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. kanë performancë të kënaqshme e përgjithësisht kanë mbuluar kostot e veprimtarive të këtyre aktiviteteve përgjatë periudhës 2015 – 2016 si dhe kanë krijuar një rezervë për zhvillimin normal të aktiviteteve të licencuara dhe përmirësimin e mëtejshëm të performancës në operim.

- Bashkëpunimit me MIE në zbatim edhe të parashikimeve të nenit 10 pika 2 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

MIE ka bërë me dije se mbajtja e të njëjtave tarifave do të garantonte zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërive deri në përmbyllje të proceseve të nisura në kuadër të reformave sektoriale. Në keto rrethana mbi bazën e argumentimit mbi mjaftueshmërinë e të ardhurave të shoqërive KESH, OST dhe OSHEE, u vlerësua mbajtja e të njëjtit rregjim tarifar për vazhdimësinë normale të veprimtarisë së tyre edhe për vitin 2017.

Sa i takon percaktimit të tarifave për vitin 2018 ERE Bordi i ERE-s miratoi me Vendimin Nr. 210, Datë 28.12.2017 tarifën e transmetimit prej 0.75 leke /kWh për vitin 2018.

Kjo vendimarrje u bazua në Metodologjinë e llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, të miratuar me Vendimin Nr. Nr. 180, Datë 08.11.2017 të Bordit të ERE-s, dhe reflektoi në llogaritjen e të ardhurave të kërkuara për vitin 2018 korrigjimin e të ardhurave të tepërta të realizuara gjatë periudhës 2015-2017.

*Te detajuara shpjegimet për këtë vendimarrje gjenden në kapitullin për Tairfat .

2. Në rezolutë kërkohet që ERE të vijojë punën për nxitjen e krijimit të një tregu të brendshëm dhe hapjen efektive të tregut për të gjithë klientët dhe furnizuesit, në veçanti, në dritën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, duke siguruar shërbime të drejta, të sigurta dhe të argumentuara për klientët dhe përdoruesit e sistemit energjetik në vend, si dhe të mbështesë investime strategjike dhe teknologjike, të cilat rrisin konkurrencën dhe përmirësojnë nivelin e shërbimeve në tregun e energjisë elektrike.

Drejtimet kryesore të zhvillimeve në sektorin e energjisë, janë ndarja e përgjegjësive të sektorit si gjenerim, prodhim, transmetim, shpërndarje dhe furnizim. Kjo për të krijuar një treg të hapur dhe kompetitiv. I gjithë procesi do të kryhet me një transparencë të plotë. ERE në këtë aspekt ka qënë në krye të këtij procesi duke marrë pjesë aktive për të kryer me sukses gjithë transformimet që do të pësojnë kompanite e sektorit të energjisë. Është për tu përmendur se është krijuar e gjithë infrastruktura ligjore për ndarjen e shpërndarjes nga furnizimi për energjinë elektrike dhe jemi në prag të realizimit të kësaj ndarjeje. Ndërkohë janë miratuar gjithë maodalitetet për futjen e furnizuaseve të pavarur dhe metodat e zgjedhjes se furnizuesit. Gjithashtu për të bërë me transparent procesin e transaksioneve në fushën e blerjeve dhe shitjes së energjisë u miratuan rregullat e reja për këto transaksione nëpërmjet platformës elektronike, që tani është efektive.

Për hapjen e tregut janë përfunduar miratimet e tarifave të aksesit në nivele të ndryshme të tensionit.

ERE ka dhënë një kontribut edhe për përpilimin e rregullave dhe kuadrit organizativ për krijimin e bursës së energjisë, që është objektiv i Qeverisë për periudhën afatshkurtër.

3. Në Rezolutë perckatohet se në kuadër edhe të ligjit të ri “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të bashkëpunojë me të gjithë aktorët, si dhe të luajë një rol proaktiv për krijimin e kushteve të nevojshme dhe nxitjen e investimeve për prodhimin e energjisë, jo vetëm nga burimet hidrike, por edhe nga era, dielli, biomasa etj., duke bërë kështu të mundur rritjen e diversifikimit të burimeve të energjisë, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji në vend, si dhe uljen e shkallës së lartë të riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

Lidhur me këtë detyrë të Rezolutës rezulton se:

Për ligjin e burimeve të rinovueshme janë bërë gjithë lehtësirat për të mundësuar investime të kapitalit privat në koherencë me direktivat e Qeverisë për të mundësuar detyrimet që rrjedhin nga strategjia dhe detyrimet që Shqipëria ka për këto burime. Gjithashtu kemi dhënë kontribut direkt për të stimuluar skemat e net metering për shfrytëzimin e energjisë së diellit.

Bazuar në pikën 3 të nenit 10 të Ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave nëpërmjet VKM nr. 369, datë 26.4.2017, ka miratuar “Metodologjinë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era.” Në zbatim të sa më sipër ERE ka detyrimin të miratojë çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga

dielli dhe era, në përputhje me metodologjinë e sipërpemendur dhe kostot e mesatarizuara për vitin 2017.

Në vijim ERE, mbasi shqyrtoi VKM nr. 369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, dhe kreu konsultime me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë si dhe Autoritetin e Konkurrencës dhe analizoi të dhënat e marra në kuadër të monitorimit në impjantin PV në UKKO për marrjen e informacioneve në lidhje me kostot e investimit, O&M, shpenzime pune, si dhe kostot financiare e orët e punës me kapacitet të plotë, Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 120, datë 27.07.2017 përcaktoi sa vijon:

- Për vitin 2017 çmimi për të gjithë kontraktuesit e ndërtimit të impjanteve të jete: për burimet e energjisë PV(Fotovoltaikët) në vlerën 100 Euro/MWh për burimet e energjisë nga era (Eolike) 76 Euro/MWh
- Duke filluar nga viti 2018, për investimet në vijim, ERE, në bazë të grumbullimit të të dhënave, përta i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e VKM nr. 369 datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, i propozojë MEI-t për përmirësimin dhe rishikimin e VKM-së.
- Gjithashtu gjatë vitit 2018 është kryer edhe perditësimi i Çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2017. Në përfundim edhe për vitin 2017 mbeti në fuqi çmimi 7,448 lekë/kWh i njejtë me atë të vitit 2016.
*Detajime në kapitullin e Çmimeve e Tarifave

ERE me Vendimin Nr. 19, Datë 19.01.2018 miratoi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018 prej 8.5652 Lekë/kWh. Kjo vendimarrje vjen në zbatim të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi” të miratuar me VKM Nr 667 datë 22.11.2017 ERE përcaktoi çmimin përkatës menjëherë pas publikimit të raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) për vitin 2017.

*Detajime në kapitullin e Çmimeve e Tarifave

4. Një tjetër kërkesë e Rezolutës lidhet me:

Në miratimin e planit të investimeve të OST- së dhe OSHEE-së, t’i kushtojë një vëmendje të veçantë rritjes së investimeve, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së furnizimit të konsumatorit me energji elektrike.

- Të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), si dhe me institucionet e tjera, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i hollësishëm i projekteve të reja të mundshme për ndërtimin e hidrocentraleve, duke

i kushtuar një rëndësi të veçantë impaktit në zona që përbëjnë interes të veçantë lidhur me natyrën.

Lidhur me këtë detyrë rezulton se:

Kemi mbeshtetur në kuadër të përgjegjësiave për miratimin e investimeve si shoqërinë e transmetimit ashtu dhe të shpërndarjes për të mbeshtetur zhvillimet dhe realizimin e objektivave të tyre.

Aktualisht ERE ka miratuar Planin e Investimeve të kompanisë “OSHEE” sh.a, për vitin 2017 dhe ka miratuar Planin e Investimeve OST sh.a për vitin 2017 dhe atë dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit përkatesisht me Vendimet nr. 209, datë 28.12.2017 dhe 212, datë 28.12.2017.

Në vlerësim të kuadrit ligjor në fuqi, angazhimit të vendit në kuadër të detyrimeve që burojnë nga Traktati i Komunitetit të Energjisë Elektrike miratuar me Ligjin nr. 9501, datë 03.04.2006 dhe përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015, “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” në reflektim të komenteve të ENC dhe USAID, gjatë vitit 2017 Bordi i ERE vendosi:

Miratimin e “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.”

Nëpërmjet miratimit të këtij dokumenti vendosen rregulla që përcaktojnë përmbajtjen dhe afatin e dorëzimit në kohë në ERE, të planit të investimeve të OST dhe OSSH, si dhe vlerësimin dhe analizën e kriterëve të aplikueshme dhe miratimin e tyre (ose rishikimin) nga ERE, për të siguruar që planet e investimit të jenë në përputhje me parimet e planifikimit me kosto më të ulët, rregullat dhe kërkesat e zbatueshme për sigurinë e operimit të rrjetit, cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e furnizimit si dhe kërkesat e ENTSO-E lidhur me planifikimin e zhvillimit të rrjetit.

Në kuadër të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi në ENTSO-E është vendosur detyrimi si më poshtë:

“Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të sigurojë që plani i investimeve i dorëzuar të jetë në përputhje me parashikimet e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit në Shqipëri dhe me planin e ENTSO-E pan-EU TYNDP, dhe në përputhje me informacionin e paraqitur në ENC për projektet/propozimet me interes të ENC.”

- Në rezolutë Kuvendi ka përcaktuar edhe detyrimin e ERE që të vijojë punën për hartimi dhe përmirësimin e një sërë aktesh nënligjore të sektorit të mbrojtjes së konsumatorit, të cilat, tashmë, në funksion të ligjit të ri të sektorit, i pajisin palët e interesit me të drejta të plotësuar, por edhe i vendosin përpara detyrimeve të reja.

Lidhur me sa më sipër sqarohet se :

Zhvillimet në drejtim të implementimit të reformës në sektorin e energjisë u kurorëzuan me miratimin e katër (4) ligjeve bashkohore për këtë sektor, si ligji për energjinë elektrike, ligji për gazin natyror, ligji për energjitë e rinovueshme dhe ligji i efikasitetit të energjisë. Ky kuader

ligjor duhej mbështetur me akte nënligjore, ku pjesa më e madhe janë përgjegjësi e ERE. Në këtë situatë me urdhër të Kryetarit u organizuan grupet e punës për identifikimin dhe hartimin e të gjitha akteve nënligjore që bëjnë mire funksionimin e bazës së re ligjore. Puna e ERE për mbrojtjen e konsumatorit ka konstatuar dhe në hartimin e akteve nënligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorit që derivojnë nga Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Këto akte kryesisht janë:

- **“Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientet fundorë” .**
- **“Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.**
- **“Rregullorja për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.**
- **“Rregullorja për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”.**
- **“Metodologjisë së llogaritjes së rimbursimit të dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”**
- **“Regullores mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”.**

Për arritjen e realizimit të kësaj detyre, për të arritur një performancë të lartë të hartimit, është vepruar në bashkëpunim, në mënyrë të veçantë me Autoritetin e Konkurrencës dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vienë. Cdo akt është miratuar pas kryrjes së procesit të konsultimeve me këto institucione. Ndërkohë nëpërmjet seancave dëgjimore është marrë në konsideratë edhe zëri i grupeve të interesit. Disa nga aktet e miratuara nga ERE gjatë vitit 2017 përfshijnë:

- Rregulloren e Planit të Investimeve.
- Marrëveshjen e shërbimit të Transmetimit.
- Marrëveshje për pjesëmarrje në treg.
- Rregullore për rregjistrimin në tregun e energjisë.
- Udhëzimin mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.
- Rregullat për garancitë financiare.
- Rregullore e Alokimit të Kapaciteteve.
- Rregullat e heqjes së licencave.
- Rregulloren e licencimit në sektorin e gazit natyror.
- Kontratë për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë.
- Programi i përputhshmërisë rregullatore.
- Rregulloren e gjobave në sektorin e gazit natyror.

- Rregulloren për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike.
- Marrëveshje e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe Furnizuesit të energjisë elektrike.
- Rregullore mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike.
- Për disa ndryshime në Vendimin e ERE Nr 103 datë 23.06.2016 , “Mbi Miratimin e Rregullores për Procedurat e Blerjes së Energjisë Elektrike për Mbulimin e Humbjeve në Rrjetet e Shpërndarjes dhe të Transmetimit dhe për Blerjen dhe Shitjen e Energjisë Elektrike për të Siguruar Përbushjen e Detyrimeve të Shërbimit Publik”

Gjithashtu janë në fazën e konsultimit disa aktet për të cilët ERE ka hartuar draft rregullat si me poshtë:

- “Rregullat për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike”
- Licenca për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror
- Licenca për aktivitetin e furnizimit të gazit natyror
- Licenca për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror
- Si dhe aktet e cituara me sipër me fokus mbrojtjen e kosnuamtorit.
Ky vendim u mbështet edhe tek VKM Nr.171 datë 25.02.2015, “Për miratimin e Planit të Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Energjisë Elektrike”, i cili e vlerësoi si të disfavorshëm raportin e lartë të levës financiare, ndaj orjentoj që: “*çdo lloj financimi i ri duhet të paraqitet si një formë kapitali i vet, veçanërisht në OSHEE, për të zgjeruar bazën e tij të pronësisë dhe evituar projeksionet negative financiare të agreguara, për periudhën 2015-2017 dhe reduktimin e impaktit negativ nga rritja e tejskajshme e levës financiare në një mjedis tejet të paqëndrueshëm*”.

MEI në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin e politikave të sektorit, me të cilin ERE bashkëpunon në zbatim edhe të parashikimeve të nenit 10 pika 2 të Ligjit 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë Elektrike”, vlerësoi mbajtjen e regjimit të njëjtë tarifor për vitin 2017, për të tre kompanitë në mënyrë që të mbështeste sektorin energjitik nëpërmjet qëndrueshmërisë financiare për shkak se:

- *Ministria e Energjisë dhe Industrisë ishte drejt përfundimit të procesit për bërjen efektive të Marrëveshjes së Huasë mes KESH sh.a. dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin “Shqipëria, Plani i Ristrukturimit të KESH”, Marrëveshja e Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë që të garantohej përmbushja e kushteve financiare të parashikuara, me qëllim shmangien e kostove financiare shtesë.*

- Nga ana e MEI-t në bashkëpunim me Bankën Botërore, po përmbylej procesi i rishikimi të Planit të Rimëkëmbies së Sektorit të Energjisë Elektrike dhe problematika e marrëdhënieve të ndërsjella të kompanive.

Në këto rrethana mbi bazën e argumentimit mbi mjaftueshmërinë e të ardhurave të shoqërive KESH sh.a., OSTsh.a. dhe OSHEE sh.a. për vazhdimësinë normale të veprimtarisë së tyre edhe për vitin 2017, ERE me Vendimin Nr. 52 datë 06.04.2017 vendosi:

1. Shtyrjen deri në 31.12.2017 të fuqisë juridike të vendimit Nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE për lënien në fuqi të tarifave dhe çmimeve të përkohëshme të energjisë elektrike të miratuara me Vendimet Nr. 139, Nr. 145, Nr.146, Nr.147, dhe Nr.148 datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s
2. Fuqia Juridike e Vendimit Nr.13, datë 16.02.2016 “Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 2016”, sipas pikës 1 të vendimit Nr.190 datë 22.12.2016, të Bordit të ERE, shteron me marrjen e vendimit për përcaktimin e tarifës fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2017 në zbatim të ligjit Nr.7/2017 “P r nxitjen e p r dorimit t energjis nga burimet e rinovueshme”.

Në vijim po japim paraqitjen grafike të ndryshimit të kapitalit të vet (negativ) për shoqërinë OSHEE sh.a. për periudhën 2014-2017:




Figure 59 Ecuria e kapitalit të vet për OSHEE sh.a (Burimi OSHEE sh.a)

3.4.2 Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a.

Operatori i Sistemit të Transmetimit, i licencuar për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike, aplikoi në ERE për rishikimin e tarifës së transmetimit për vitin 2018. OST sh.a. propozoi katër tarifa të ndryshme për katër variante të mundshme, të cilat variojnë nga 1,52 Lekë /kWh deri në 0.65 lekë/kWh, ose 2,3 herë më të lartë deri në nivel të njëjtë me tarifen aktuale.

ERE bazuar në:

- Metodologjinë e llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, të miratuar me Vendimin Nr. 180, Datë 08.11.2017 të Bordit të ERE-s,
- Analizën e pasqyrave financiare të OST për vitet 2015-2017 dhe të informacionit të paraqitur në aplikim e më pas informacionit shtesë të dërguar nga kompania në përgjigje të kërkesave të ERE-s,
- Argumentave të OST sh.a. të parashtruara në seancën teknike,
- Opinioneve të parashtruara nga palët e interesit,

reflektoi në llogaritjen e të ardhurave të kërkuara për vitin 2018 korigjimin e të ardhurave të tepërta të realizuara gjatë periudhës 2015-2017. Të ardhurat e kërkuara prej 5,451 milion lekë, të miratuara për vitin 2018 i mundësojnë shoqërisë prokurimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim dhe të shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit me çmime tregu, ashtu sikurse përcaktohet në Nenin 62 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”

Bordi i ERE-s miratoi me Vendimin Nr. 210, Datë 28.12.2017 tarifën e transmetimit prej 0.75 lekë /kWh për vitin 2018.

3.4.3 Lënia në fuqi e Vendimit Nr.52 datë 06.04.2017 të Bordit të ERE-s”, mbi çmimet me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018

OSHEE sh.a. e licencuar për aktivitetin e shërbimit të shpërndarjes dhe furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike, pas kërkesës së përsëritur nga ana e ERE-s, aplikoi për rishikimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivele tensioni dhe për çmimet e shërbimit të furnizimit universal për vitin 2018.

OSHEE sh.a. paraqiti një analizë të realizimit të treguesve tekniko-financiarë për periudhën 2015-2017, me fokus të veçantë në realizimin e pritshëm të performancës së OSHEE sh.a. për vitin 2017.

Në përfundim të kësaj analize, OSHEE sh.a. duke arsyetuar se: “meqënëse tarifa mesatare e përlllogaritur për vitin 2018 është thuajse e njëjtë me atë të vitit 2015, dhe duke u mbështetur në përvojën pozitive të arritjeve të periudhës 2015-2017” propozoi që:

- Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të jetë ajo e miratuar me vendimin Nr. 147 datë 25.12.2014 të Bordit të ERE-s
- Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike si dhe çmimet e detajuara për kategoritë e klientëve sipas niveleve të tensionit të jenë ato të miratuara me vendimin Nr.148 datë 25.12.2014 të bordit të ERE-s.
- Tarifat e aksesit për nivele tensioni të jenë:
 - 2.36 lekë/kWh për nivelin e tensionit 35 kV
 - 3.81 lekë/kWh për nivelet e tensionit 20-6 kV
 - 5,51 lekë/kWh për nivelin e tensionit 0,4 kV.

Në zbatim të rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, aplikimi i ardhur në datë 14.12.2017, kërkonte të paktën katër muaj në mënyrë që të realizohej: analiza e informacionit të paraqitur nga ana e OSHEE sh.a., kërkesa për argumentat shtesë, transparenca, tërheqja e opinionit të palëve të interesit dhe reflektimi i tyre, organizimi i seancave teknike e publike, etj.

Duke konsideruar faktin që procedura për shqyrtimin e aplikimit deri në vedimmarrje kërkonte kohë, ndërkohë që aplikimi nga ana e OSHEE sh.a. ishte tejet i vonuar, Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 211, Datë 28.12.2017 vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për nivele tensioni për vitin 2018.
2. Lënien në fuqi të pikës “1” të Vendimit Nr. 52, datë 06.04.2017 “Mbi lënien në fuqi të Vendimit Nr. 190 datë 22.12.2016 të Bordit të ERE-s”, sipas tabelës më poshtë:

TIPI I AKTIVITETIT	NR. I VENDIMIT	TARIFAT E MIRATUARA
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	Nr. 52, Datë 06.04.2017	1.5 Lekë/Kwh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV	Nr. 52, Datë 06.04.2017	3.9 Lekë/Kwh
Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes	Nr. 52, Datë 06.04.2017	4.79 Lekë/Kwh
Çmimi I shitjes për Klientët në 20 kV *	Nr. 52, Datë 06.04.2017	11 Lekë/Kwh Në Pik 12.65 Lekë/Kwh
Çmimi I shitjes për Klientët në 10/6 kV *	Nr. 52, Datë 06.04.2017	11 Lekë/Kwh Në Pik 12.65 Lekë/Kwh
* Miratim I përkohshëm për klientët që nuk arrijnë të sigurojnë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit në përputhje me VKM nr. 449, datë 15.06.2016, furnizimi si mundësi e fundit i këtyre klientëve kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit me çmimet si më lart		
Çmimi I shitjes për Konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU	Nr. 52, Datë 06.04.2017	12.4 Lekë/Kwh Në Pik 14.3 Lekë/Kwh
Çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor	Nr. 52, Datë 06.04.2017	*Çmimet paraqiten në tabelën më poshtë
TARIFAT E SHËRBIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDOR		
Niveli I tensionit	Cmimi (Leke/kWh)	Cmimi pik (Leke/kWh)
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjarë	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndriçim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Leke/Muai)		200
*Çmimi I energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të energjisë aktive		
*Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është :		
Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00		
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		

3. Lënien në fuqi të Vendimit Nr. 53 datë 06.04.2016 “Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi universal për kategorinë objekte kulturi/bashkësi fetare datë 06.04.2017”

3.4.4 Prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe impakti i tyre

Prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike (HEC-et me fuqi deri në 15 MW) në vitin 2017 pësoi një ulje prej rreth 27% krahasuar me vitin 2016. Ndikim kryesor në rënien e prodhimit nga këta prodhues ishin prurjet e pakta hidrike gjatë vitit 2017. Futja në operim gjatë vitit 2017 e 5 centraleve të rinj me fuqi të instaluar 11,525 MW dhe një prodhim prej 27,8 GWh, nuk zvogëloi efektin negativ të kushteve të pafavorshme hidrike.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e energjisë së prodhuar dhe të ardhurat e realizuara në vite nga shitja e energjisë elektrike për prodhuesit me përparësi dhe HEC

Ashta.




Figure 60 Prodhimi vjetor i Prodhuesve me Përparësi & HEC Ashta (MWh)

Prodhimi më i ulët i energjisë elektrike ndikoi në uljen e të ardhurave të realizuara nga prodhuesit me përparësi në krahasim me vitin 2016. Për vitin 2017 çmimi i blerjes së energjisë nga këta gjenerues ishte i njëjtë me atë të vitit paraardhës.

Të ardhurat e realizuara ndër vite nga prodhuesit me përparësi paraqiten në grafikun në vijim:




Figure 61 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi (Burimi OSHEE sh.a.)

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve të miratura për prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet për periudhën 2004-2017:




Figure 62 Ecuria e çmimeve të miratuara për prodhuesit me përparësi

Tendenca në rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi ku përveç shtimit të kapaciteteve prodhuese të impianteve hidro, në të ardhmen parashikohet të fillojnë prodhimin edhe impiantet fotovoltaike, eolike dhe inceneratorët që kanë lëndë të parë pjesën e biodegradueshme të mbetjeve të ngurta urbane, ndikon në rritjen edhe më tej të peshës specifike që zë prodhimi nga prodhuesit me përparësi, ndaj konsumit total të energjisë elektrike.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e peshës specifike të prodhimit nga prodhuesit me përparësi kundrej konsumit total:




Figure 63 Peshë specifike e prodhimit te prodhuesve me përparësi nga konsumit total (Burimi OST sh.a OSHEE sh.a ERE)

OSHEE sh.a., në zbatim të VKM Nr.244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e Detyrimit të Shërbimit Publik”, ka detyrimin për blerjen e energjisë së prodhuar nga prodhuesit me përparësi. Rritja e mëtejshme e prodhimit nga këta prodhues për shkak të shtimit të kapaciteteve prodhuese jo vetëm nga teknologjia me hidro, por edhe nga teknologjitë e tjera të burimeve të rinovueshme, ndikon ndjeshëm në koston për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE sh.a..

Grafiku në vijim paraqet strukturën e shpenzimeve të OSHEE sh.a. për blerjen e energjisë elektrike për vitin 2017:





Figure 64 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. (Burimi OSHEE sh.a.,ERE)

Për shkak të kushteve të pafavorshme hidrike, shpenzimet për blerjen e energjisë nga prodhuesit me përparësi në vitin 2017 zinin rreth 19% të shpenzimeve totale për energji të OSHEE sh.a nga 39.6% në periudhën parardhëse. Ndërkohë u verejt rritje e shpenzimeve për blerjen e energjisë në tregun e parregulluar nga 25.8% në 64.5 % të totalit të shpenzimeve. Blerja në tregun e parregulluar, kompensoi rënien e prodhimit nga impiantet hidrike si KESH sh.a., Hec Ashta dhe prodhuesit me përparësi duke bërë evidente nevojën e diversifikimit të burimeve gjeneruese.

Nxitja e investimeve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë, i shërben diversifikimit të burimeve në Shqipëri dhe arritjes së objektivit kombëtar prej 38% në vitin 2020.

Sfidë mbetet gjetja e rrugëve për nxitjen e investimeve eficiente, për mundësinë e daljes së tyre në tregun e parregulluar si dhe shtrirjen e kontributit për mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme tek të gjithë klientet fundorë.

3.4.5 Çmimi i përditësuar i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2017.

VKM Nr. 687, datë 22.11.2017 miratoi “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”. Sipas kësaj metodologjie çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike përcaktohet nga: çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin në bandë i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh , një koeficient bonus për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 dhe norma mesatare e këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

VKM Nr. 687, datë 22.11.2017 përcaktoi gjithashtu edhe kufijtë maksimal dhe minimal të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi të cilët janë: jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016.

Pika 5 e Vendimit të ERE-s Nr.190 datë 22.12.2016 i cili la në fuqi Vendimin Nr. 13, datë 16.02.2016 “Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 2016” përcaktoi detyrimin për përditësimin dhe kompensimin e të gjitha efekteve të mundshme financiare për të licensuarit në periudhën pasardhëse.

Në zbatim të këtij detyrimi, ERE kreu llogaritjet për përditësimin e çmimit për vitin 2017, me qëllim llogaritjen e kompensimeve të mundshme në periudhën pasardhëse.

Sipas raportit vjetor të çmimeve për tregun e ditës në avancë për vitin 2016 të publikuar në faqen zyrtare të Bursës Hungareze rezultoi se çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë

(HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin në bandë (baseload) për vitin 2016 ishte 35.43 EUR/MWh.

Nga informacioni i publikuar nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit Lekë/EUR për çdo muaj të vitit 2016, rezultoi se kursi mesatar për vitin 2016 ishte 137.36 Lekë/EUR .

Nisur nga këta tregues dhe në zbatim të formulës përlogaritëse të metodologjisë së miratuar me VKM Nr. 687, datë 22.11.2017 rezultoi çmimi i blerjes së energjise prej 6.33 leke/kWh i cili është më i ulët se kufiri minimal prej 7.448 lekë/kWh siç përcaktuar në dispozitën 2.ç te VKM Nr 687.

Në perfundim edhe për vitin 2017 mbeti në fuqi çmimi 7,448 lekë/kWh i njëjtë me atë të vitit 2016.

3.4.6 Çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet që shfrytëzojnë burimet e rinovueshme nga dielli dhe era për vitin 2017.

VKM Nr. 369 datë 26.4.2017 miratoi “Metodologjinë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” dhe ngarkoi Entin Rregullator të Energjisë të miratojë çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

Metodologjia përcaktoi kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arësyeshëm të vlerës së investimeve. Në themel të kësaj metodologjie është llogaritja e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nëpërmjet formulës llogaritëse të LCOE-së.

$$LCOE = \frac{\sum e \text{ kostove gjatë jetëgjatësisë}}{\sum e \text{ energjisë elektrike të prodhuar gjatë jetëgjatësisë}} = \frac{\sum_{t=1}^n \frac{I_t + M_t + F_t}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

Duke konsideruar rezultatet e studimeve të kryera nga IRENA dhe ECOFYS, metodologjia ka përcaktuar edhe vlerat elementeve të rëndësishëm të formulës si vlera e investimeve për njësi kapaciteti të instaluar dhe norma mesatare e ponderuar e kthimit të kapitalit për periudhën 2017-2019 sipas tabelës së mëposhtme:

ERE, mbasi shqyrtoji VKM, formuloi një sërë pyetjesh për sqarimin e kësaj metodologjie.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën e saj Nr. 4445/1, datë 04.07.2017, i dergoi ERE-s sqarimet nga ku në përfundim konkludon:

1. Objekti i Metodologjise është përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga impiante të vogla gjeneruese me burime të rinovueshme deri në 2MW për impiantet fotovoltaikë dhe deri në 3MW instalime me impiante eolike. Kjo Metodologji reflekton politikën energjitike të Keshillit të Ministrave, në përputhje me parashikimet e vendosura nga legjislacioni përkatës.
2. Me qëllim mospengimin e investimeve të reja në këtë fushë, deri në momentin e hartimit të procedurave të ankandit dhe metodologjinë përkatëse, ky çmim mund të shërbejë si një komponent i procedurës konkurruese për kontratën për diferencë (CfD) mbi bazën e të cilit do të zhvillohen procedurat e ankandit pas hartimit të kushteve dhe procedurave në përputhje me pikën 4, të nenit 9 të ligjit 7/2017.
3. Nisur nga fakti se nuk zotërohen eksperiencat e tjera apo të dhëna mbi kostot reale të projekteve, çmimi i referuar si i mesatarizuar në metodologji, duhet ti shërbejë ERE gjatë vendimmarrjes për vitin 2017. Ndërkohë për vitet në vijim, ERE do miratojë çmimet mbi bazën e të dhënave të LCOE dhe WACC sipas tabelës ose sipas të dhënave konkrete të kostove reale të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

Në vijim të komunikimeve me MIE, përfaqësuesit e saj deklaruan se nëse ERE gjatë zbatimit të këtyre çmimeve përgjatë vitit 2017, vëren luhatje, mospërputhje dhe paqartësira, ajo mund të bëjë propozime konkrete për përmirësimin dhe rishikimin e metodologjisë për periudhën në vazhdim.

ERE gjykon se përcaktimi i çmimeve të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, i shërben nxitjes së investimeve në burimet e rinovueshme të teknologjive të ndryshme nga ajo e HEC-eve duke ndikuar në rritjen e diversifikimit të burimeve të rinovueshme në Shqipëri si dhe arritjes së objektivit kombëtar prej 38% deri në vitin 2020.

Në bazë të metodologjisë së miratuar nga Këshilli i Ministrave, dhe duke marrë parasysh mungesat e të dhënave lidhur me kostot e investimit dhe operimit të teknologjive fotovoltaike dhe eolike në vend, mungesën e eksperiencave të mëparshme për incentivimin dhe mbështetjen e investimeve në këtë fushë si dhe duke bërë një krahasim me çmimet e rajonit për këto burime, për të mundësuar nxitjen e investimeve në këto teknologji, ERE me Vendimin Nr. 120, datë 27.07.2017 miratoi për vitin 2017 çmimin 100 Euro/MWh për burimet e energjisë nga dielli dhe 76 Euro/MWh për burimet e energjisë nga era për të gjithë kontraktuesit e ndërtimit të impjanteve.

3.4.7 Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2018.

Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi” të miratuar me VKM Nr. 687, datë 22.11.2017, ERE përcaktoi çmimin përkatës menjëherë pas publikimit të raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) për vitin 2017. Sipas këtij raporti rezultoi se çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin në bandë (baseload) për vitin 2017 ishte 50.35 Euro/MWh.

Kursi mesatar vjetor i këmbimit Euro/Lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për çdo muaj të vitit 2017 rezultoi 134.15 Lekë/EUR .

Nisur nga elementët e përcaktuar më sipër dhe në zbatim të formulës përlllogaritëse të pikës 3 të VKM Nr.687, datë 22.11.2017 në lidhje me metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi rezultoi çmimi 8.7808 lekë/kWh.

Çmimi i llogaritur rezultoi më i lartë se kufiri maksimal që sipas VKM-së së sipërpërmendur duhet të jetë jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016 konkretisht: $7.448 \times 1.15 = 8.5652$ Lekë/kWh.

Për rrjedhojë, ERE me Vendimin Nr. 19, Datë 19.01.2018 miratoi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018 prej 8.5652 Lekë/kWh.

3.4.8 Miratimi i tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017

ERE me Vendimin Nr. 82, datë 26.05.2017, vendosi çertifikimin paraprak të Shoqërisë ALBGAZ sh.a si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet përkatëse të Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”. ERE me tej liçensoi ALBGAZ sh.a. për aktivitetin e shpërndarjes dhe transmetimit të gazit natyror respektivisht me vendimet 187 dhe 188 datë 10.11.2017.

ALBGAZ sh.a., aplikoi në ERE për miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror. ALBGAZ sh.a. kërkoi që për periudhën 05.01.2017– 20.02.2017 tarifa e transmetimit të gazit natyror të jetë 12.725 lekë/m³ dhe për periudhën 20.02.2017 – 20.09.2017 tarifa e transmetimit të gazit natyror të jetë 33.33 lekë/m³

Kjo kerkese e ALBGAZ sh.a. u beë në kushtet e mungesës së hartimit dhe miratimit të metodologjisë përkatëse dhe gjithashtu të mungesës së eksperiencës së shoqërisë në lidhje me rregullimin e aktivitetit në përgjithësi dhe veçanërisht të rregullimit të tarifave.

Kërkesa për të ardhura u argumentua nga shoqëria me nevojën për shpenzime për mirëmbajtje për shkak të gjendjes tejet të amortizuar të sistemit, me qëllim kryerjen e një aktiviteti normal si dhe nevojën për investime të konsiderueshme me qëllim krijimin e një rrjeti të kompletuar transmetimi. Shoqëria paraqiti projektin e saj për pesë-fishimin e tubacioneve si rrejdhojë e marrëveshjeve për krijimin e një rrjeti të kompletuar transmetimi duke kryer mirëmbajtje të gazsjellësve që aktualisht janë funksional si dhe të gazsjellësve ku pritjet të transportohet gaz nga konçensionarët.

ERE, mbi bazë të analizës së informacionit të disponuar nëpërmjet korrespondencës dhe komunikimeve me ALBGAS sh.a. në seancat teknike, miratoi me vendimin Nr. 90, datë 07.06.2017 tarifën e transmetimit të gazit natyror prej 25 lekë/m³ për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017. Kjo tarifë është rezultat i të ardhurave të kërkuara të miratuara prej 71.55 milion lekë dhe sasisë prej 2,861 mije Nm³ të gazit për t'u lëvruar në rrjetin e transmetimit.

3.4.9 Lënia në fuqi e tarifës së perkoheshme të transmetimit të gazit natyror deri më 31.12.2017

Bordi i ERE-s me anë të Vendimit Nr. 127, datë 16.08.2017, filloi procedurën për licensimin e Shoqërisë ALBGAS sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror dhe me Vendimi Nr.142, datë 06.09.2017, filloi procedurën mbi miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së përdorimit të rrjetit të transmetimit.

Meqënëse :

- ALBGAS sh.a. nuk është pajisur me licensë për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhe ERE kishte njoftuar Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për fillimin e procedurave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe ndërkohë ishte në pritje të rekomandimeve të tij .
- Metodologjia e llogaritjes së tarifës së transmetimit të gazit natyror ishte akoma një çështje në diskutim midis ERE-s, konsulentëve të BBH dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, dhe me tej pritëshin rekomandimet e ESC e me pas miratimi i kësaj metodologjie.
- ECRB e bën të domosdoshme lënien në fuqi të Vendimit Nr.90, datë 07.06.2017 duke shprehur opinionin e saj me anë të email-it të datës 26.09.2017, se Shoqëria ALBGAS sh.a. duhet ushtrojë aktivitetin e saj konform Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe direktivave të komunitetit të energjisë duke argumentuar se rregullimi I aksesit në rrjet duhet të jetë i garantuar dhe Shoqëria ALBGAS sh.a. duhet të ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.
- Paraqitjen e kërkeses nga Shoqëria ALBGAS sh.a. me shkresën Nr.85, datë 28.08.2017 për shtyrjen e afatit të Vendimit Nr. 90, datë 07.06.2017 të Bordit të ERE-s, me qëllim të vijimit të aktivitetit të Shoqërisë për periudhën në vazhdim,

Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 155 Date 28.09.2017 vendosi per lënien në fuqi deri në 31.12.2017 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017 “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme prej 25 lekë/m³ për transmetimin e gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 05.01.2017–20.09.2017”

3.4.10 Tarifat dhe çmimet e miratuara nder vite

Në grafikun e figurës në vijim është paraqitur ecuria e çmimeve të energjisë elektrike të miratuara nga ERE gjatë periudhës 2008-3M 2018:




Figure 65 Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008-3M 2018

Grafiku pasqyron ndryshimet e ndodhura në tarifën e miratuara nga ERE për shkak të reflektimit të ndryshimeve që solli Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” në strukturën e tregut shqiptar të energjisë elektrike.

Që nga viti 2015 vazhdon të aplikohet tarifa e shërbimit të shpërndarjes për nivelin e tensionit 35 kV prej 1,5lekë/kWh dhe që prej 01.01.2017 tarifa e shërbimit të shpërndarjes për nivelin e tensionit 20 kV prej 3,9 lekë/kWh. Grafiku i tarifës së shitjes me shumicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. në funksion të shërbimit të furnizimit me shumicë ndërpritet në vitin 2016 për shkak se ky funksion i kaloi furnizuesit të shërbimit universal. KESH, ne zbatim të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i cili imponon liberalizim të segmenteve të prodhimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, dhe të VKM Nr. 244 datë 30.03.2016, ‘Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e

energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, në vitin 2018 do të shesë energji tek furnizuesi i shërbimit universal për mbulimin e kërkesës së klienteve fundore dhe tek operatori i sistemit të shpërndarjes për mbulimin e humbjeve me çmime të parrregulluara nga ERE. Për rrjedhim grafiku i çmimit të prodhimit për KESH sh.a. (i miratuar nga ERE) ndërpritet në vitin 2017.

ERE përcaktoi për vitin 2017 çmimet e blerjes së energjisë elektrike nga impiantet fotovoltaike dhe eolike të cilat reflektohen në grafik nga dy pika me vlerat përkatëse 13,42 lekë/kWh dhe 10,2 lekë/kWh.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve mesatare të realizuara të energjisë elektrike në tërësi si dhe për klientë familjarë dhe jofamiljarë:




Figure 66 Çmimi mesatar i realizuar (Burimi ERE, OSHEE)

Çmimi mesatar prej 11,12 lekë/kWh për klientët fundorë rezultoi në rënie për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 për shkak të:

- Realizimit të një strukture të shitjes ndryshe nga ajo e vitit 2016
- Efektit të Vendimit Nr.53 datë 06.04.2017 “Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi universal për kategorinë objekte kulti/bashkësi fetare”.

Tabela në vijim paraqet realizimin e çmimeve për kategori të ndryshme të klientëve në nivelet përkatëse të tensionit krahasuar me miratimin:

Kategoria e Klienteve	Çmimi i miratuar (lekë/kWh)		Çmimi i realizuar (lekë/kWh)	
	Aktive	Në Pik	Aktive	Në Pik
Klientë ne 35kV	9.50	10.93	9.49	10.93
Klientë në 20/10/6 kV	11.00	12.65	11.00	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli në 20/10/6 kV	7.10	8.17	7.52	8.74
Klientë në 20/10/6 kV matur ne TU kabinë me nje abonent	12.40	14.30	12.40	14.26
Klientë në 20/10/6 kV matur ne TU (Kabinë me shume abonentë)	14.00	16.10	13.90	16.10
Klientë në 0.4 kV	14.00	16.10	9.50	
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.60	8.74	7.58	8.74
Objekte fetare	9.50	10.93	9.48	10.93
Familjarë	9.50		9.50	
Ambjente te Perbashketa	9.50		9.50	
Çmimi mesatar 2017	10.70		11.12	

Figure 67 Çmimi i realizuar per kategorite e klienteve (Burimi ERE, OSHEE)

Çmim mesatar prej 11.12 lekë/kWh për vitin 2017 i cili rezultoi nga një strukturë faktike e shitjes së energjisë elektrike e ndryshme nga ajo e miratuar ka nje efekt prej rreth 2 miliard lekë të ardhura më tepër për OSHEE sh.a..

Kjo vlerë e cila rezulton si rritje e të ardhurave të kërkuara nga aktiviteti i FSHU gjatë vitit 2017 krahasuar me të ardhurat e lejuara, do të konsiderohet në analizën për të ardhurat e kerkuara të kesaj shoqërie përgjatë procesit të rishikimit te tarifave i cili ka filluar procedurat me Vendimin e Bordit te ERE-s Nr. 211 datë 28.12.2017.

Çmimi faktik prej 7.52 lekë/kwh për kategorinë “Furra buke e prodhim mielli më i lartë se ai i miratuar 7.10 lekë/kWh rezultoi për shkak të aplikimit nga ana e OSHEE sh.a. të tarifës 7.6 lekë/kWh për ata klientë të kësaj kategorie që lidhjen e kanë në tension te mesëm ndërsa matjen e kanë në tension të ulët.

3.4.11 Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, për vitin 2017

Baza e të dhënave e Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) për tarifat e energjisë është burimi kryesor i të dhënave zyrtare të energjisë elektrike në vendet e Evropës Qendrore / Lindore.

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur tarifat e energjisë elektrike në Euro cent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për konsumatorët jo familjarë. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët jo familjare për vendet e rajonit është 11.65 lekë/kWh.




Figure 68 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo-familjar në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit ERA për vitin 2017

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur tarifat e energjisë elektrike në Euro cent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për konsumatorët familjarë. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë për vendet e rajonit është 11.20 lekë/kWh.




Figure 69 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjar në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit ERA për vitin 2017

3.5 Puna e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit gjatë Vitit 2017.

Gjatë vitit 2017 Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ka dhënë kontributin e saj në drejtim të perpilimit të drafteve të një sërë aktesh nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike” dhe Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” si dhe ato në lidhje me përcaktimin e sjelljes së të licencuarve në raport me sa parashikuar në ligj; dhënien e asistencës gjatë përpunimit të praktikave për pajisjen me licencë të subjekteve të ndryshme që operojnë në sektorin e energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror; trajtimit të ankesave apo kërkesave për interpretime mbi dispozitat e legjislacionit në fuqi; shqyrtimit të ankesave apo kërkesave të paraqitura nga të licencuar apo palë të interesit, në lidhje me vendimmarrje të ERE apo në lidhje me kompetencën e ERE për të ndërhyrë, e janë përgatitur përgjigjet në varësi të zgjidhjeve të mundëshme konform ligjit duke respektuar afatet kohore të përcaktuara në të; botimit rregullisht në fletore zyrtare të gjitha vendimeve të Bordit të ERE-s, konform kërkesave dhe detyrimeve të përcaktuara në ligj;

Një vend të veçantë në veprimtarinë e ERE-s në funksion të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, konsiston dhe në autoritetin dhe përgjegjësinë e saj në drejtim të zbatimit të masave më efektive për garantimin e mbrojtjes së klienteve të energjisë elektrike, për të pasur tarifa që reflektojnë kostot e drejta dhe të argumentuara, për një shërbim furnizimi me energji elektrike të pandërprerë dhe brenda standardeve të cilësisë së furnizimit.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet klientëve të energjisë elektrike dhe të licencuarve, është tashmë një ndër prioritet kryesorë të ERE-s, që cila buron nga neni 24 i Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe neni 98 i Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Një vend të rëndësishëm në veprimtarinë e ERE-s në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, gjatë vitit 2017, krahas hartimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike; Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ka zënë edhe monitorimi i zbatimit nga Furnizuesi i Shërbimit Universal të akteve nënligjore të cilat mbrojnë të drejtat e konsumatorit.

3.5.1 Aktiviteti i ERE-s në zhvillimin e legjislacionit sekondar dhe ndryshimet e tjera ligjore të ndodhura gjatë vitit 2017

Një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së ERE-s është edhe hartimi i legjislacionit sekondar që përbën edhe kuadrin rregullator në Sektorin e Energjisë Elektrike. Ky kuadër është plotësuar nga ERE në një pjesë të konsiderueshme dhe aktualisht janë ende në proces përpunimi nga ERE i disa akteve me rëndësi në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Hartimi dhe rishikimi i akteve nënligjore nga ana e ERE-s, është bërë në çdo rast duke konsultuar gjerësisht palët e treta që kanë patur interes të drejtëpërdrejtë mbi këto vendimmarrje. Vlen të përmendim faktin që në çdo rast fillimi i procedurës për shqyrtimin e një akti nënligjor nga ana e ERE është njoftuar në median e shkruar për ti dhënë mundësi njohjeje publikut me të, por edhe duke përcjellë komente apo sugjerime mbi përmbajtjen. Zhvillimi i seancave dëgjimore me prezencën e palëve që kanë shfaqur interes për dokumentat në proces përpunimi nga ERE, të cilat në çdo rast janë bërë publike për palët përmes publikimit të tyre në faqen elektronike të ERE-s, është një fazë e procesit të miratimit të akteve që është respektuar me seriozitet e në shumë raste janë organizuar disa seanca dëgjimore me qëllim ballafaqimin e propozimeve të ndryshme mbi këto akte nga palët e interesuara. Po ashtu edhe finalizimi i procesit të miratimit të një akti, garanton transparencën e vendimmarrjeve të ERE-s përmes mbledhjeve vendimmarrëse të cilat janë të hapura për publikun. Në çdo rast aktet e miratuara nga ERE janë konsultuar me Autoritetin e Konkurrencës, Ministrinë përgjegjëse për energjinë, si dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë. Në miratimin e këtyre akteve është mbajtur në konsideratë opinioni i palëve si më sipër, si një garanci më shumë në plotësimin dhe mbrojtjen shumëplanëshe të interesave të aktorëve të tregut të energjisë elektrike, por mbi të gjitha interesave të konsumatorëve.

3.5.2 Legjislacioni sekondar i miratuar përgjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017, Bordi i ERE ka kaluar 214 vendimmarrje ndër të cilat shumë kanë të bëjnë me ndjekjen e procedurave të parashikura në ligj me qëllim miratimin e akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike apo gazit natyror, në kuadër të përshtatjes së tyre me Ligjin e ri nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” apo atë nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Ndër këto vendimmarrje përmendim miratimin e një sërë aktesh të rëndësishme në funksion të operimit të saktë dhe eficient të sektorit të energjisë:

- ***Mbi miratimin e “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”;***

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë përmbajtjen dhe afatin e dorëzimit në kohë në ERE, të planit të investimeve të OST dhe OSSH, si dhe vlerësimin dhe analizën e kritereve të aplikueshme dhe miratimin e tyre (ose rishikimin) nga ERE, për të siguruar që planet e investimit të jenë në përputhje me parimet e planifikimit me kosto më të ulët, rregullat dhe kërkesat e zbatueshme për sigurinë e operimit të rrjetit, cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e furnizimit si dhe kërkesat e ENTSO-E lidhur me planifikimin e zhvillimit të rrjetit.

- ***Për miratimin e “Rregullores mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit, kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”;***

Kjo rregullore përcakton procedurën e paraqitjes së kërkesës, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të kërkuarit për rastet kur ai dyshon në saktësinë e matësit të energjisë elektrike në mënyrë që të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë klientëve, në respekt të të drejtave dhe detyrimeve të tyre në lidhje me saktësinë e matjes së energjisë elektrike të konsumuar prej tyre. Kjo rregullore synon të mbrojë Klientët përmes promovimit të qasjes transparente ndaj kërkesave që kanë të bëjnë me saktësinë e matjes së energjisë elektrike të regjistruar nga matësi elektrik i instaluar te klienti si dhe të sigurojë përmbushjen e kriterëve të matjes së energjisë elektrike në mënyrë transparente.

- ***“Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të ankandëve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Europën Jug – Lindore (SEE CAO)”;***

Operatorët e Sistemit të Transmetimit të SEE dhe Zyra e Koordinuar e Ankandit në Evropën Juglindore (SEE CAO) përgatitën një grup të ri rregullash për të zbatuar Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit (referuar si HAR) në rajonin e Evropës Juglindore për procesin e ankandit për vitin 2018. Ndërkohë për vitin 2017 Ankandet eksplicite të koordinuara Vjetore, Mujore dhe Ditore janë kryer sipas Rregullave të Ankandit të SEE CAO v.1.4, të miratuara nga të gjitha Autoritetet Rregullatore Kombëtare në vitin 2016.

- ***Mbi miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”;***

Kjo metodologji është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, Rregullave përkohshme të Tregut të Energjisë Elektrike, Kodit të Matjes, Kodit të Transmetimit si dhe akte të tjera nënligjore të miratuara nga ERE. Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i parimeve, kushteve dhe procedurave të tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit mbi bazën e parimeve të llogaritjes së këtyre tarifave, duke vlerësuar të dhënat e domosdoshme për një tarifë të drejtë.

- ***Mbi miratimin e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”;***

Kjo rregullore specifikon treguesit dhe kërkesat e operimit dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, si dhe performancën në lidhje me sigurinë e rrjetit për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), sipas kërkesave të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. OSSH ka Detyrimin e Shërbimit Publik që të përmbushë kriteret standarde të cilësisë së furnizimit, të specifikuar nga Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes, ndërkohë që “Detyrimi i shërbimit publik” është detyrimi që vendoset ndaj një të licencuari për kryerjen e një shërbimi publik, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike, efikasitetin e energjisë elektrike, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk çënon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.

- ***Mbi miratimin e Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike***;

Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i parimeve, kushteve dhe procedurave të tarifave të përdorimit të rrjetit të shpërndarjes mbi bazën e parimeve të llogaritjes së këtyre tarifave duke vlerësuar të dhënat e domosdoshme për një tarifë të drejtë.

- ***Mbi miratimin e “Kodit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”***;

Kodi i Transmetimit trajton procesin e Planifikimit të Rrjetit të Transmetimit, të Lidhjes së përdoruesve në rrjetin e Transmetimit, të Planifikimit Operacional dhe Skedulimit të përdoruesve/pjesëmarrësve të Tregut të Energjisë Elektrike, të Operimit dhe Dispeçerimit të Përdoruesve të rrjetit të Transmetimit, Operimit të Tregut të Energjisë Elektrike dhe balancimit të Sistemit Elektroenergjitik, si në kushte normale ashtu dhe në kushte jo-normale. Objektivi i përgjithshëm i këtij Kodi është që të garantojë që kapitujt e këtij Kodi Rrjeti të funksionojnë së bashku dhe në koherencë të plotë me Kodin e Matjes, Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, Modelin dhe Rregullat e Tregut, me dispozitat e Kodeve të Rrjetit Evropian dhe Manualin Operacional të ENTSO-E.

- ***Mbi miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal***;

Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i parimeve, rregullave dhe procedurave për vendosjen e çmimeve me pakicë të energjisë elektrike, për klientët fundorë të cilët furnizohen nga FSHU. Kjo metodologji ka si objekt përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për kategoritë e klientëve që furnizohen nga FSHU në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" si dhe VKM nr. 449, datë 15.06.2016. Këto klientë janë: Klientët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes 20 kV, 10 kV, 6 kV; 0.4 kV deri në momentin që ERE të vendosë që këta klientë, përfitues të shërbimit universal të mund ta blejnë energjinë elektrike në treg me çmime të parregulluara.

- ***Mbi miratimin e “Rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për t licencuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike”***;

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat për llogaritjen e pagesave rregullatore/të rregullimit për të gjithë të licencuarit në tregun e energjisë elektrike si një nga burimet kryesore të financimit të ERE-s, me qëllim mbulimin e kostove të aktivitetit të rregullimit. Kjo rregullore është hartuar për llogaritjen e pagesave rregullatore me qëllim që të përcaktojë pagesa rregullimi të veçanta për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, tregimit dhe operimit të tregut të energjisë elektrike.

- ***Mbi miratimin e “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”***;

Rregullat e Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike (Rregullat për Mekanizmin Balancues) rregullojnë tregun balancues, përfshirë përgjegjësinë për balancim të

pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, të drejtat dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimeve balancuese, mekanizmin për përcaktimin e çmimit për shërbimet balancuese të shfrytëzuara nga Operatori i Sistemit Transmetues, mekanizmin për përcaktimin e çmimeve të disbalancave, kompensimin financiar të disbalancave të palëve përgjegjëse për balancim dhe çështje të tjera që lidhen me operimin e tregut sipas kërkesave që dalin nga Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” në fuqi dhe korniza ligjore e Komunitetit të Energjisë. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të sigurojë një mekanizëm balancues efikas dhe jo-diskriminues, i cili do të nxisë pjesëmarrësit e tregut që janë palë përgjegjëse për balancim për të mbajtur balancën e sistemit si dhe për të ofruar shërbime balancuese.

- ***Mbi miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”;***

Qëllimi i kësaj metodologjie, është përcaktimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e çmimeve të drejta dhe transparente. Objekti i saj është llogaritja e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit për konsumatorët fundorë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 86 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Kjo metodologji do të zbatohet për të licencuarin e ngarkuar për shërbimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e energjisë elektrike, i caktuar në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 87 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

- ***Mbi Miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike”;***

Me vendimin nr. 214, datë 28.12.2017, Bordi i ERE ka miratuar Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike. Implementimi i këtyre rregullave do të jetë i mundshëm me zbatueshmërinë e Modelit të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë, siç parashikuar në pikën 8, të VKM-së nr. 519, datë 13.07.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”. Në bazë të këtyre rregullave, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të licencohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe do të jetë e autorizuar për të organizuar dhe operuar Tregun e një Dite më Parë për Energjinë Elektrike në Republikën e Shqipërisë.

- ***Kushtet e përgjithshme të Kontratës së Shërbimit të Furnizimit për Klientët Fundorë.***

Kushtet e përgjithshme të Kontratës së Shërbimit të Furnizimit për Klientët Fundorë, janë miratuar në mbështetje të autoritetit që i buron nga neni 79 dhe neni 94, pika 1 e Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Qëllimi i këtyre Rregullave është të sigurojnë një proces të drejtë dhe efektiv të shërbimit të furnizimit të klientëve të energjisë elektrike, përmes vendosjes së kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike, të ofruar nga

të Licencuarit në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, për klientët fundorë. Kjo rregullore normon marrëdhënien mes furnizuesve dhe klientëve fundorë duke paracaktuar të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe rolin e ERE-s në monitorimin e kësaj marrëdhënie.

- ***Rregullorja “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.***

Rregullorja në fjalë kërkon të krijojë kushtet e një shërbimi të garantuar për furnizim të pandërprerë me energji elektrike, të klienteve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Kjo rregullore synon të përcaktojë treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike të klienteve të energjise elektrike, përmes rregullave për vazhdueshmerinë e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet evidentimit të ndërprerjeve të energjisë elektrike, në sistemin e shpërndarjes si dhe klasifikimin e ndërprerjeve. Ky akt nënligjor në frymën e hartimit të tij ka mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, nëpërmjet përcaktimit të parametrave të cilësisë së furnizimit dhe detyrimeve të ndërsjellta të furnizuesve dhe klientëve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes, për të ruajtur një marrëdhënie transparente në tregun e energjisë elektrike.

- ***“Rregullorja për parametrat e cilësisë së furnizimit dhe performanës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjise elektrike”.***

Rregullat dhe parametrat e cilësisë së furnizimit me energji elektrike nga rrjeti i sistemit të transmetimit përcaktojnë kërkesat për cilësinë e furnizimit me energji elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit të sistemit të transmetimit, pjesëmarrësit që operojnë në tregun e energjisë dhe shërbimeve ndihmëse, duke përcaktuar kushtet për përdorimin transparent dhe pa-diskriminim të rrjetit, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

- ***“Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.***

Kjo kontrate rregullon marrëdhënien në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë dhe ka për qëllim garantimin e standardeve bashkohore për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve fundorë, si një detyrim i cili buron nga Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- ***Rregullorja “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”***

Ndër risitë e Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ishte dhe përcaktimi me dispozita të veçanta i “Klientëve në Nevojë” si dhe detyrimin e furnizuesit të Shërbimit Universal të Furnizimit për të furnizuar klientët në nevojë.

Rregullorja “Për përcaktimin e kushteve për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”, konsiston në mbrojtjen e konsumatorit përmes një tregu, ku synohet nxitja e

konkurrencës dhe ulja e pengesave për hyrjen e furnizuesve të rinjë dhe palët e tjera të treta. Kjo rregullore përcakton një mbrojtje të veçantë për “klientët në nevojë”, si dhe vendos kritere në lidhje me ndërperjen e shërbimit të furnizimit për këtë kategori konsumatorësh.

Statusi i “klientit në nevojë”, përcaktohet nga Ministria Përgjegjëse për Çështjet Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë Përgjegjëse për Energjinë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në konsultim me ERE-n dhe grupet e interesit. Në vijim të këtij bashkëpunimi hartohen kriteret, procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Aktualisht ERE është në pritje të komenteve nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe MIE.

- ***Rregullorja mbi Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Gaz Natyror për Klientët Fundorë***.

Këto rregulla kanë për qëllim të sigurojnë një proces të drejtë dhe efektiv të shërbimit të furnizimit të klienteve të gazit natyror, përmes vendosjes së kushteve të përgjithshme, në shërbimin e furnizimit të ofruar nga të Licencuarit në Aktivitetin e Furnizimit në Sektorin e Gazit Natyror.

Aktualisht kjo Rregullore është në proces miratimi.

- ***Rregullorja për “Metodologjinë e llogaritjes së rimbursimit të Dëmit Ekonomik nga Operatori i Sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”***.

Kjo metodologji hartohet në kushtet kur, si rezultat i ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes, Operatorit të Sistemit, i shkaktohen humbje në sistemin e shpërndarjes dhe furnizuesi nuk mund të realizojë matjen e saktë të konsumit të energjisë elektrike në sistemin matës, gjë që mund të sjellë si pasojë moslëshimin e faturës së saktë të energjisë elektrike. Qëllimi i kësaj metodologjie konsiston në rregullimin e marrëdhënieve midis Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, Furnizuesit dhe Klientëve/Individëve/Subjekteve, të cilët ndërhyjnë në mënyrë të paautorizuar në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, lidhur me rimbursimin e humbjeve ndaj operatorit të sistemit si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes, nga ana e personave të paautorizuar.

Aktualisht ERE është në përfundim të procesit për miratimin e kësaj metodologjie.

3.5.3 Kontrata/Marrëveshje tip të miratuara përgjatë 2017

Në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", për shkak të detyrimit me të cilin e ngarkon ky ligj ERE-n në cilësinë e rregullatorit të sektorit, janë miratuar një sërë kontratash apo marrëveshjesh TIP të cilat gjenerojnë detyrime për palët nënshkruese brenda kornizave të parashikimeve të ligjit. Më poshtë listojmë kontratat TIP apo marrëveshjet e miratuara nga ERE si detyrim i parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".

- Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe Furnizuesit të energjisë elektrike;
- Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe Furnizuesit të energjisë elektrike;
- Mbi miratimin e Kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2017-31.12.2017;
- Miratimi i Kontratës për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2017;
- Miratimi i Draft-Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Tregun e Energjisë Elektrike;
- Miratimi i kontratës së shërbimit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a.

3.5.4 Vendimmarrje të tjera të ERE-s përgjatë vitit 2017

Të tjera vendimmarrje të rëndësishme të Bordit të ERE përgjatë vitit 2017 kanë qenë ato të lidhura me procesin e ndarjes së Operatorit të sistemit të transmetimit, certifikimit të OST, apo miratimit të operatorit të kombinuar të gazit Albgaz sh.a. Si më poshtë listojmë disa nga këto vendimmarrje të rëndësishme, puna për miratimin e të cilave është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë si dhe konsulencën aktive të USAID:

- Mbi miratimin përfundimtar të Certifikimit të OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6 të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe nenit 9, pika 6 të Direktivës 72/2009FC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;
- Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror";
- Miratimin e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë";
- Miratimin paraprak të Certifikimit të Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror Albgaz sh.a.;

- *Mbi licencimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a.”, në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;*
- *Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror”, Albgaz sh.a*
- *Mbi licencimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror”, Albgaz sh.a.*

3.5.5 Vendime për të cilat është kërkuar rishikimi përgjatë vitit 2017

Bordi i ERE-s gjatë vitit 2017, krahas akteve të nxjerra në kuadër të legjislacionit sekondar, ka nxjerrë dhe akte për të ndryshuar apo modifikuar akte të nxjerra më parë. Ka patur disa raste kur operatorët e tregut të energjisë apo palët e interesit i janë drejtuar ERE-s me kërkesën për rishikimin e një akti, me qëllim adresimin më të saktë të problematikave të hasura gjatë implementimit të vetë aktit. Ka patur gjithashtu raste kur vetë ERE ka marrë inisiativën për rishikimin e një akti pas konstatimit të hapësirave për përmirësimin e tij. Përmendim këtu akte si:

- *Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 75, datë 26.5.2017, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 25, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 169, datë 31.10.2016, “Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”;*

Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, e miratuar që në datë 23.06.2016, me vendimin e ERE-s nr. 103, ka qenë objekt shqyrtimi nga ERE pas kërkesave të përsëritura nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për shyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të saj. Kjo për shkak të parashikimeve të reja në sektorin e energjisë elektrike, të cilat diktuan nevojën e organizimit të ankandeve, me qëllim blerjen e energjisë elektrike nëpërmjet platformave elektronike online. Këto të fundit, për shkak të kompleksitetit të krijimit të organizimit dhe të qenit një risi në tregun shqiptar, diktuan nevojën e shtyrjes së herë pas hershme të hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, deri në realizimin e kësaj platforme nga shoqëria OSHEE sh.a. dhe bërjen e saj të zbatueshme. Së fundmi, me vendimin e Bordit të ERE nr. 122, datë 08.08.2017, kjo rregullore u vendos të hynte në fuqi në 30.09.2017.

- *Rrëzimin e kërkesës së Shoqërisë OST sh.a. për rishikimin dhe korrigjimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 52, datë 06.04.2017 “Mbi lënien në fuqi të Vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017”.*

ERE me Vendimin me nr. 52, datë 06.04.2017, vendosi “Lënien në fuqi të Vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017”.

Shoqëria OST sh.a i kërkoi ERE-s rishikimin dhe korrigjimin e Vendimit të Bordit nr. 52, datë 06.04.2017 “Mbi lënien në fuqi të Vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017”, në lidhje me tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2017 si dhe detyrimin të OSHEE sh.a për shlyerjen e detyrimeve korente si dhe detyrimeve të prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a. OST sh.a. paraqiti pretendimin që lidhej me mospërfshirjen në Vendimin nr. 52, datë 06.04.2017 të Bordit të ERE-s, të shlyerjes nga ana e OSHEE sh.a të detyrimeve të prapambetura ndaj OST sh.a me qëllim shlyerjen e kredive nga OST sh.a., ashtu siç parashikuar në Vendimin e Bordit të ERE me nr.111, datë 01.07.2016 “Mbi Lënien në Fuqi të Vendimeve nr .139, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE për Periudhën 1 Korrik 2016 - 31 Dhjetor 2016”, si dhe Vendimin e Bordit të ERE nr. 190, datë 22.12.2016 “Mbi Lënien në Fuqi të Vendimeve nr. 139, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE, Vendimit Nr. 13, datë 16.02.2016, Vendimit nr. 128, datë 29.07.2016 të Bordit të ERE deri në 31.03.2017”.

ERE konstatoi se, pavarësisht problemeve të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura ndaj shoqërisë OST sh.a., tarifa e transmetimit të energjisë elektrike, llogaritet mbi bazë të të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë dhe jo mbi bazën e fluksit të mjeteve monetare. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin e politikave të sektorit, me të cilin ERE bashkëpunon në zbatim të përcaktimeve të nenit 10, pika 2 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, vlerësoi mbajtjen e të njëjtit regjim tarifor për vitin 2017 për të tre kompanitë, duke u shprehur ndër të tjera se, kjo vendimmartje ka jo vetëm rëndësi strategjike për sektorin, por edhe do të garantonte zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërive deri në përmbyllje të proceseve të nisura në kuadër të reformave sektoriale. Vendimi i ERE nr. 52, datë 06.04.2017, në pikën 1 të tij ka përcaktuar, shtyrjen deri në 31.12.2017 të fuqisë juridike të vendimit Nr. 190, datë 22.12.2016. Në pikën 4, të Vendimit Nr. 190, datë 22.12.2016, përcaktohet se, OSHEE sh.a, përveç shlyerjes së detyrimeve korente, duhet të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a dhe OST sh.a nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a dhe KESH sh.a. Sa më sipër i dha zgjidhje edhe shqetësimit të ngritur nga OST për mosadresim në Vendimin nr. 52, datë 06.04.2017, të Bordit të ERE, të çështjes së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura dhe atyre korrente.

- ***Mbi kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014, për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015;***

Në ERE është drejtuar kërkesa e Telecom Albania sh.a., Vodafone Albania sh.a., Plus Communication sh.a dhe Albtelecom sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 148, datë 26.12.2014 të ERE, ku të shtohet një kategori e veçantë në këtë vendim për operatorët e shërbimeve publike të

komunikimeve elektronike dhe të zbatohen tarifa për këta sipërmarrës me nivele më të ulëta se tarifat që aplikohen aktualisht dhe në çdo rast jo më shumë se 9.5 lekë/KWh.

Ndërkohë neni 16, pika 5 e Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” parashikon që: “Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara”. Pasi u konstatua se kërkesa për rishikimin e vendimit të ERE nr. 148, datë 26.12.2014 është përcjellë jashtë afateve të parashikuara në ligj e si e tillë është parashkruar, Bordi i ERE është shprehur për rrëzimin e saj.

3.6 Proceset gjyqësore në të cilat ERE ka qenë palë gjatë vitit 2017

3.6.1 ERE në cilësinë e palës së paditur

ERE ka qenë palë e paditur në disa procese gjyqësore të iniciuara në vitet 2011-2012 nga shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. në lidhje me vendimmarrje të saj të cilat datojnë në vitet 2010-2011, e për rrjedhojë vetë objekti i kërimit i pretenduar nga pala zëvendësuese paditëse OSHEE sh.a., ka humbur aktualitetin. Bëhet fjalë për vendimmarrjet e ERE në lidhje me klauzola të Kontratës së furnizimit për klientët familjarë në vitet 2011-2012, apo marrëveshje të subjekteve të licencuara OSHEE – OST, etj, të cilat pikërisht për shkak të vendimmarrjeve të reja, zëvendësuese, të pagoditura gjyqësisht më tej, në vitet në vijim, kanë humbur aktualitetin. Shpallja nul e këtyre vendimmarrjeve nuk prodhon asnjë efekt mbi palët, pikërisht për shkaqet e sipërcituara. Këto gjykime, kanë përfunduar me vendim të formës së prerë në gjykatën e apelit, pas rrëzimit të padive nga gjykata kompetente. Këto çështje aktualisht janë çuar në gjykatën e Lartë nga shoqëria OSHEE sh.a.

- Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për çështjen me palë paditëse Shoqëria “Çez shpërndarje” sh.a, dhe të paditur ERE me objekt: Anullimin dhe pezullimin e aktit administrativ Vendimit të ERE nr. 128, dt.11.09.2012, “Për procedimin administrativ për vendosje gjobe ndaj shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.”. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Apelit ka vendosur rrëzimin e padisë. Aktualisht kjo çështje është rregjistruar pranë Gjykatës së Lartë.
- Proçesi gjyqësor me palë: Shoqëria “OSHEE” sh.a., të paditur ERE, palë e tretë “KESH” sh.a. dhe Avokatura e Shtetit, me objekt: Deklarimin e pavlefshmerise dhe anulimi i pjesshem i vendimit nr. 134, datë 17.09.2012, “Mbi kontraten për furnizimin e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë "KESH" sh.a. dhe Shoqërisë "Cez Shperndarje" sh.a. për periudhën 01.01.2012 deri në 31/12/20142, etj. Kjo çështje është ngritur në gjykatë nga ana e shoqërisë “ÇEZ Shpërndarje” sh.a. dhe më vonë me heqjen e licencës së kësaj shoqërie është bërë zëvendësimi procedural nga shoqëria “OSHEE” sh.a.. Me vendim të

formës së prerë Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur rrëzimin e padisë së OSHEE sh.a.

- Aktualisht rezulton i ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga shoqëria OST sh.a në lidhje me vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ për çështjen me objekt Kundërshtimin dhe anulimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE nr.102, datë 19.07.2012 "Per miratimin e marreveshjes së transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe OSHEE sh.a, me palë paditëse OSHEE sh.a. dhe të Paditur ERE. OST ka qënë palë ë tretë në këtë procedim.

Përveç sa më sipër, janë edhe disa procese gjyqësore në të cilat ERE është në cilësinë e palës së paditur. Bëhet fjalë për vendimmarrje në kompetencë të plotë të ERE për të cilat pas shqyrtimit nga gjykatat kompetente dhe ato të apelit, Gjykatat kanë vendosur rrëzimin e tyre e që aktualisht janë gjithsesi të përcejlla në Gjykatën e Lartë nga palët paditëse.

Listojmë e shpjegojmë si më poshtë:

- Procesi gjyqësor me palë: Paditëse Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme AREA, Paditur ERE; me objekt: Deklarimin e pavlefshmërisë së Vendimit nr. 156, datë 24.12.2015 “Mbi lënien në fuqi të Vendimeve nr. 139, nr. 140, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, si dhe Vendimit nr. 27, datë 16.02.2015”. Kolegji i Gjykatës Administrative ka vendosur me vendim të formës së prerë rrëzimin e padisë. Aktualisht kjo çështje është në pritje për t’u gjykuar nga Gjykata e Lartë
- Procesi gjyqësor për çështjen me palë Paditëse Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme AREA, e paditur ERE, me objekt padie Shfuqizimin e Vendimit të ERE nr. 13, datë 16.02.2016”Mbi tarifën fikse të Energjisë Elektrike që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga Hidrocentralet për vitin 2016”. Kolegji i Gjykatës Administrative me vendim të formës së prerë ka vendosur rrëzimin e padisë. Aktualisht kjo çështje është në pritje për t’u gjykuar nga Gjykata e Lartë.
- Procesi gjyqësor me palë paditëse Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme AREA, të paditur ERE dhe me objekt padie: Deklarimin e pavlefshëm të Vendimit të ERE nr. 143, datë 26.12.2014 “Për rishikimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit në prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013-2014”, Deklarimin e pavlefshëm të Vendimit të ERE nr. 144, datë 26.12.2014 “Për rishikimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhim e nergjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013-2014”. Kolegji i Gjykatës Administrative, me vendim të formës së prerë ka vendosur rrëzimin e padisë si dhe kërkesës për vendosjen e masës së sigurisë dhe rrëzimin e padisë. Në vijim kjo çështje është përcejllë për shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë dhe kjo e fundit vendosi për Ndryshimin e vendimit nr. 24, datë 28.09.2015 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë. Pranimin e padisë të palës paditëse Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA) dhe palës paditëse shoqëria “C&S

Construction Energy” sh.p.k duke shfuqizuar vendimin nr. 143, datë 26.12.2014 të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe vendimin nr. 144, datë 26.12.2014 të Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Enti Rregullator i Energjisë, duke e gjetur këtë vendim të gjykatës së Lartë në shkelje të plotë të Kushtetutës, e duke evidentuar ndërhyrjen e gjykatës në kompetencat e organit të pavarur kolegjal e të ngarkuar me ligj me detyrimin e rregullimit të sektorit të energjisë, ka paraqitur këtë çështje për shqyrtim të kushtetueshmërisë pranë Gjykatës Kushtetuese. Avokatura e shtetit pas kërkesës së ERE për përfaqësimin e interesave të entit publik përpara Gjykatës Kushtetuese, brenda afatit ligjor ka paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese kërkesën në datë 11.10.2017. ERE është në pritje të shqyrtimit dhe vendimit të kësaj gjykate në lidhje me këtë kërkesë.

3.6.2 Proceset Gjyqësore në të cilat ERE ka qënë palë e tretë gjatë vitit 2017.

Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ndër të tjera i kushton një vëmendje të veçantë mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike. Në këtë kuadër ERE, ka shqyrtuar administrativisht konform procedurës dhe brenda afateve ligjore, ankesat e paraqitura nga klientët e energjisë elektrike.

Sigurisht kjo nuk i ka penguar këta të fundit, që ti drejtohen organeve gjyqësore për të reklamuar të drejtën e tyre, të pretenduar të cënuar nga kompania e furnizimit “OSHEE” sh.a.

Në këto kushte ata e kanë gjykuar të arsyeshme që ERE të jetë pjesë e procesit gjyqësorë, në cilësinë e personit të tretë, në të gjitha rastet kur ata kanë thirrur si të paditur në gjykatë, kompaninë OSHEE sh.a.

Janë 46 proceset gjyqësore në të cilat ERE është thirrur për të ndihmuar palët ndërgjyqëse dhe gjykatën në zgjidhjen e konflikteve të cilat në të gjitha rastet janë shqyrtuar më herët administrativisht pranë Sektorit për Mbrojtjen e Konsumatorit, në ERE.

Këto procese janë iniciuar përgjatë viteve 2014 – 2015 dhe një pjesë e tyre rreth 18 kanë përfunduar gjykimin në shkallën e parë, dhe janë në proces shqyrtimi në Gjykatën e Apelit, ndërsa për 28 procese të tjera vazhdon procesi gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor - Tiranë.

Kallzime Penale

Gjatë vitit 2017 janë depozituar 2 kallzime penale në drejtim të ERE:

- Kallzimi penal me objekt “Kundërshtim të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik” nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Aktualisht ERE ka depozituar pranë Prokurorisë të dhënat e kërkuara.

- Kallzimi penal me objekt “Veprime të kundraligjshme gjatë ushtrimit të detyrës” nga ana e shtetasit Sokol Riska.

Aktualisht nga ana e Prokurorisë është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

3.7 Zhvillimi i seancave dëgjimore në ERE

Përgjatë vitit 2017 janë zhvilluar disa seanca dëgjimore, teknike ose jo, të organizuara nga ERE në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis operatorëve të licencuar të tregut energjitik apo edhe seanca diskutimesh me palët e interesuara, në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*" dhe Ligjit nr. 102/2015 "*Për Sektorin e Gazit Natyror*".

- 23 seanca dëgjimore me diskutime me palët e interesuara në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*" dhe atij nr. 102/2015 "*Për Sektorin e Gazit Natyror*".

Në çdo rast që palët e interesit kanë kërkuar shpjegime apo kanë patur paqartësi në lidhje me dispozitat e parashikuara në draftet e akteve në shqyrtim për miratim nga ERE apo në çdo rast kur ka patur nevojë për të diskutuar e dakortësuar mes palëve të interesit për parashikimin e këtyre akteve nënligjore, janë organizuar seanca dëgjimore në të cilat palët kanë shqyrtuar e dakortësuar nen për nen çdo dispozitë. Pavarësisht sa më sipër, ka patur raste kur palët e ineteresit, pas dakortësimit e miratimit nga Bordi i ERE të akteve nënligjore, pas implementimit të tyre kanë konstatuar rrethana për të cilat i janë drejtuar ERE me kërkesën për rishikimin e aktit me qëllim përmirësimin dhe intepretimin më të qartë të tyre.

- 12 seanca dëgjimore, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis operatorëve të licencuar të tregut energjitik.

Gjithashtu gjatë trajtimit të ankesave të konsumatorëve, për raste specifike ka qenë e nevojshme të organizoheshin seanca dëgjimore me prezencën e konsumatoreve dhe të OSHEE sh.a, me qëllimin mbledhjen e informacionit apo qartësimit të situatës midis palëve.

3.8 Korrespondencat e trajtuara gjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017 ERE ka trajtuar përveç vendimarrjeve të mësipërme edhe një sërë korrespondencash kryesisht me tematikat: interpretim ligjor, propozime për kuadrin ligjor nga subjektet e Licencuara, kërkesë për vendimarrje nga ERE, kërkesë për opinionin e ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

3.8.1 Komunikime me Pjesëtarët e Tregut.

Komunikimi me pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike është një ndër prioritet e ERE-s, që burojnë nga legjislacioni bazë i sektorit të energjisë elektrike. Në këtë këndvështrim me qëllim ekuilibrimin e interesave të shtetit, të konsumatorëve dhe investitorëve ERE, ka vendosur një bashkëpunim me pjesëtarët e tregut në sektorin e energjisë elektrike për një koordinim sa më të mirë dhe transparent të tregut të energjisë duke zhvilluar konsultime dhe takime me operatorët e tregut të energjisë elektrike, duke përpunuar dhe dhënë në kohë informacionin e kërkuar nga subjektet e interesuara lidhur me çështjet e tregut të energjisë elektrike, legjislacionit dhe zbatimit të detyrimeve që burojnë prej tij.

3.8.2 Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit.

Gjatë vitit 2017, ka vijuar puna intensive për përditesimin e faqes zyrtare të internetit të ERE-s, duke ofruar një pasqyrë sa më të plotë e më të saktë të informacioneve dhe shërbimeve të ofruara. Një nga prioritetet kryesore ka qënë dhe mbetet përditësimi sistematik i faqes së Internetit, duke u ofruar të gjithë të interesuarve një informacion të përditësuar mbi legjislacion primar dhe sekondar në sektorin e energjisë, të gjitha vendimmarrjet e ERE, publikimi i akteve nënligjore të miratura dhe ato për të cilat është filluar procedura e miratimit dhe priten komentet nga palët e treta; etj Gjithashtu në faqen zyrtare vazhdon të sigurohet aksesin dhe plotësimi online i formularit të ankesave nga të gjithë të interesuarit.

3.9 Veprimtaria e ERE-s në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Në funksion të detyrave të saj, ERE ka analizuar të dhënat lidhur me numrin e ankesave të klientëve të paraqitura gjatë vitit 2017 dhe ka evidentuar se ky numër është shumë më i vogël në krahasim me vitin 2016. Për vitin 2016, në ERE janë paraqitur dhe trajtuar 957 ankesa për energjinë elektrike, ndërkohë që gjatë vitit 2017 janë paraqitur dhe trajtuar 564 ankesa. Përveç ankesave të paraqitura, Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit në zbatim të përgjegjësive dhe objektivave të tij ka ofruar asistencë dhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve dhe konsultimeve verbale dhe me e – mail e telefon, për të gjithë klientët e energjisë elektrike. Objekti i ankesave të paraqitura ka konsistuar në shkeljen e kushteve të përgjithshme të Kontratës për “Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë” dhe Kushtet e përgjithshme të Kontratës së Shërbimit të Furnizimit për klientët dhe Jofamiljarë”, në të cilat përcaktohen detyrimet reciproke të palëve.

ERE në referencë të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe akteve nënligjore, si: “Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjare dhe Jofamiljarë”; “Licencës për Veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike”; “Rregullores për Trajtimin e Ankesave të Paraqitura nga Klientët dhe për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve midis të Licencuarve në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror” dhe “Rregullave për Organizimin,

Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, ka trajtuar dhe analizuar ankesat e klientëve të energjisë elektrike duke ia përcjellë shoqërisë “OSHEE“ sh.a, së bashku me udhëzimet përkatëse.

Në tabelën e mëposhtme jepen të detajuara sipas objektit ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2017.

OBJEKTI ⇒	ENERGJI E PAMATUR	FATURIM AFORFE	MBIFATURIM	FATURIM FIKTIV	KONTRATE FIKTIVE	MJKT	VLERE REFERUESE	TE NDRYSHME	TOTALI
MUJAJ									-
JANAR	25	3	22	2	3	2	19	9	85
SHKURT	26	1	25	1	6	6	5	13	83
MARS	19	6	10	8	1	2	5	9	60
PRILL	14	6	11	1	3	0	6	9	50
MAJ	23	2	9	3	2	3	4	11	57
QERSHOR	15	1	7	2	1	3	1	7	37
KORRIK	8	3	8	1	1	2	0	4	27
GUSHT	12	3	3	0	0	2	0	5	25
SHTATOR	6	0	11	0	0	2	1	7	27
TETOR	7	3	11	3	4	0	2	11	41
NENTOR	8	3	11	0	1	3	0	11	37
DHJETOR	16	1	8	0	1	5	0	4	35
	179	32	136	21	23	30	43	100	564
							TOTALI =		564

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017 janë trajtuar nga ERE në total rreth 564 ankesa. Nga të dhënat e administruara konstatohet se ankesat me objekt “energjinë e pamatur” zënë vendin kryesor në trajtimin e ankesave, të ndjekura nga ankesat me objekt “mbifaturimin” dhe “faturimin aforfe”.

Në mënyrë grafike ky informacion jepet në Figurën 70.




Figure 70 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2017

3.9.1 Ankesat për “Energji të pamatur“.

Nga analiza e treguesve statistikorë konstatohet se spektrin më të madh të ankesave e zënë ankesat për faturimin nën emërtimin “energji e pamatur“, në masën 179 ankesa ose 32% e totalit të ankesave. Vihet re se këto ankesa janë të mbartura dhe përfshijnë faturime të energjisë elektrike, të cilat kanë ardhur si pasojë e kontrolleve të ushtruara nga shoqëria “CEZ Shpërndarje“ sh.a, përgjatë periudhës 2011-2013, ku vihet re se në shumicën e rasteve të paraqitura, procesverbalet e mbajtura për konstatimin e ndërhyrjeve të paautorizuara në sistemin e matjes janë kryer jo në prezencën e klientit, në bokse kolektive të matësive të energjisë elektrike si dhe raste ku është lëshuar më shumë se një faturë, brenda 1 viti, që përmban “energji te pamatur“.

Sikurse evidetohet pavarësisht trajtimit të një pjese të konsiderueshme të këtyre faturimeve nga shoqëria “OSHEE“ sha, vijon të ketë ende ankesa të pazgjidhura lidhur me këtë problematikë.

3.9.2 Ankesat për mbifaturimin e energjisë elektrike.

Ankesat me objekt “mbifaturimin“ e energjisë elektrike të rregjistruara në ERE për vitin 2017 janë 136 ankesa, ose rreth 24% e totalit të ankesave. Këto ankesa janë shkaktuar nga problematika të ndryshme si: mosrakordimi i gjendjes së hedhur në sistemin e faturimit me gjendjen reale të matësit, gabime nga ana e faturuesve, vonesa në hedhjen e të dhënave të matësive të rinj në sistem. Për të gjitha këto ankesa, ERE ka kërkuar nga shoqëria “OSHEE” sh.a, verifikimin e praktikave dhe procedurave lidhur me faturimet e kryera së bashku me korrigjimet përkatëse që duhen realizuar në zbatim të afateve të përcaktuara për trajtimin e ankesave.

3.9.3 Ankesat për “faturim aforfe”.

Ankesat për “faturim aforfe” të energjisë elektrike janë paraqitur dhe trajtuar rreth 32 raste ose gati 6% e totalit të ankesave. Problematike vazhdojnë të mbeten ende faturimet aforfe të energjisë elektrike për periudhën 2007 – 2010, lidhur me sasinë e energjisë elektrike të faturuar aforfe të përcaktuara në Vendimet e Bordit të ERE-s si dhe me afatin final të aplikimit të këtij faturimi bazuar në Vendimin e Bordit të ERE-s nr.104, datë 22.12.2009 “Për përcaktimin e kohëzgjatjes për faturimin aforfe për klientët familiarë pa matës të energjisë elektrike”.

3.9.4 Faturimi i energjisë elektrike për “matje jashtë kushteve teknike”.

Gjatë vitit 2017 janë evidentuar një numër relativisht më i vogël i ankesave me objekt “matjet jashtë kushteve teknike”, në krahasim me vitin 2016 ku ishin rreth 64 ankesa ose 7% e totalit, ndërsa gjatë 2017 konstatohen rreth 30 a ankesa ose 5% e totalit. Ky faturim është bërë në rastet e evidentimit të matësive të energjisë elektrike, jashtë klasës së saktësisë në matje ose për shkak të dëmtimit të tyre. Faturimi i tyre është bërë bazuar në proces – verbalet e mbajtur nga ana e shoqërive të autorizuara për verifikimin e saktësisë së matësive të energjisë elektrike ashtu siç përcaktohet në pikën IV.9 të “Kodit të Matjes”. Gjithashtu, problematikë mbetet gjendja lidhur me faturimet për matje “jashtë kushtit teknik” të viteve të mëparshme 2007 – 2013.

3.9.5 Ankesat mbi “kontratat fiktive“ dhe “faturimin fiktiv“.

Ankesa të trajtura nga ERE gjatë vitit 2017, lidhur me kontratat fiktive dhe faturime fiktive, konstatohen në total rreth 44 ankesa. Nga këto 21 ankesa janë për faturim fiktiv ose 4% e totalit të ankesave dhe 23 ankesa për kontrata fiktive ose 4% e totalit, të ankesave që klientët e energjisë elektrike kanë bërë ndaj shoqërisë “OSHEE” sh.a. Këto ankesa lidhen kryesisht me kontrata të furnizimit me energji elektrike të dubluara me kontratat origjinale të klientëve, me kontrata të hapura në mënyrë të njëanshme pa marrëveshje mes palëve, kontrata provizore të hapura gjatë viteve të mëparshme, faturime fiktive për kontrata të cilat janë të shkëputura nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike ose për objekte të cilat nuk ekzistojnë më, apo nuk kanë ekzistuar asnjëherë. Duhet përmendur se problemet kryesore lidhur me kontratat dhe faturimin fiktiv vijnë nga zonat me ndërtime informale, objektet e të cilave kanë qenë ose janë në proces legalizimi nga ana e ALUIZNI-t.

3.9.6 Ankesa “të ndryshme”.

Në grupin e ankesave të klasifikuara “të ndryshme” janë futur ankesat me objekt: refuzimin e të drejtës për lidhje të re në sistemin e shpërndarjes; ankesat për kreditim të pagesave të energjisë elektrike; ndryshim tarifimi; kolaudim matësi etj. Në grupin e ankesave të ndryshme konstatohen rreth 100 ankesa të cilat zënë 18% të totalit të ankesave.

3.9.7 Ankesa për “vlera referuese” .

Kontestimi i vlerave referuese ka qenë një tjetër grup ankesash të cilat ERE i ka trajtuar gjatë vitit 2017 me rreth 43 ankesa ose 7% e totalit. Ky numër është relativisht me i ulët në krahasim me vitin 2016 ku janë trajtuar rreth 60 ankesa.

Kjo problematikë e ankesave mbi “vlerat referuese“, u konstatuan në muajin Gusht 2016 e po vijon.

ERE, përcakton metodologjinë e llogaritjes së vlerave referuese të matjes së energjisë elektrike, në rastet kur konstatohet se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, duke përcaktuar gjithashtu se vlerat referuese që do të përdoren.

Lidhur me zbatimin e këtij vendimi nga ana e kompanisë “OSHEE” sh.a, ERE konstatoi një sërë ankesash të ardhur nga kliente të energjisë elektrike, të cilët ankimonin faturat e vendosura nën zërin “faturim me vlerë referuese”.

ERE ia ka parashtuar këtë problematikë kompanisë “OSHEE” sh.a, ku ka evidentuar ankesat e disa klientë të energjisë elektrike të cilët ishin faturuar për muajin Gusht 2016 e në vijim dhe gjatë vitit 2017, nën zërin “vlerë referuese” dhe ka kërkuar nga OSHEE sha: verifikimin e praktikës dhe procedurës së ndjekur për faturimin e këtyre klientëve të energjisë elektrike dhe anulimin e çdo mbifaturimi të bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

3.9.8 Përgjigje të ardhura nga OSHEE sh.a gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2017 janë trajtuar nga kompania “OSHEE” sha, rreth 492 ankesa të klientëve për të cilat ERE ka kërkuar zgjidhjen e tyre (nga një total prej 564 ankesa)

Sa i takon problematikës së ankesave të trajtuara nga OSHEE sh.a. vërehet se nga 492 përgjigje të ardhura nga OSHEE sh.a gjatë vitit 2017 :

- 173 prej tyre kanë patur si subjekt anulimin e faturave të ankimuara, ose është marrë parasysh rekomandimet e ERE dhe klienti ka rezultuar të ketë të drejtë.
- 219 prej tyre kanë patur si subjekt kthim përgjigje negative lidhur me ankesat e klientëve, pra klienti nuk ka të drejtë.

- 72 prej tyre kanë patur si subjekt përgjigje mungesën e dokumentacionit nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a, për të gjykuar mbi ankesat e paraqitura; Kjo tipologji ankesash po trajtohet nga vetë ERE duke organizuar seanca dëgjimore me praninë e palëve për të mundësuar marrjen e më tepër informacioni apo dokumentacion nga vet abonenti, dhe më tej duke kërkuar vlerësimin e këtij dokumentacioni nga kompania, si dhe mbi bazën e informacionit vlerëson dhe sygjeron mënyrën e zgjidhjes së ankesave.

- 28 prej tyre kanë patur si subjekt përgjigje pasaktësi të numrit të kontratës.

PJESA IV: Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s

Edhe për vitin 2017 përsa i takon fushës së Burimeve Njerëzore është zbatuar me përpikmëri Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar me ligjin nr.86/2012 date 18.09.2012, i ndryshuar me Ligjin nr.44/2014 date 24.04.2014 dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 ”Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar me ligjin nr.85/2012 date 18.09.2012, ligjin nr.45, date 24.04.2014 si dhe ligjin nr.42/2017 date 06.04.2017.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga të 9 zyrtaret (që janë subjekt i këtij detyrimi), sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji. Gjithashtu kemi komunikim të rregullt në zbatim të njoftimeve të derguara nga ILDKPKI.

ERE ushtron përgjegjësitë e saj në zbatim të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, përmes organit vendimmarrës të Bordit të ERE-s, i cili ndihmohet në punën e tij nga një staf teknik, staf mbështetës dhe specialistë të jashtëm. Në zbatim të Vendimit nr. 181, datë 05.05.2008 të Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e strukturës dhe organikës është zbatuar me përpikmëri Ligji Nr. 9584 datë 11.07.2006, ”Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, si dhe Vendimi nr. 187, datë 8.03.2017 ”Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit” si dhe Vendimin nr. 202, datë 15.03.2017 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të këshillit të ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore “ të ndryshuar.

Në vijim të Ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015 ” Për Sektorin e Energjisë” i ndryshuar, për përzgjedhjen, emërimin dhe promovimin në detyrë të personelit është zbatuar ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Per nepunesin civil” si dhe të gjithë aktet nenligjore të dale në funksion të zbatimit me përpikmëri të Ligjit.

4.1 Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s

Në fushën e administrimit dhe financës janë zbatuar me korrektësi aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse për administrimin e financave të ERE-s, përfshirë ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimet Publike”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe Urdherit nr.64 date 22.7.2014 “Per shpalljen e standarteve kombetare te kontabilitetit te permiresuara dhe zbatimin e detyrueshen te tyre”.

Janë zbatuar të gjitha afatet kohore në lidhje me kryerjen e prokurimeve të fondeve publike, në përputhje me ligjin Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në fushën e prokurimeve publike. Janë kryer procedurat e prokurimeve të blerjeve të vogla në kuadër të plotësimit të nevojave të ERE-s për mallra e shërbime (si pjesë e Komisionit të Blerjeve të Vogla) në zbatim të legjislacionit të prokurimeve elektronike për fondet publike.

Gjithashtu, është kryer inventarizimi i pasurisë që ERE ka në administrim. Për sa i takon fondeve monetare, ato sigurohen nga pagesat e rregullimit që ERE ka vendosur për të licënsuarit. Për vitin 2017 të ardhurat e planifikuara nga pagesat e rregullimit janë realizuar 62%.

Bilanci i shpenzimeve të kryera nga ERE, si pjesë e përmbushjes së detyrimit ligjor për të garantuar një punë normale të institucionit, si edhe më parë kanë konsistuar në përmbushjen e nevojave më të domosdoshme që ka pasur ERE gjatë vitit, në zbatim të buxhetit për vitin 2017 të miratuar. Shpenzimet me kryesorë mund të përmendim:

Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat, për të cilat institucioni ynë ka shlyer të gjitha detyrimet dhe nga sistemi elektronik “Detyrimet në kohe reale” nuk rezulton debitor apo me gjoba.

Publikimet për informim të opinionit publik janë realizuar në zbatim të detyrimit Ligjor nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”

Pagesat për shlyerjet e detyrimeve të shërbimeve si ujë, energji elektrike, telefon për të cilat institucioni ynë gjithashtu nuk është debitor, shpenzime për shërbime të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës si dhe amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara etj.

Tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, si dhe taksat vjetore të regjistrimit të automjeteve.

Detyrimet e taksave për Bashkinë e Rrethit të Tiranës rezultojnë zero (0).

Veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s gjatë vitit 2017 është audituar nga një ekspert kontabël i regjistruar dhe i licënsuar për këtë aktivitet bazuar në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”. Në vijim të këtij paragrafi paraqitet raporti përkatës i ekspertit kontabël.

Shtojca 1 Auditimi i Pasqyrave Financiare

Emertimi dhe Forma ligjore:	Enti Rregullator i Energjise
NIPT -i:	KS1717024I
Adresa e Selise:	Bul" Bajram Curri", Rr" Viktor Eftimiu",
Tirane	
Data e krijimit:	15.10.1995

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2 dhe Ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

VITI 2017

Pasqyrat Financiare jane individuale
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek
Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2017-31.12.2017
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 30.03.2018

ENTI RREGULLATOR I ENERJISE PASQYRAT FINANCIARE

2017

Enti Rregullator i Energjise
Pasqyra e Pozicionit financiar

AKTIVE	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivitet monetare	4	17,836,051	8,167,752
Investime		-	-
Të drejta të arkëtueshme		-	-
Nga aktiviteti i shfrytëzimit		38,912,370	72,966,139
Debitore të tjera		-	27,414
Te tjera		-	-
Totali i të drejtave të arkëtueshme	5	38,912,370	72,993,553
Inventarët		-	-
Lende e pare dhe materiale		3,241,963	3,532,221
Parapajime për inventar		-	317,160
Totali i inventarit	6	3,241,963	3,849,381
Shpenzime të shtyra		-	-
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		59,990,384	85,010,686
Aktive financiare		-	-
Aktivitet materiale		-	-
Ndertesat		-	-
Makineri e pajisje		-	-
Mjete transporti		14,504,806	1,478,758
Pajisje zyresh		2,576,556	3,220,694
Te tjera pajisje dhe informatike		6,621,540	8,492,720
Totali i aktiveve materiale	7	23,702,903	13,192,172
Aktivitet biologjike		-	-
Aktive jo materiale:		-	-
Aktive tatimore të shtyra		-	-
Kapitali i nënshkruar i papaguar		-	-
Total Aktive		83,693,286	98,202,858

Enti Rregullator i Energjise

Kryetari

Hartuesi i pasqyrave

Petrit Ahmeti



Aferdita Bushi

1 | Shënime shpjeguese nga faja 6 deri në faqen 16 janë pjesë përberëse e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERJISE PASQYRAT FINANCIARE

2017

Enti Rregullator i Energjise
Pasqyra e Pozicionit financiar

PASIV	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime afatshkurtra:			
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		-	-
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		1,294,951	1,210,093
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>		1,609,353	1,584,893
<i>Te pagueshme te tjera</i>		76,475	196,995
Shuma detyrime afatshkurtra	8	2,980,779	2,991,981
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		7,184,349	-
Provizione		-	-
Total detyrime afatshkurtra		10,165,128	2,991,981
Detyrime afatgjata:			
<i>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</i>		-	-
<i>Të ardhura të shtyra</i>		-	-
<i>Provizione</i>		-	-
<i>Detyrime tatimore të shtyra</i>		-	-
<i>Te pagueshme te tjera</i>		-	-
Total detyrime afatgjata	9	-	-
Total detyrime		10,165,128	2,991,981
Kapitali dhe Rezervat			
<i>Fondet e ERE</i>		95,210,878	95,210,878
<i>Rritje/Renie fondi gjate vitit</i>		(14,498,370)	-
<i>Fitim / Humbja e Vitit</i>		-	-
Total kapitali aksionar	10	80,712,508	95,210,878
Totali I kapitalit dhe I detyrimeve		90,877,635	98,202,857


Kryetari

Petrit Ahmeti




Hartuesi i pasqyrave

Aferdita Bushi



2 | Shenimet shpjeguese nga faqja 6 deri ne faqen 16 jane pjese perberese e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERJISE PASQYRAT FINANCIARE

2017

Enti Rregullator i Energjise

Pasqyra e performances	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	11	109,545,007	116,826,170
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		1,279,341	1,230,064
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		-	1,649,561
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	12	-	-
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme të tjera shpenzime</i>		-	-
Shpenzime të personelit	13	(97,077,944)	(80,051,052)
<i>Paga dhe shpërblime</i>		(88,897,228)	(72,910,652)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		(8,180,716)	(7,140,400)
Zhvlërësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	14	(4,579,269)	(2,507,128)
<i>Shpenzime të tjera shfrytëzimi</i>	15	(30,741,121)	(33,250,509)
Të ardhura të tjera		-	-
<i>Zhvlërësimi i aktiveve dhe investimeve financiare</i>		-	-
Shpenzime financiare	16	(108,734)	(86,044)
<i>Shpenzime per interesa</i>		(108,734)	(86,044)
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>		-	-
<i>Fitime/humbje nga kursat e këmbimit</i>		-	-
<i>Te ardhura te tjera</i>		-	-
<i>Gjoha dhe interesa</i>		-	-
<i>Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet</i>		-	-
Rritja/Renia neto e fondeve	17	(21,682,719)	3,811,061
Enti Rregullator i Energjise			

Kryetari

Petrit Ahmeti



Hartuesi i pasqyrave

Aferdita Bushi

3

Shenimet shpjeguese nga faqja 6 deri ne faqen 16 jane pjese perberese e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERJISE PASQYRAT FINANCIARE

2017

Enti Rregullator i Energjise

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare	(metoda indirekte)	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
<i>Rritja/Rënia neto e fondeve</i>	(14,498,370)	3,811,061
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	4,579,269	2,507,128
<i>Shpenzime të shytyra</i>	-	-
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>	-	-
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	-	-
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>	-	-
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	34,081,183	(57,275,638)
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>	607,419	561,043
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	(11,202)	(909,711)
<i>Rritje/(rënie) në detyrime afatgjata</i>	-	-
<i>Tatim fitimi i paguar</i>	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	24,758,299	(51,306,118)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	(15,090,000)	(8,497,045)
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	-	511,822
<i>Dividentë të arkëtuar</i>	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(15,090,000)	(7,985,223)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Mjete monetare neto nga aktivitetin e financimit		
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare	9,668,299	(59,291,341)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	8,167,752	67,459,093
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	17,836,051	8,167,752

Kryetari

Petril Ahmeti

Hartuesi i pasqyrave

Aferdita Bushi

4

Shenimet shpjeguese nga faqja 6 deri në faqen 16 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria « Enti Rregullator i Energjise » është Ent Publik i pavaruar me NIPT K51717024I, i cili është krijuar në datë 15.10.1995 sipas Ligjit Nr. 7963 Datë 17.07.1995. Objekti i Ligjit rregullon maredhëniet në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe vendos rregullat e këtij tregu. Kryetar i Entit Rregullator të Energjise është z. Petrit Ahmeti.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlërësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlërësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
------------------	------	------

6 | Shënime shpjeguese nga faja 6 deri në faqen 16 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERJISE PASQYRAT FINANCIARE

2017

Euro/LEK	132.95	135.23
USD/LEK	111.10	128.17

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

✓ Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

✓ Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

✓ Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

✓ Vlera e drejtë

7 | Shënime shpjeguese nga faqja 6 deri në faqen 16 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

✓ Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

✓ Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

✓ Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në

pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12 Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci Kontabel, Aktivët

4. Aktivët monetare

Aktivët monetare janë në shumën 17,836,051 leke, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

ENTI RREGULLATOR I ENERGIJE PASQYRAT FINANCIARE

2017

Nr	Likujditete	Viti 2017	Viti 2016
1	Depozita ne banke	17 836 051	8 167 752
2	Para ne arke	0	0
	Totali	17 836 051	8 167 751

Depozitat ne banke ne monedhe te huaj jane te konvertura me kursin e dates 31.12.2017, diferencat nga kursi i kembimit jane te pasqyrura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Te drejta te arketueshme

Paraqitet shuma e te drejtave te arketueshme deri me 31.12.2017, prej 38 912 370 leke, si me poshte:

Nr	Të drejta të arketueshme	Viti 2017	Viti 2016
1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	38 912 370	72 966 139
1	Debitorë të tjerë		27 414
2	Debitorë të tjerë-paguar me shume taksa		
	Shuma	38 912 370	72 993 553

6. Inventarët

Ne kete post paraqitet me 31.12.2017 inventari i materialeve ne shumen 3 241 962 leke, si me poshte:

Nr	Inventarët	Viti 2017	Viti 2016
1	Lëndë e parë dhe materiale	3 241 962	3 532 221
2	Parapagime per inventar		317 160
	Shuma	3 241 962	3 849 381

Gjendja e materialeve eshte vleresuar me koston e blerjes. Gjate vitit 2017 nuk eshte ndryshuar menyra e mbajtjes se inventarit e cila vazhdon te jete me kosto mesatare.

7. Aktive materiale

Aktivët afat gjata materiale jane te paraqitura me koston e blerjes minus amortizimin e vitit. Vlera kontabel e tyre eshte 23 702 902 leke, sipas tabelës se meposhtme :

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Ndertesa	-	-
2	Mjete transporti	14 504 806	1 478 758
3	Pajisje informatike dhe zyre	9 198 096	11 713 414
	Totali	23 702 902	13 192 172

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e

ENTI RREGULLATOR I ENERJISE PASQYRAT FINANCIARE

2017

mbylles se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016.

Bilanci Kontabel, Pasivet**8. Detyrime afatshkurtra**

Detyrimet afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2017 paraqiten ne shumen 2 980 779 leke, si me poshte :

Detyrime afatshkurtra:		Viti 2017	Viti 2016
Nr			
1	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		
2	Të pagueshme ndaj punonjësve		
3	Të pagueshme ndaj sigurimeve	1 294 951	1 210 093
4	Të pagueshme ndaj TAP	1 609 353	1 584 893
7	Të pagueshme për detyrimet tatimore-Tburim		
8	Të tjera të pagueshme	76 475	196 995
	Shuma	2 980 779	2 991 981

9. Te ardhura te shtyra

Paraqitet detyrimi i shoqerise ne shumen 7 184 349 leke ne 31.12.2017:

Te ardhura te shtyra		Viti 2017	Viti 2016
Nr			
1	Mbipagese e detyrimit te pag.reg. KESH	7 184 349	
	Shuma	7 184 349	

10. Kapitali

Kapitali paraqitet si me poshte:

Fondet e ERE		Viti 2017	Viti 2016
Nr			
1	Fonde te mbartura	95 210 878	91 399 817
2	Rritje/Renie fondi gjate vitit	(14 498 370)	3 811 061
		80 712 370	95 210 878

Gjate vitit 2017 kapitalet e veta jane ulur ne shumen pre 14 498 370 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise eshte 80 712 508 leke.

PASH - Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

12 | Shantimet shpjeguese nga faqja 6 deri ne faqen 16 jane pjese perberese e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERJISE PASQYRAT FINANCIARE

2017

11. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Te ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqërisë për vitin 2017 janë 110 824 348 leke.

Pasqyra e performances	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	11	109 545 007	116 826 170
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		1 279 341	1 230 064
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		-	1 649 561
Shuma		110 824 348	119 705 795

12. Lenda e pare dhe Materiale te konsumueshme

Shoqëria nuk ka shpenzime të lëndës së parë dhe materialeve të konsumueshme gjatë vitit 2017

13. Shpenzime te personelit

Shpenzimet për personelin në shumën 97 077 944 leke janë të detajuara si më poshtë:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2017	Viti 2016
1	Paga dhe shpërblime	88 897 228	72 910 652
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	8 180 716	7 140 400
	Shuma	97 077 944	80 051 052

14. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi

Jane llogaritur shpenzimet për amortizimin e asetëve sipas normave ligjore në fuqi në shumën 4 579 269 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Amortizimi i aktiveve	4 579 269	2 507 128
	Shuma	4 579 269	2 507 128

15. Shpenzime te tjera te aktivitetit

Në këtë zë janë në shumën 30 741 121 leke, të përfshira si në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Shpenzime të tjera	3 713 378	3 196 813
2	Sherbime të ndryshme nga të tretet	2 180 025	4 030 493
3	Shpenzim uji energji	409 048	642 737
4	Mirembajtje automjete e taksa lidhur me to	1 146 076	1 126 653
5	Publikime në media	1 519 200	1 177 000
6	Udhetime dieta	20 574 656	21 403 676
7	Poste telefon etj	1 183 738	1 195 758
8	Taksa dhe tarifa vendore	15 000	15 000
9	Te tjera	-	462 379
	Shuma	30 741 121	33 250 509

13 | Shenimet shpjeguese nga faqja 6 deri në faqen 16 janë pjesë perberëse e pasqyrave financiare

16. Shpenzime financiare

Paraqiten shpenzime per vitin 2017 ne shumen 108 733 leke te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Sherbime bankare (komisione)	58,101	50,622
2	Humbje kursi kembimi	52,019	36,544
3	Rezultate nga kursi kembimit	-1,387	-1,122
	Totali	108,733	86,044

Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

17. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Administratori

Petrit AHMETI



Hartuesi i pasqyrave

Aferdita BUSHI

Ludmilla Paluka Licensa 161

Auditues Ligjore

Eneida Rahmani Licensa 158

Raport i Audituesve Ligjore te Pavarur

Per

Auditimin e Pasqyrave Financiare te
Entit Regullator te Energjise
Viti ushtrimor i mbyllur me 31.12.2017

Tirane, me 30 Mars 2018

1

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Kryetarit te Entit Regullator te Energjise,

Z. Petrit AHMETI

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te **Entit Regullator te Energjise**, te cilat perfshijne pasqyren e pozicionit financiar me daten 31 Dhjetor 2017, pasqyren e te ardhurave gjithepfshirese, pasqyren e ndryshimeve ne kapital dhe pasqyren e flukseve te parasë per vitin qe mbyllet me ketë datë, si edhe shënimet per pasqyrat financiare, perfshirë një përmbledhje të politikave kontabël me të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të **Entit Regullator te Energjise** me daten 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin qe mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Auditues Ligjore

Ludmilla Paluka Licensa 161 *Eneida Rahmani Licensa 158*

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Entit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë. Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Auditues Ligjore te Pavarur

Ludmilla Paluka



Rr.H.Hidi, Ndertesa nr 2, Zyra 9,
Tirane
Nr.kontakti 069 20 36 339.

Eneida Rahmani



Rr.Ali Demi Nr.16 Tirane
Nr.kontakti 068 20 51 151

Tirane, me 30 Mars 2018

Raporti i Auditimit eshte i vlefshem vetem per pasqyrat financiare bashkelidhur tij.

3

Shtojca 2 Plani I Veprimeve 2018

Gjatë vitit 2018, ERE do të fokusohet në plotësimin e kuadrit ligjor me legjislacionin sekondar në funksion të Vendimeve të Këshillit të Ministrave në zbatim të ligjit 43/2015 Për Sektorin e Energjisë elektrike” apo ndryshimeve që ligji ka pësuar me ligjin 7/2018 “Për disa ndryshime në ligjin 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Në vijim të zhvillimeve të sektorit të gazit natyror ERE do të vijojë punën me qëllim përafrimin e kuadrit ligjor me legjislacionin europian si dhe lehtësimin e procedurave për ushtrimin e këtij aktiviteti. Një rëndësi të veçantë ERE do t’i kushtojë dhe monitorimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi nga ana e të licencuarve si dhe duke evidentuar nevojën për ndërhyrje në kuadrin rregullator në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së qetë e të lirë të të licencuarve si dhe konsumatorëve të energjisë. ERE do të vijojë të kushtojë një vëmendje të veçantë edhe kujdesit për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve të energjisë elektrike duke trajtuar jo vetëm ankesat e përcjella për kompetencë në ERE, marrë pjesë në proceset gjyqësore në të cilat konsumatorët ushtrojnë të drejtën kushtetuese për ankesë ndaj Operatorit të Shpërndarjes, por edhe duke përshtatur kuadrin ligjor e monitoruar performancën e operatorëve në mënyrë që interesat e konsumatorëve të jenë të mbrojtura më së miri.

Plani i Veprimit i ERE-s në funksionin e licencimit dhe monitorimit gjatë vitit 2018 përveç detyrave të planifikuara, paraqet në terma të përgjithshëm si më poshtë disa prioritete të dala nga analizimi i situatës gjatë vitit 2017.

DISA NDËR TEMATIKAT KRYESORE QË DO VAZHDOJNË TË MBETEN PRIORITARE NË FOKUSIN E MONITORIMIT EDHE GJATË VITIT 2018
OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST)
Sistemi i Transmetimit duhet të realizojë kushtet e transparencës në përputhje me kërkesat e ENTSO-i dhe në zbatim të Rregullores të miratuar nga ERE për këtë qëllim (Vendimi Nr 118 dt 27.07.2017).
Monitorim i zbatimit të kushteve të certifikimit të OST sha
Perfundimi i linjes 400 KV Elbasan - Bitola
Fuqizim i N/Stacionit të Komanit në 400 KV.
Angazhim në përmbushjen e detyrimit ligjor për Bursën Shqiptare të Energjisë në zbatim të VKM Nr. 519 dt. / 2016 dhe akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara .
Konsolidimi i platformave specifike për përmbushjen e kërkesave që rrjedhin nga ndryshimi i operimit të tregut të Energjisë.
Realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes për sigurimin e gadishmërisë së sistemit dhe përbalimin e kapaciteteve në rritje
Studim lidhur me shmangjen e devijimeve jashtë kufinjve të lejuar sipas kërkesave të ENTSO-i në Interkoneksion.
Monitorimin e Sigurimit të shërbimeve ndihmëse dhe ato të ballancimit në përputhje me kuadrin ligjor.
Parashikimin e investimeve të reja në fushën e rritjes së sigurisë dhe performancës së sistemit elektro-energjitik.
Bashkepunimi me sistemin e shpërndarjes për administrimin e të dhënave në kohë reale që i shërbejnë planifikimit sa më të mirë.
Koordinimi i komunikimeve operative me sistemin e shpërndarjes dhe operatorë të tjerë në kuadër të dispeçerimit efikas të sistemit elektro - energjitik.
OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSHEE)

Ndarja përfundimtare financiare e shërbimit të Shpërndarjes me atë të Furnizimit.
Azhornimi i bazës së të dhënave lidhur me klientët faktikë të sistemit të shpërndarjes
Plotesimi me matje që ti shërbejë realizimit të bilancit energjistik dhe faturimit me bazë Fideri/Kabine.
Monitorim i ecurisë së permbushjes së kushteve për daljen në treg të hapur të klientëve të lidhur në rrjetin 20 kV.
Prioritarizimi i investimeve të nevojshme dhe planifikimi i realizimit të tyre.
Sigurimi dhe deklarimi i të dhënave në kohë reale lidhur me furnizimin nga prodhuesit në sistemin e shpërndarjes dhe konsumin e energjisë
Sigurimi në kohe reale i planit të nevojave për energji.
Perfundimi dhe vënia në përdorim e sistemit SCADA.
Përmirësimi i sistemit elektronik të menaxhimit të të dhënave të klientëve.
Reduktimi i Humbjeve.
Përmirësimi i treguesve të performancës së furnizimit dhe çelësish të shërbimit.
KORPORATA ELEKTRO-ENERGJITIKE SHQIPËTARE (KESH)
Monitorim i prodhimit dhe masave të marra për optimizimin e tij.
Monitorimi i Menaxhimit të rezervës hidrike.
Monitorim i procedurave të transaksioneve dhe shit-blerjes së energjisë
Realizimi i shërbimeve periodike dhe ato të mirëmbajtjes së hidrocentraleve.
Monitorime specifike të të licensuarve të tjerë

Për qëllimin e përcaktimit të tarifave dhe çmimeve të rregulluara gjatë vitit 2018 në mënyrë të veçantë puna e ERE-s do të fokusohet në drejtim të:

- Përcaktimit të tarifave të aksesit për përdorimin e rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit, krahas përcaktimit të tarifave për aktivitetet e rregulluara.
- Alokimit të shpenzimeve për aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror për përcaktimin e tarifave të transmetimit dhe shpërndarjes për operatorin e kombinuar ALBGAS sh.a.

Shtojca 3 Regjistri i Vendimeve të ERE-s për Vitin 2017

Nr. 1	Datë 19.01.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe marrëveshjes së pjesëmarrjes në bursën e organizuar të energjisë elektrike”	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 2	Datë 19.01.2017	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 3	Datë 19.01.2017	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 4	Datë 19.01.2017	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores për procedurën e egjistrimit në tregun e energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 5	Datë 19.01.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, date 7.7.2014, “Mbi rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 6	Datë 19.01.2017	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 7	Datë 19.01.2017	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në “Rregullat e përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016, të Bordit të ERE-s.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 8	Datë 19.01.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e udhëzimit mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 9	Datë 19.01.2017	Mbi miratimin e licencës tip për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike	Fletore Zyrtare me Nr. 20 Datë 09.02.2017
Nr. 10	Datë 19.01.2017	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “A-V Compass Power” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrik.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 11	¹ Datë 19.01.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Balcan Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 12	Datë 19.01.2017	Për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tuç”, me fuqi 4470 kW dhe HEC “Lumzi”, me fuqi 11000 kW, me fuqi totale të instaluar 15470 kW	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 13	Datë 19.01.2017	Për licencimin e shoqërisë “MC Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 14	Datë 19.01.2017	Mbi fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k., me numër 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 94, datë 6.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 15	Datë 19.01.2017	Mbi fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k., me numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit nr. 102, datë 7.11.2014, “Për tregtimin e energjisë elektrike”.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 16	Datë 19.01.2017	Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2016 për t licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017

¹ Vendimet e tjera që nuk janë të pasqyruara në këtë Rregjistër, kanë të bëjnë me çështje të rregullimit të brendshëm të ERE.

Nr. 17	Datë 19.01.2017	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.	Fletore Zyrtare me Nr. 17 Datë 06.02.2017
Nr. 18	Datë 31.01.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2017–31.12.2017	Fletore Zyrtare me Nr. 20 Datë 09.02.2017
Nr. 19	Datë 3 31.01.2017	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energji Univer” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kabash”, me fuqi të instaluar 5.8 MW	Fletore Zyrtare me Nr. 20 Datë 09.02.2017
Nr. 20	Datë 31.01.2017	Mbi mosfillimin e procedurës së licencimit të shoqërisë “Energji Univer” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike...	Fletore Zyrtare me Nr. 20 Datë 09.02.2017
Nr. 21	Datë 31.01.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ENPI Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me Nr. 20 Datë 09.02.2017
Nr. 22	Datë 15.02.2017	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal për periudhën kohore 01.01.2017 – 31.12.2017	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 23	Datë 15.02.2017	Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe Furnizuesit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 24	Datë 15.02.2017	Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe Furnizuesit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 25	Datë 15.02.2017	Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ere nr.169 datë 31.10.2016 “mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ere nr. 103 datë 23.06.2016 , “mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik.”	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 26	Datë 15.02.2017	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë.	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 27	Datë 15.02.2017	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e programit të përputhshmërisë rregullatore.	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 28	Datë 15.02.2017	Mbi Modifikimin e licencës së shoqërisë Komp Energji” sh.p.k., me numër. 248, seria pv14k, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve nr.94, datë 06.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”.	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 29	Datë 15.02.2017	Mbi Modifikimin e licencës së shoqërisë “komp energji” sh.p.k., me numër 253, Seria T14p, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr.102, datë 07.11.2014, për tregtimin e energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.42 Datë 7 mars 2017
Nr. 31	Datë 20.02.2017	Mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH sh.a. për periudhën 1 Prill 2017 – 31 Dhjetor 2017.	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017

Nr. 32	Datë 20.02.2017	Mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për periudhën 1 Prill 2017 – 31 Dhjetor 2017.	Fletore Zyrtare me Nr.42 Datë 7 mars 2017
Nr. 33	Datë 27.02.2017	Mbi informacionin periodik për përpunimin e akteve nënligjore.	
Nr. 34	Datë 02.03.2017	Mbi miratimin e udhëzimit mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror	Fletore Zyrtare me Nr.42 Datë 7 mars 2017
Nr. 35	Datë 02.03.2017	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për certifikimin e operatorit të kombinuar të gazit natyror të Albgaz sh.a	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 36	Datë 06.03.2017	Për licensimin e shoqërisë “Enpi Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 37	Datë 06.03.2017	Për licensimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. Datë 7 mars 2017
Nr. 38	Datë 06.03.2017	Mbi licensimin e shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kabash” me fuqi të instaluar 5800 kw	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 39	Datë 06.03.2017	Mbi fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k, në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me Nr.42 Datë 7 mars 2017
Nr. 40	Datë 06.03.2017	Mbi fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k, në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 41	Datë 06.03.2017	Për mos fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “CGC” sh.p.k në aktivitetin e tregimit të gazit natyror (shitje me shumicë)	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr.42	Datë 13.03.2017	Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet ere-s dhe sekretariatit të komunitetit të energjisë	Fletore Zyrtare me Nr. 42 Datë 7 mars 2017
Nr. 43	Datë 15.03.2017	Mbi miratimin përfundimtar të Çertifikimit të OST SHA, në përputhje me nenin 54 , pika 6 të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe neni 9, pika 6 të direktivës 72/2009FC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë	Fletore Zyrtare me Nr. 76 Datë 12.prill .2017
Nr. 44	Datë 27.03.2017	Mbi Miratimin e Raportit Vjetor të ERE-s “Gjëndja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2016”, që do t'i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë.	Fletore Zyrtare me Nr. 132 Datë 15.06. 2017
Nr. 46	Datë 31.03.2017	Për fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “CGC” sh.p.k në aktivitetin e tregimit të gazit natyror (shitje me shumicë)	Fletore Zyrtare me Nr. 87 Datë 24 . prillë 2017
Nr. 47	Datë 31.03.2017	Mbi licensimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k, në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike	Fletore Zyrtar me Nr. 87 Datë 24 prillë 2017

Nr.48	Datë 31.03.2017	Mbi licensimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k, në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. 87 Datë 24 prillë 2017
Nr. 49	Datë 31.03.2017	Mbi fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “ Energji Univers” sh.p.k, në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me Nr. 87 Datë 24 prillë 2017
Nr. 50	Datë 31.03.2017	Mbi fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “ Alb Energy” sh.p.k, në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me Nr. 87 Datë 24 prillë 2017
Nr. 51	Datë 31.03.2017	Mbi licensimin e shoqërisë “Alb Tek Energy ” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me Nr. 99 Datë 8 maj 2017
Nr. 52	Datë 06.04.2017	Mbi lënien në fuqi të vendimit nr.190 , datë 22.12.2016 të Bordit të ERE-s, deri më 31.12.2017.	Fletore Zyrtare me Nr. 87 Datë 24 prillë 2017
Nr. 53	Datë 06.04.2017	Çmimi I SHitjes së Energjisë Elektrike nga Furnizues Universal për Kategorinë e Objekteve Kultit/Bashkësitë Fetare	Fletore Zyrtare me Nr.87 Datë 24 prillë 2017
Nr. 54	Datë 18.04.2017	Mbi fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “ALB ENERGY MARKET” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.99 Datë, 8. maj 2017
Nr. 55	Datë 18.04.2017	Mbi fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “ALB ENERGY MARKET” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. 99 Datë 8 maj 2017
Nr. 56	Datë 18.04.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ Alb Energy“ sh.p.k, për lënien peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania”sh.a.	Fletore Zyrtare me Nr. 99 Datë 8 maj 2017
Nr. 57	Datë 18.04.2017	Mbi miratimin e Kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2017-31.12.2017.	Fletore Zyrtare me Nr. 99 Datë 8 maj 2017
Nr. 58	Datë 18.04.2017	Mbi miratimin e Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror. (Bashkëlidhur)	Fletore Zyrtare me Nr. 99 Datë 8 maj 2017
Nr. 59	Datë 18.04.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me Nr. 99 Datë 8 maj 2017
Nr. 62	Datë 11.05.2017	Miratimi i Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2017 (kontrata bashkëlidhur).	Fletore Zyrtare me Nr. 124 Datë 30 maj 2017
Nr. 63	Datë 11.05.2017	Miratimii i “Draft-Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Tregun e Energjisë Elektrike”.	Fletore Zyrtare me Nr. 124 Datë 30 majo 2017

Nr. 64	Datë 11.05.2017	Fillimi i procedurës për miratimin e disa ndryshimeve në Marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a dhe furnizuesit miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr.23, Datë 15.02.2017.	Fletore Zyrtare me Nr. 124 Datë 30 maje 2017
Nr. 65	Datë 11.05.2017	Licensimi i Shoqërisë "ALB ENERGY" sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.	Fletore Zyrtare me Nr.124 Datë 30 maje 2017
Nr.66	Datë 11.05.2017	Miratimi i kërkesës te shoqërisë " Alb Energy" sh.p.k, për lënien peng të aseteve në favor të Bankës "Societe Generale Albania"sh.a.(lista bashkëlidhur)	Fletore Zyrtare me Nr. 124 Datë 30 maje 2017
Nr. 67	Datë 11.05.2017	Mos fillimi i procedurës për licencimin e shoqërisë "BALKAN GREEN ENERGY" sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.124 Datë 30 maje 2017
Nr. 68	Datë 11.05.2017	Mos fillimi i procedurës për licencimin e shoqërisë "ALBANIAN GREEN ENERGY" sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.124 Datë 30 maje 2017
Nr. 69	Datë 11.05.2017	Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë "Kurum International" sh.a në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, për një afat 5 - vjeçar.	Fletore Zyrtare me Nr.124 Datë 30 maje 2017
Rinovim license. Me përfundimin e afateve të licensave të marra subjektet aplikojne pranë ERES për rinovimin e licenses, gjate 2017 bordi ka marre 2 vendime për fillimin e procedurës për rinovimin e licenses dhe ka marre 2 vendime për rinovim të licensave.

ERE refuzon dhënien e një licence nëse në baze të nenit 41 të ligjit aplikuesi nuk përmbush ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji, është në proces falimentimi ose

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

8

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

likuidimi, aplikuesit i është revokuar ose hequr licenca dhe nuk ka përfunduar periudha, brenda së cilës është i ndaluar riaplikimi për licencë. Gjate 2017 ERE ka marrë 7 vendime për mosfillim të procedurës së licensimit.

ERE heq një licencë në baze të nenit 42 të ligjit kur i licencuari nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë, shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve, nuk kryen pagesat e rregullimit të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji, bëhet financiarisht i paafte ose kërkon shpalljen e falimentimit, me kërkesë të të licencuarit, ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës. Përheqjen e licenses njoftohet me shkrim i licencuari për fillimin e procedurave për heqjen e licencës, në njoftim shprehen qartësisht arsyet për heqjen e licencës. Gjate 2017 ERE ka marrë 2 vendime për heqje license, të dyja të të njejtës shoqeri njera për tregtim të energjisë elektrike dhe tjetra në furnizim të energjisë elektrike (shoqeria A&A Group shpk).

Modifikimi i kushteve të një licence ERE mund të modifikojë licencën në përputhje me nenin 43 të ligjit, me iniciativën e vet, në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, kur ndryshojnë kushtet e kontratës koncesionare ose me kërkesën e të licencuarit. ERE merr në konsideratë ndikimet e pritshme që modifikimet e iniciuara apo të propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i licencuari ka në përputhje me këtë ligj dhe kushtet e licencës së tij. Përpara miratimit të modifikimit të një licence, ERE publikon modifikimet e propozuara dhe shqyrton vërejtjet ose ankesat e mundshme, të paraqitura nga palët e interesuara lidhur me këtë proces (Neni 44 i ligjit). Gjate vitit 2017 bordi i ERES ka marrë 4 vendime për fillim procedure për modifikim të licensave (ne fushën e energjisë 3 dhe të gazit 1) dhe 3 vendime për miratimin e modifikimit të licenses.

Transferimi i licencës ose asetëve. Transferimi i licencës ose asetëve të të licencuarit, që shërbejnë për kryerjen e veprimtarive të licencuara, bëhet me miratimin paraprak të ERE-s, bazuar në rregulloren e miratuar prej saj miratuar me vendimin nr. 119, date 21.07.2016 të bordit “Rregullore për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”. Miratimi i ERE-s nuk është i nevojshëm në rastet e transferimit të asetëve me vlerë minimale, apo asetëve që nuk lidhen ngushtësisht me veprimtarinë e licencuar, sipas rregullores të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni. Gjate këtij ushtrimi janë marrë 10 vendime për lenie peng asetesh nga të cilat 6 fillim procedure, 3 miratim të kërkesave të shoqerive për lenien peng të asetëve në favor të bankave dhe 1 refuzim të kërkesës për transferimin e asetëve.

Në përputhje me kuadrin ligjor të mësipërm janë zbatuar me korrektësi afatet e publikimit në median e shkruar të Vendimeve të Bordit të ERE-s për njohjen e të gjitha palëve të interesuara me këto Vendime. Gjithashtu çdo aplikim për licencim i është nënshtruar një analize të kujdesshme të rregullshmërisë dhe plotësimit me korrektësi të dokumentacionit ligjor, administrativ, financiar, teknik dhe marrjes së lejeve përkatëse të përdorimit të ujrave apo leje mjedisore, të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me aktivitetin që subjektet kanë kërkuar të licensohen.

Për të gjithë subjektet e licensuar nga ERE, mbahen dhe arkivohen regjistra të veçantë për secilin aktivitet, me të dhënat e nevojshme për subjektin dhe llojin e licensës, të cilat pasqyrohen të

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

9

Enti Rregullator i Energjisë**Auditim Performance për vitin 2017**

përditesuara në Web-in e ERE-s dhe mund të konsultohen nga çdo palë e interesuar. Licensat kane një numer rendor progresiv si edhe një seri dhe kod të veçante sipas fushave të licenses.

Licensat e dhëna gjatë 2017 janë:**Subjektet e licencuar, në aktivitetin e prodhimit të energjisë**

SUBJEKTI	IMPIANTI PRODHUES	FUQIA E INSTALUAR
"M.C.Inerte Lumzi" shpk	H/C "Tuç" H/C "Lumzi"	4,47 MW 11 MW
"Energji Univers" shpk	H/C "Kabash"	5,8 MW
"Albtek Energji" shpk	TEC "Përpunimi mbetjeje urban"	2,85 MW
"Skatina - Hec" shpk	H/C "Skatinë"	2,677 MW
"Eurobiznes" shpk	H/C "Lusen 1" H/C "Lusen 2" H/C "Lusen 3"	0,315 MW 0,6 MW 0,6 MW
"The Blue Stars" shpk	H/C "Goricë"	1,767 MW
"Afrimi K" shpk	H/C "Thunza"	2 MW
"Sima - Com" shpk	H/C "Meshurdh"	1,3 MW

- Modifikim Licence Prodhimi shoqërisë Komp Energji shpk, me numër.248, seria pv14k, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.94, datë 06.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec-et "Hurdhas 1", "Hurdhas 2" dhe "Hurdhas 3".

Të licencuarit në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike gjatë 2017

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DATA E VENDIMIT TË BORDIT
1	"M.C.Inerte Lumzi" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 13, datë 19.01.2017
2.	"E N P I" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 36, datë 06.03.2017
3.	"Balkan Energy Trade" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 37, datë 06.03.2017
4.	"Grid Energy" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 47, datë 31.03.2017
5.	"ALB - ENERGY" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 42, datë 12.04.2017
6.	"ENERGJI UNIVERS" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 65, datë 11.05.2017
7.	"ALB ENERGY MARKET" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 70, datë 11.05.2017
8	"PPC Albania" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 93, datë 04.07.2017
9	"Energy Financing Team Tirana" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 119 datë 27.07.2017
10	"ALIN TRADING" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 137, datë 06.09.2017
11	"Albpetrol" sha	Tregëtim	Vendimi Nr. 140, datë 06.09.2017
12	"ENERY TO ENERGY" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 144, datë 06.09.2017
13	"THE BLUE STAR" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 143, datë 06.09.2017
14	"BINDI" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 170, datë 26.10.2017
15	"SMART Trade & Consulting" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 173, datë 26.10.2017
16	"PRIMA ENERGY" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 195, datë 24.11.2017

- Modifikim i licencës së shoqërisë "Komp Energji" shpk, me numër 253, Seria T14p, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr.102, datë 07.11.2014, për tregëtimin e energjisë elektrike.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

10

Enti Rregulator i Energjisë**Auditim Performance për vitin 2017**

- Rinovimi i licencës nr. 176, Seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” shpk, në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
- Shfuqizim i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 38, datë 10.4.2013, për licencimin e shoqërisë “A&A Group” shpk në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (heqje licence).

Subjektet e licensuar në aktivitetin e Furnizimit të energjisë elektrike, gjatë vitit 2017

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DATA E VENDIMIT të BORDIT
1.	“Grid Energy” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 48, datë 31.03.2017
2.	“ALB ENERGY MARKET” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 80, datë 26.05.2017
3.	“Albanian Green Energy ” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 114, datë 27.07.2017
4.	“ALBPETROL” sha	Furnizim	Vendimi Nr. 141, datë 06.09.2017
5	“Energy Financing Team Tirana ” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 174, datë 26.10.2017
6	“Energji Ashta” shpk	Furnizim	Në proces

- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Kurum International” sha në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shfuqizimi vendimit të bordit të ERE-s nr. 134, datë 24.12.2014 (heqje licence), për licencimin e shoqërisë “A&A Group” shpk në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike

Subjektet e licensuar në aktivitetet e Gazit natyror për vitin 2017

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	DATA E VENDIMIT të BORDIT
1	“C.G.C.” shpk	Tregëtim	Vendimi Nr.73, datë 16.05.2017
2.	“Albgaz” sha	Shpërndarje	Vendimi Nr.187, datë 10.11.2017
3	“Albgaz” sha	Transmetim	Vendimi Nr.188, datë 10.11.2017

Monitorimi

Monitorimi kryhet nga dy sektore ai i monitorimit të të licensuarve dhe sektori i monitorimit të tregut.

Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neni 7, neni 20, gërma ç), d), f) dhe g), neni 22, neni 58, pika 9, neni 62, pika 4 si dhe neni 72, gërma dh); Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, neni 13; si dhe kushtet e licensave të lëshuara nga ERE, shërbimet e operatorëve të licensuar nga ERE janë objekt i monitorimit në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdhërave të ERE-s.

Monitorimet janë kryer bazuar në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, këto monitorime janë kryer bazuar në plane tematike paraprake dhe organizuar në mënyrë të tillë që të monitorohen në vazhdimësi rezultatet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

11

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

Sektori i monitorimit të të licensuarve. në mënyrë të përmbledhur po paraqesim detyrat e sektorit dhe punen e bere për ndjekjen e tyre:

- a) Sigurimi i të dhenave të detyrueshme nga të gjithë të licencuarit në sektorin energjistik: Sigurohen cdo dite të dhënat kryesore të sistemit elektroenergjitik (miniskada), sigurohen të dhënat e miratuara periodike mujore nga OST, KESH, OSHEE, sigurohen të dhënat nga prodhimi mujor i H/C-ve privat/koncesion, sigurohen të dhënat për transaksionet e shit-blerjes së energjisë, ndiqet mbledhja e raporteve financiare të vitit 2017.
- b) Përpunimi i të dhenave dhe raportimi periodik i tyre në strukturat drejtuese: është ndertuar baza për përpunimin e të dhenave të sistemit elektro-energjitik, cdo muaj jane përpunuar dhe hedhur të dhënat e operatoreve të sistemit, jane përgatitur dhe shpërndare cdo muaj rezultatet mujore periodike, jane përgatitur në mënyrë tabelare e grafike të dhënat e kerkuara nga strukturat, jane pasqyruar të dhena specifike krahasuese për treguesit me të rendesishem.
- c) Vleresimi lidhur me përmbushjen nga të licensuarit të detyrimeve të parashikuara në kushtet e licences dhe aktet e tjera rregullatore: Rakordohet me sektorin e licensimit për detyrimet e të licensuarve gjate vitit, perditohet regjistri i të licensuarve në bashkëpunim me sek e licensimit, ndiqet zbatimi i kuadrit rregullator për transaksionet e shit-blerjes në bashkëpunim me sektorin e monitorimit të tregut. (KESH dhe OSHEE).
- d) Përgatitja e Planit të monitorimit mujor dhe vjetor dhe dergimi për miratim: Ne baze të praktikës përgatitet Plani i Punes mujor i integruar në planin e punes së Drejtorise së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, Përgatitet Plani Vjetor për monitorimet tematike dhe percaktohet monitorimi vjetor i të dhenave të operatoreve gjate gjithë vitit
- e) Realizimi i Planit të monitorimeve të parashikuara dhe raportimi periodik në strukturat drejtuese: Monitorim dhe përpunim periodik i të dhenave të OST, KESH dhe OSHEE për cdo muaj dhe kryerja e analizave të tyre për të evidentuar rregullshmerine e cështje kritike specifike, analiza specifike krahasuese e humbjeve, prodhimit dhe shit-blerjes, analize e gjendjes debitore, përgatitja e bilancit Mujor, 4,8 dhe 12-mujor të operatoreve dhe publikimi i tyre në faqen e web-itsi detyrim i ligjit Nr. 43/2015, Monitorim prane OST, OSHEE. Realizimi i monitorimeve tematike specifike të urdheruara nga titullari i ERE-s: Monitorim Tematik prane OST, Analize e gjendjes 4,8,12 mujore të sistemit elektro-energjitik Shqiptar.
- f) Përgatitje e studimeve dhe propozimeve qe lidhen me permiresimin e punes: Jane përgatitur forma tabelare e grafike për të nxjerre në pah në mënyrë krahasuese treguesit me të rendesishem dhe jane paraqitur në Bordin e ERE-e, është kontribuar në paraqitjen dhe saktesimin e treguesve të cilesise së shërbimit në shpërndarje dhe mbledhjen me baze mujore treguesit e cilesise për shërbimin në TL e TM duke perdorur ata tregues qe perdoren e rekomandohen në vendet e zhvilluara.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

12

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

Sektori i monitorimit të tregut. Në mënyrë të përbledhur po paraqesim detyrat e sektorit dhe punën e realizuar prej tyre:

a) Monitorimi i Operatoreve në Tregun e Energjisë Elektrike lidhur me zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në përputhje me Modelin dhe Rregullat e Tregut në Shqipëri: në baze të të dhënave kryen llogaritjet e disbalancave për të gjithë pjesëtarët e tregut si dhe konsumet e konsumatorëve të kualifikuar, monitorohen publikimet e operatoreve kryesore në faqet e tyre të internetit.

b) Rishikim dhe përgatitje të propozimeve për Bordin e Komisionerëve të ERE-s lidhur me rregullat e Tregut në Shqipëri: Përgatitja e relacioneve për ndryshimin e Rregullave për alokimin e kapaciteteve lidhur me zhvillimin e ankandëve ditore si pjesë e rishikimit të rregullave të tregut.

c) Monitorim i ankandëve të kapaciteteve që zhvillohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit: Janë kryer monitorime në lidhje me zbatueshmërinë e rregullave dhe procedurat e Ankandëve të kapaciteteve si ato vjetore/mujore madje edhe ditore.

d) Monitorim i rregullshmerisë së realizimit të importit dhe eksportit (shitje me çmime tregu) të energjisë nga ana e KESH (FPPS): Të dhënat janë monitoruar në baze të raportimeve nga KESH si dhe drejtpërdrejt në subjekt.

e) Monitorim i rregullshmerisë së shitjes me pakicë të energjisë nga OSHEE për të gjithë konsumatorët fundorë, Monitorim i rregullshmerisë së importit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes. Janë përgatitur forma tabelare e grafike për të nxjerre në pah në mënyrë krahasuese treguesit me të rëndësishëm dhe janë paraqitur në Bordin e ERE-s. Monitorim i Zbatimit të rregullores së lidhjeve të reja nga operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

f) Përgatitje e Raportëve Periodike e Specifike lidhur me zbatimin e detyrave funksionale dhe gjendjen e Tregut të energjisë elektrike në Shqipëri. Analize e gjendjes tremujore në sistemin elektro-energjitik Shqiptar: Analize e gjendjes 3-mujore, 6-mujore në sistemin elektro-energjitik Shqiptar.

Nga analiza e rezultateve dhe përpunimi i problematikave e informacioneve të marra, nga strukturat drejtuese të ERE-s, është gjykuar sipas rastit të zhvillohen verifikime, analiza, seanca dëgjimore dhe monitorime në terren.

Janë realizuar monitorime tematike të paplanifikuara në planet mujore - OSHEE, Monitorim mbi indikatorët periodike që raportohen në ERE, Procedurat për organizimin në Sistemin e Faturimit, (Billing), Rezultatet e faturimit sipas niveleve të konsumit, Monitorim mbi zbatimin e detyrimeve në lidhjet e reja, Planet e veprimtimit e objektivat për përmirësimin e situatës - KESH, Menaxhimi i rezervave ujore dhe import-eksportet, Planet e veprimtimit e objektivat për përmirësimin e situatës - OST, Funksionimi i sistemit SCADA, Analize e gjendjeve tremujore në sistemin elektro-energjitik Shqiptar.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

13

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

Monitorimet Tematike gjatë vitit 2017

Urdhëri i Monitorimit	Objekti i Monitorimit	Kompania
Urdhër Nr. 62, datë 02.11.2016	Mbi shqyrtimin e projekt planit të Investimeve për vitin 2017	OSHEE sh.a.
Urdhër Nr. 74, datë 27.12.2016	Analizimi i rezultateve tekniko-ekonomike; Transaksionet e shkëmbimit të energjisë elektrike dhe procedurat e prokurimit të energjisë elektrike; Situata hidroenergjitike dhe menaxhimi i rezervave hidrike; Shërbimet ndihmëse; Analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow i kompanisë për periudhën Prill - Dhjetor 2016	KESH sh.a.
Urdhër Nr. 75, datë 27.12.2016	Analizimi i rezultateve tekniko-ekonomike; Lidhjet e Reja në Sistemin e Transmetimit; Disbalancat e energjisë elektrike, ankandet e kapaciteteve të energjisë elektrike dhe shërbimet ndihmëse; Zbatimi i Planit të Investimeve; Analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow i kompanisë për periudhën Prill - Dhjetor 2016	OST sh.a.
Urdhër Nr. 76, datë 27.12.2016	Analizimi i rezultateve tekniko-ekonomike; Procedurat e prokurimit të energjisë elektrike; Procedurat e operimit të sistemit të faturimit; Mbi zbatimin e Planit të Investimeve; Analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow i kompanisë për periudhën Prill - Dhjetor 2016	OSHEE sh.a.
Urdhër Nr. 17, datë 04.04.17	Mbi ecurinë e punimeve të subjekteve të licencuara "Për ndërtim, instalim, shfrytëzim dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike"	"Biopower Green Energy" sh.p.k.; "ERS-08" sh.p.k.; "HERA" sh.p.k.; "E VENTO S.R.L. ALBANIA" sh.p.k.; "Union Eolica Albania" sh.p.k.; "Alb Wind Energy" sh.p.k.; "EnPower Albania" sh.p.k.
Urdhër Nr. 24, datë 11.05.2017	Mbi shqyrtimin e projekt planit të Investimeve për vitin 2017	OST sh.a.
Urdhër Nr. 25, datë 11.05.2017	Mbi shqyrtimin e projekt planit të Investimeve për vitin 2017	KESH sh.a.
Urdhër Nr. 38, datë 18.07.17	Mbi monitorimin e aktivitetit ekonomiko-financiar të centralit fotovoltaik, për periudhën 2015-2017	"Ujësjellës Kanalizime Korçë" sh.a.
Urdhër Nr. 41, datë 26.07.17	Procedurat e prokurimit të energjisë elektrike si dhe Analiza e Cash Flow për periudhën Janar - Korrik 2017	OSHEE sh.a.
Urdhër Nr. 42, datë 26.07.2017	Transaksionet e energjisë elektrike dhe procedurat e prokurimit si dhe Analiza e Cash Flow për periudhën Janar - Korrik 2017	KESH sh.a.
Urdhër Nr. 47, datë 25.09.2017	Verifikimi në objekt i kapacitetit të instaluar faktik krahasuar me kapacitetin e instaluar dhënë në licencën përkatëse; Regjistrimet e llogarive të të Licencuarit; Parametrat teknikë dhe zbatimi i kushteve, në përputhje me standartet e parashikuara në Kodin e Shpërndarjes dhe Transmetimit sipas rastit; Format e raportimit në përputhje me detyrimet në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi: i. Prodhimi vjetor i ndarë në muaj; ii. Fuqia e mundëshme (Disponibël), duke përfshirë periudhat kohore të disponibilitetit të çdo njësie Gjeneruese e kombinuar kjo me planin dhe kohën për daljen nga puna; iii. Fuqia Aktive dhe Reaktive e çdo njësie Gjeneruese. Pjesëmarrja e tyre në pik dhe në pjesë të veçanta të mbulimit të ngarkesës; Cilësia e prodhimit dhe detaje të marra për përmirësimin e cilësisë së prodhimit; Detaje mbi çdo ndryshim të bërë në Asetet e Prodhimit, përfshirë detaje të çdo elementi që është zgjeruar, nxjerrë jashtë përdorimit ose zëvendësuar gjatë operimit; Kushtet dhe tarifat e lidhjes së prodhuesve.	Shoqëritë e licencuara nga ERE në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (sipas HEC-ëve përkatëse)

Eshtë kthyer në rutine mujore mbledhja e përpunimi i indikatorëve të domosdoshëm që ndihmojnë të gjitha strukturat për të gjykuar lidhur me ecurinë, problematikat dhe trendet e zhvillimit në këtë sektor. Një set i plotë me indikatorët kryesorë të sistemit publikohet në faqen e internetit të ERE-s çdo 4-mujor si detyrim i ligjit Nr. 43/2015 dhe që i shërben të gjithë të interesuarve si dhe rrit transparencën për zhvillimet në sektorin elektro-energjitik.

ERE, në bashkëpunim me USAID, është në fazën e përfundimit të përgatitjes për ndërtimin e një Platformë elektronike të të gjithë sektorit e cila do të detyroje pjesëmarrësit në tregun e energjisë për të plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Direktivat dhe Rregulloret e KE-së si dhe

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

14

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

Ligjet nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", njëkohësisht do ti shërbejë të gjithë të interesuarve për marrjen në kohë reale të informacioneve të nevojshme.

Drejtoria e licensimit dhe monitorimit ka marre pjese duke dhënë kontributin e vet ne:

- Hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjit 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", mbylljen e Rregullores për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre në sektorin e gazit natyror, Mbylljen e praktikave për të cilat kanë filluar procedurat e miratimit si: Rregullave dhe procedurave për liçensimin, ndryshimin, transferimin e pjesëshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e liçensave në sektorin e gazit natyror, Udhëzimi mbi kriteret e percaktimit të aksesit të depozitimit të gazit.
- Për disa ndryshime në rregullat e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit.
- Rregullat për garancitë financiare të pjesëmarrësve për rregjistrim në tregun e energjisë,
- Rregullore për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë, Marrëveshja e pjesëmarrjes në tregun e energjisë.

Grupet e monitorimeve specifike janë organizuar me pjesëmarrje nga drejtori e sektorë të tjerë me qëllim sigurimin e specialistëve të nevojshëm në procesin e monitorimit por edhe për faktin se numëri i specialistëve që punojnë në Drejtorinë e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut është i kufizuar.

Eshte me mjaft rëndësi shtimi i kapaciteteve në strukturën e ERE-s, si dhe forcimi i profesionalizmit dhe pavarësisë operacionale të stafit për të perballuar me sukses sfidat e sektorit të energjisë dhe gazit (duke patur parasysh prodhimin e energjisë nga burime të tjera johidrike si edhe sektorin e gazit).

Drejtoriae Tarifave dhe Çmimeve

Perbehet nga dy sektore:

1. Sektori i Struktures së Tarifave dhe Çmimeve, përgjegjës, specialist dhe,
2. Sektori i Analizes së Kostove dhe Çmimeve, përgjegjës, specialist.

Bazuar në Ligjet Nr 43/2015 "Per Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Nr.102/2015, "Per sektorin e gazit natyror" Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve funksionon sipas parimeve të përcaktuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 141, date 24.12.2008 dhe ndryshuar me vendimin Nr. 80 dt. 24 .08. 2011.

1. Në përputhje me pikën 1 të nenit 16 të Rregullores, Drejtoria e tarifave dhe Çmimeve, dhe në vecanti Sektori i Struktures së Tarifave dhe të Çmimeve, bazuar në metodologjine vleresimit të kostos dhe miratimit të çmimeve, vlereson mjaftueshmerine e tarifave për sigurimin e shërbimit dhe furnizimit me energji e gaz duke i mbajtur vlerat e tarifave në nivelin e mbulimit të kostove dhe të siguroje vazhdimin normal të vepritarise. Në përputhje me pikën 2 të nenit 16 të Rregullores, Drejtoria e tarifave dhe Çmimeve, dhe në

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

15

Enti Rregullator i Energjisë**Auditim Performance për vitin 2017**

veçanti Sektori i Analizes, ka shqyrtuar programet e investimeve të të licënuarve, Pasqyrat Financiare të Operatoreve të energjisë si material mbështetës në përgatitjen e relacioneve për tarifat dhe çmimet. Gjithashtu nga ky sektor dhe në bashkëpunim me sektoret e tjere është hartuar rregullorja për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, e cila u miratua me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 135, dt. 6 Shtator 2017.

2. Kjo Drejtori, në përmbushje të përgjegjësisë që i ngarkon ligji 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” në mënyrë të vecantë referuar nenit 17 pika 4, ERE përcakton, propozon dhe çon për miratim pagesën rregullatore që paguhet prej të licënuarve në përputhje me rregulloren përkatëse. Si rrjedhojë, në Janar 2017 është hartuar rregullorja për përcaktimin e pagesave rregullatore për të licënuarit në sektorin e energjisë elektrike, e cila është miratuar me Vendimin Nr. 190 dt. 23 Nëntor 2017 të Bordit të ERE-s.

Drejtorja e çmimeve dhe tarifave është përgjegjëse për zhvillimin e metodologjisë së tarifave dhe mbledhjen dhe analizen e të dhenave e të informacioneve për propozime të arsyeshme nga operatorët e tregut të energjisë në lidhje me strukturën dhe nivelin e tarifave.

Ashtu si dhe në vitet e mëparshme edhe gjatë vitit 2017, nga kjo Drejtori është synuar që nepermjet tarifave dhe çmimeve të propozuara prej saj dhe të miratuara nga Bordi i ERE, tu japë Operatoreve mundësitë e mbulimit të kostove dhe ti beje të interesuar për përdorimin e të ardhurave për investime të reja në zhvillim të ecurisë së aktivitetit.

Gjatë vitit 2017 kjo Drejtori në bashkëpunim, ka hartuar dhe me Vendim të Bordit janë miratuar disa Metodologji të rëndësishme për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave, si me poshtë vijon:

- Metodologjia e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike miratuar me Vendimin Nr. 142 date 06.09.2017.
- Metodologjia e tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike miratuar me Vendimin Nr. 156, date 28.09.2017.
- Metodologjia e llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 182 dt. 10 Nëntor 2017.
- Metodologjia e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, miratuar me Vendim të Bordit të ERE-s Nr. 180, dt. 8 Nëntor 2017.
- Metodologjia e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal (FSHU), miratuar me Vendim të Bordit të ERE-s Nr. 189, dt. 23 Nëntor 2017.
- Metodologjia për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror miratuar me Vendim të Bordit të ERE-s Nr. 178, dt. 8 Nëntor 2017.
- Metodologjia e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me Vendimin Nr. 201, date 04.12.2017.

Gjithashtu, gjatë vitit 2016 dhe 2017, në bashkëpunim me USAID u hartua metodologjia e llogaritjes së tarifave të Shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose tërësisht nga shteti për rrjedhojë u hartua edhe: Metodologjia e llogaritjes së

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

16

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

Tarifave të Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti.”

Ne u njohem me disa nga rastet për nisjen, diskutimin, perpunimin, relacionet, kundërshtimet e operatoreve, bashkëpunimin me to si dhe komunikimin me Sekretariatën e Energjisë deri në hartimin e plane të metodologjive të mësipërme. Ky proces nga ana procedurale zhvillohet sipas rregullores dhe është transparent për gjithë operatorët e tregut të energjisë. Ne kemi një dokumentacion të mjaftueshëm sasior për të dhënë një siguri të arsyeshme për zbatimin e rregullt të procedurave e afatave deri në miratimin e tyre nga Bordi.

Mbi procedurat për aplikimin dhe miratimin e tarifave dhe të çmimeve

Bazuar në Rregulloren për funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me Vendim Bordi Nr.96, dt.17.06.2016, Neni 21- Procedura e aplikimeve për percaktimin e tarifave e çmimeve, pika 1; kerkohet nga të licensuarit në sektorin e energjisë dhe të gazit të paraqesin propozimet për percaktimin e tarifave dhe të çmimeve jo me vonë se data 1 Shtator e vitit aktual.

Po kjo Rregullore, Neni-22, percakton se ERE do të shpallë vendimet mbi percaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve brenda dates 15 dhjetor të vitit që është paraqitur aplikimi.

Shqyrtimi i aplikimeve për tarifën dhe çmimet nga ana e të licensuarve në sektorin elektroenergetik dhe të gazit natyror kryhet për aktivitetin si vijon:

- Aktivitetin e gjenerimit të energjisë elektrike,
- Aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike,
- Aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike,
- Aktivitetin furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike,
- Aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

Gjate procesit të shqyrtimit të aplikimeve kjo Drejtori analizon situatën energjitike në vend duke pasur parasysh orientimet e qeverisë për sektorin, situatën ekonomiko-financiare të Operatoreve kryesore në tregun energjistik dhe atë të gazit dhe relaton pranë Bordit deri në vendimarrjen që finalizohet me tarifën dhe çmimet sipas strukture së tregut të energjisë.

Nga analizat e kryera dhe informacionit tekniko-ekonomik, ERE konstatoi se të tre Operatorët kryesore në treg, kishin krijuar gjate periudhës 2015-2016 rezerva të cilat u gjykuan të mjaftueshme për zhvillimin normal të aktiviteteve për periudhën pasardhese. Ky konstatim u konfirmua edhe nga rezultati financiar pozitiv, në pasqyrat financiare, për të tre kompanitë në periudhën 2015 – 2016.

Krahas rezultateve të arritura gjate periudhës 2015-2016 u konstatua se shoqëritë kanë trashëguar detyrime të ndërsjellta. Për sa me siper, u gjykua se korrigjimi në ulje i të ardhurave për keto shoqëri nuk do të ishte i arsyeshëm, pasi kjo nuk do të ndihmonte përmirësimin financiar të të gjithë sektorit dhe vecanërisht atë të OSHEE sh.a, e cila vazhdonte të rezultonte me një vlerë të konsiderueshme negative të kapitaleve të veta.

ERE gjykoi që rezervat në të ardhurat të perdoreshin:

- Per shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH sh.a dhe OST sh.a. sipas planit të hartuar nga OSHEE sh.a. për uljen e detyrimeve ndaj këtyre shoqërive në përputhje edhe me ristrukturimin e borxheve të KESH nga EBRD.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

17

Enti Rregullator i Energjisë**Auditim Performance për vitin 2017**

- Per investime me qellim uljen e metejshme të humbjeve në rrjetin e shperndarjes, si dhe permiresimin e cilesise së sherbimit për klientet tarifore.

Ky vendim u mbeshtet edhe tek VKM nr.171, date 25.02.2015, "Per miratimin e Planit të Rimekembjes Financiare të Sektorit të Energjisë Elektrike", i cili e vleresoi si të disfavorshem raportin e lartë të leves financiare.

Ne ketor rethana, në bashkepunim me MEI, mbi bazen e argumentimit mbi mjaftueshmerine e të ardhurave të shoqerive KESH sh.a., OSTsh.a. dhe OSHEE sh.a.për vazhdimësinë normale të veprimtarise së tyre edhe për vitin 2017, ERE me Vendimin nr. 52, date 6.04.2017 vendosi:

1. Shtyrjen deri në 31.12.2017 të fuqisë juridike të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s për lënien në fuqi të tarifave dhe çmimeve të përkohëshme të energjisë elektrike të miratuara me Vendimet nr .139, nr. 145, nr.146, nr.147, dhe nr.148 datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
2. Fuqia Juridike e Vendimit nr.13, datë 16.02.2016 "Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 2016", sipas pikës 1 të vendimit nr.190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, shteron me marrjen e vendimit për përcaktimin e tarifës fikse të energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2017 në zbatim të ligjit nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a.

Operatori i Sistemit të Transmetimit, i licënuar për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike, aplikoi në ERE për rishikimin e tarifës së transmetimit për vitin 2018. OST sh.a. propozoi kater tarifa të ndryshme për kater variante të mundeshme të cilat variojne nga 1,52 Leke /kWh deri në 0.65 lekë/kWh, ose 2,3 here me të lartë deri në nivel të njejte me tarifen aktuale.

ERE bazuar në:

- Metodologjinë e llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, të miratuar me Vendimin Nr. 180, Datë 08.11.2017 të Bordit të ERE-s,
- Analizen e pasqyrave financiare të OST për vitet 2015-2017 dhe të informacionit të paraqitur në aplikim e më pas informacionit shtesë të dërguar nga kompania në pergjigje të kerkesave të ERE-s,
- Argumentave të OST sh.a. të parashtruara në seancen teknike,
- Opinioneve të parashtruara nga palet e interesit,

reflektoi në llogaritjen e të ardhurave të kerkuara për vitin 2018 korrigjimin e të ardhurave të teperta të realizuara gjate periudhen 2015-2017. Të ardhurat e kerkuara prej 5,451 të miratuara për vitin 2018 i mundesojne shoqërisë prokurimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim dhe të sherbimeve ndihmese dhe të balancimit me çmime tregu ashtu sikurse përcaktohet në Nenin 62 të Ligjit 43/2015 "Per Sektorin e Energjisë Elektrike".

Bordi i ERE-s miratoi me Vendimin Nr. 210, datë 28.12.2017 tarifen e transmetimit prej 0.75 leke /kWh për vitin 2018.

Lënia në fuqi e Vendimit nr.52, datë 06.04.2017 të Bordit të ERE-s", mbi çmimet me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

18

Enti Rregullator i Energjisë**Auditim Performance për vitin 2017**

OSHEE sh.a. e liçensuar për aktivitetin e shërbimit të shpërndarjes dhe furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike, pas kërkeses së perseritur nga ana e ERE-s, aplikoi për rishikimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjise elektrike në nivele tensioni dhe për çmimet e shërbimit të furnizimit universal për vitin 2018.

OSHEE sh.a. paraqiti një analize të realizimit të treguesve tekniko-financiare për periudhen 2015-2017 me fokus të veçante në realizimin e prishem të performances së OSHEE për vitin 2017 sh.a. Në perfundim të kësaj analize, OSHEE sh.a. duke arsyetuar se “meqenese tarifa mesatare e perlogaritur për vitin 2018 është thuhajse e njejte me ate të vitit 2015, dhe duke u mbeshtetur në përvojen pozitive të arritjeve të periudhes 2015-2017” propozoi qe:

- Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të jete ajo e miratuar me vendimin nr. 147, date 25.12.2014 të Bordit të ERE-s.
- Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike si dhe çmimet e detajuara për kategorite e klienteve sipas niveleve të tensionit të jene ato të miratuara me vendimin nr.148, date 25.12.2014 të bordit të ERE-s.
- Tarifat e aksesit për nivele tensioni të jene:
 - 2.36 leke/kWh për nivelin e tensionit 35 kV
 - 3.81 leke/kWh për nivelet e tensionit 20-6 kV
 - 5,51 leke/kWh për nivelin e tensionit 0,4 kV.

Në zbatim të rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, aplikimi i ardhur në date 14.12.2017 kerkonte të pakten kater muaj në mënyrë qe të realizohej: analiza e informacionit të paraqitur nga ana e OSHEE sh.a., kërkesa për argumentat shtese, transparenca, terheqja e opinionit të paleve të interesit dhe reflektimi i tyre, organizimi i seancave teknike e publike, etj.

Duke konsideruar faktin qe procedura për shqyrtimin e aplikimit deri në vedimarrje kerkonte kohe, nderkohe qe aplikimi nga ana e OSHEE sh.a. ishte tejet i vonuar, Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 211, datë 28.12.2017 vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për nivele tensioni për vitin 2018.
2. Lënien në fuqi të pikës “1” të Vendimit nr. 52, datë 06.04.2017 “Mbi lenien në fuqi të Vendimit nr. 190, datë 22.12.2016 të Bordit të ERE-s”, sipas tabelës më poshtë:

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

TIPI I AKTIVITETIT	NR. I VENDIMIT	TARIFAT E MIRATUARA
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	Nr. 52, Datë 06.04.2017	1.5 Leke/Kwh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV	Nr. 52, Datë 06.04.2017	3.9 Leke/Kwh
Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes	Nr. 52, Datë 06.04.2017	4.79 Leke/Kwh
Çmimi i shitjes për Klientët në 20 kV *	Nr. 52, Datë 06.04.2017	11 Leke/Kwh Në Pik 12.65 Leke/Kwh
Çmimi i shitjes për Klientët në 10/6 kV *	Nr. 52, Datë 06.04.2017	11 Leke/Kwh Në Pik 12.65 Leke/Kwh
* Miratim i përkohshëm për klientët që nuk arrijnë të sigurojnë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit në përputhje me VKM nr. 449, datë 15.06.2016, furnizimi si mundësi e fundit i këtyre klientëve kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit me çmimet si më lart		
Çmimi i shitjes për Konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU	Nr. 52, Datë 06.04.2017	12.4 Leke/Kwh Në Pik 14.3 Leke/Kwh
Çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor	Nr. 52, Datë 06.04.2017	*Çmimet paraqiten në tabelën më poshtë
TARIFAT E SHËRBIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDOR		
Niveli i tensionit	Çmimi (Leke/kWh)	Çmimi pik (Leke/kWh)
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjarë	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndricim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Leke/Muaj)		200
*Çmimi i energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të energjisë aktive		
*Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është :		
Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00		
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		

Burimi ERE

3. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 53, datë 06.04.2016 "Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi universal për kategorinë objekte kulti/bashkësi fetare datë 06.04.2017"

Prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe impakti i tyre

Prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike (HEC-et me fuqi deri në 15 MW) në vitin 2017 pesoi një ulje prej rreth 27% krahasuar me vitin 2016. Ndikim kryesor në rënie e prodhimit nga keta prodhues ishin prurjet e pakta hidrike gjatë vitit 2017. Futja në operim gjatë vitit 2017 e 5 centraleve të rinj me fuqi të instaluar 11,525 MW dhe një prodhim prej 27,8 GWh, nuk zvogeloi efektin negativ të kushteve të pafavorshme hidrike.

Prodhimi me i ulet i energjisë elektrike ndikoi në uljen e të ardhurave të realizuara nga prodhuesit me përparësi në krahasim me vitin 2016 për vitin 2017 çmimi i blerjes së energjisë nga keta gjenerues ishte i njejtë me atë të vitit parardhës.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

20

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

Tendenca në rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit me perparësi ku pervec shtimit të kapaciteteve prodhuese të impianteve hidro, në të ardhmen parashikohet të fillojnë prodhimin edhe impiantet fotovoltaike, eolike dhe inceneratorët që kanë lende të pare pjesen e biodegradueshme të mbetjeve të ngurta urbane, ndikon në rritjen edhe me tej të peshe specifike që ze prodhimi nga prodhuesit me përparësi ndaj konsumit total të energjisë elektrike.

Per shkak të kushteve të pafavorshme hidrike shpenzimet për blerjen e energjisë nga prodhuesit me perparësi në vitin 2017 zinin rreth 19% të shpenzimeve totale për energji të OSHEE sh.a nga 39.6% në periudhen parardhese. Nderkohe u verejt rritje e shpenzimeve për blerjen e energjisë në tregun e parregulluar nga 25.8% në 64.5 % të totalit të shpenzimeve. Blerja në tregun e parregulluar kompensoi rritjen e prodhimit nga impiantet hidrike si KESHsh.a., Hec Ashta dhe prodhuesit me perparësi duke bere evidente nevojen e diversifikimit të burimeve gjeneruese.

Nxitja e investimeve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë, i sherben diversifikimit të burimeve në Shqipëri dhe arritjes së objektivit kombëtar prej 38% në vitin 2020.

Per ERE-n dhe gjithë Operatorët e Tregut sfide mbetet gjetja e rrugëve për nxitjen e investimeve eficiente, për mundësinë e daljes së tyre në tregun e parregulluar si dhe shtrirjen e kontributit për mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme tek të gjithë klientet fundore.

ERE, në zbatim të nenit 10, pika 3 të Ligjit 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” si dhe në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me Vendimin Nr. 120, dt. 27Korrik 2017 ka caktuar çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nga dielli dhe era, dhe u diskutua opinioni i ERE-s në lidhje me projektvendimin për metodologjinë e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesët e biodegradueshme të mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale. Ne sugjerojmë ngritjen e një sektori të veçantë me synimin e analizës dhe përcaktimit të tarifave për prodhimin e enregjisë nga burimet jo hidrike.

Çmimi i përditësuar i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2017.

VKM nr. 687, datë 22 Nëntor 2017 miratoi “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”. Po kjo VKM përcaktoi gjithashtu edhe kufijtë maksimal dhe minimal të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi të cilët janë: jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016.

Pika 5 e vendimit të ERE-s nr.190, datë 22.12.2016 i cili la në fuqi Vendimin nr. 13, datë 16.02.2016 “Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 2016” përcaktoi detyrimin për përditësimin dhe kompensimin e të gjitha efekteve të mundshme financiare për të licensuarit në periudhën pasardhëse.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

21

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

Në zbatim të këtij detyrimi, ERE kreu llogaritjet për përditësimin e çmimit për vitin 2017, me qëllim llogaritjen e kompensimeve të mundshme në periudhën pasardhëse.

Sipas raportit vjetor të çmimeve për tregun e ditës në avancë për vitin 2016 të publikuar në faqen zyrtare të Bursës Hungareze rezultoi që çmimi i ditës në avancë të shlyerjes së energjisë elektrike në bazë për vitin 2016 është 35.43 EUR/MWh.

Nisur nga keta tregues dhe në zbatim të formulës për llogaritëse të metodologjisë së miratuar me VKM nr. 667, datë 22.11.2017 rezultoi çmimi i blerjes së energjisë prej 6.33 leke/kWh i cili është më i ulët se kufiri minimal prej 7.448 lekë/kWh siç është përcaktuar në dispozitën 2.ç të VKM nr. 667.

Ne perfundim edhe për vitin 2017 mbeti në fuqi çmimi 7,448 lekë/kWh i njejte me ate të vitit 2016.

Çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet që shfrytëzojnë burimet e rinovueshme nga dielli dhe era për vitin 2017.

VKM nr. 369, datë 26.4.2017 miratoi "Metodologjinë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era" dhe ngarkoi Entin Rregullator të Energjisë të miratojë çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

ERE ka gjykuar se përcaktimi i çmimeve të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, i shërben nxitjes së investimeve në burimet e rinovueshme të teknologjive të ndryshme nga ajo e HEC-eve duke ndikuar në rritjen e diversifikimit të burimeve të rinovueshme në Shqipëri si dhe arritjes së objektivit kombëtar prej 38% deri në vitin 2020.

Ne baze të metodologjisë së miratuar nga Keshilli i Ministrave, dhe duke marrë parasysh mungesat e të dhenave lidhur me kostot e investimit dhe operimit të teknologjive fotovoltaike dhe eolike në vend, mungesën e eksperiencave të mëparshme për incentivimin dhe mbështetjen e investimeve në këtë fushë si dhe duke bërë një krahasim me çmimet e rajonit për keto burime, për të mundësuar nxitjen e investimeve në keto teknologji, ERE me Vendimin nr 120 date 27.07.2017 miratoi për vitin 2017 çmimin të jete 100 Euro/MWh për burimet e energjisë nga dielli dhe 76 Euro/MWh për burimet e energjisë nga era për të gjithë kontraktuesit e ndërtimit të impianteve.

Miratimi i tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror për periudhën 05.01.2017-20.09.2017 dhe lënia në fuqi e tarifës së përkohshme të transmetimit deri më 31.12.2017

ERE me Vendimin nr.82, datë 26.05.2017, vendosi certifikimin paraprak të Shoqërisë ALBGAS sh.a. si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet perkatëse të ligjit nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror". ERE me tej licensoi ALBGAS sh.a.për aktivitetin e shpërndarjes dhe transmetimit të gazit natyror respektivisht me vendimet 187 dhe 188 date 10.11.2017.

ALBGAS sh.a., aplikoi në ERE për miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

22

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

ERE, mbi bazë të analizës së informacionit të disponuar nepermjet korrespondencës dhe komunikimeve me Albgaz sh.a. në seancat teknike, miratoi me vendimin nr. 90, date 7.06.2017 tarifen e transmetimit të gazit natyror prej 25 lekë/m³ për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017. Kjo tarifë është rezultat i të ardhurave të kërkuara të miratuara prej 71.55 milion lekë dhe sasise prej 2,861 mije Nm³ të gazit për t'u lëvruar në rrjetin e transmetimit.

1. Ndryshimet në tarifën dhe çmimet

Tarifa e shitjes me shumicë të energjisë elektrike nga KESH sha në funksion të shërbimit të furnizimit me shumicë ndërpritet në vitin 2016 për shkak se ky funksion i kaloi furnizuesit të shërbimit universal. KESH, në zbatim të ligjit 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i cili imponon liberalizim të segmenteve të prodhimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, dhe të VKM nr. 244, dt. 30.03.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", në vitin 2018 do të sheshe energji tek furnizuesi i shërbimit universal për mbulimin e kërkesës së klienteve fundore dhe tek operatori i sistemit të shpërndarjes për mbulimin e humbjeve me çmime të parregulluara nga ERE.

2. Tarifën e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, për vitin 2017

Baza e të dhënave e Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) për tarifën e energjisë është burimi kryesor i të dhënave zyrtare të energjisë elektrike në vendet e Evropës Qendrore / Lindore.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrimit, Financës dhe Marrëdhënieve me jashtë të ERE-s

Kjo Drejtori ka këtë strukturë të miratuar:

- Specialisti i Financës dhe Protokoll Arkives,
- Sektori i marrëdhënieve me jashtë,
- Specialisti i IT-se dhe Shërbimit të Marrëdhënieve me jashtë.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrimit, Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë mbulon veprimtarinë financiare të ERE-s dhe mban përgjegjësi të plotë për të gjitha problemet që kanë të bëjnë me administrimin, si dhe marrëdhëniet me jashtë, konform legjislacionit të shtetit shqiptar. Në bashkëpunim me drejtorinë e tjera përgatit projekt-buxhetin për miratim, kontrollon dhe evidenton shpenzimet e kryera, fondet e përdorura për investime, dhe blerjet e vogla. Merr masa dhe përgjigjet për krijimin e kushteve të nevojshme të punës për personelin teknik dhe Bordin e Komisionerëve. Mbi bazën e buxhetit të miratuar për vitin aktual, kalkulon dhe ndjek pagesat e rregullimit nga të licencuarit dhe mbi bazën e analizave financiare bën kompensimin e detyrimeve nëse është edomoshme. Përgatit dhënieve e llogarisë vjetore për institucionin, si pjesë e raportit vjetor të ERE-s. Gjithashtu kjo drejtori mbulon programimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe të marrëdhënieve me jashtë duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

23

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

Mbi administrimin e Burimeve njerëzore

Bazuar ne Ligjin Nr. 43/2015 "Per Sektorin e Energjisë Elektrike" Neni 11, Pika 1, emerimi i Kryetarit dhe anetareve të bordit behet nga Kuvendi i Shqipërisë. Nderkohe sipas pikes 7 të po ketij neni, Bordi përcakton strukturën organizative të ERE-s dhe numrin e punonjësve, pagën dhe trajtimet financiare të kryetarit, të anëtarëve të bordit, si dhe të personelit teknik. Në përcaktimin e masës së pagës dhe trajtimeve financiare apo jofinanciare të personelit teknik, bordi merr parasysh kushtet e tregut dhe nivelin e pagave në shoqëritë që kontrollohen në sektorin që mbulon.

Sipas pershkrimit të mesipërm, Bordi ka kopetencën për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të punonjesve.

ERE sipas vendimit të mësipërm ka një strukture të miratuar prej 32 vetash dhe një personeli mbeshtetes dhe shërbimi me date 31 dhjetor 2017 prej 9 vetash. Personeli prej 32 vetash aktualisht gezon statusin e nepunesit civil sipas Ligjit Nr. 152/2015 "Per nepunesin Civil".

Sipas nenit 2, të Ligjit "Per nepunesin Civil" ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (në vazhdim "nëpunës civil"), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore. Termi "Institucion i pavarur" nënkupton administratën e Kuvendit, e Presidentit, e pushtetit vendor, e Gjykatës Kushtetuese, e Gjykatës së Lartë, e Prokurorisë dhe çdo institucion i pavarur, i parashkuar në Kushtetutë apo i krijuar me ligj dhe që i raporton Kuvendit, përfshirë degët e tyre territoriale.

Pikerisht neni 11 pika 7 e tij e ben të nevojshem rishikimin e Vendimit nr.181, datë 05.05.2008 të Kuvendit të Shqipërisë mbi përcaktimin e organikes së ERE-s.

Bazuar në Ligjin Nr 43/2015 "Per Sektorin e Energjisë Elektrike" neni 15, Konflikti i interesit, jane përcaktuar kushtet dhe rrethanat qe perbejnë Konflikt Interesi. Ky nen i le fushë veprimi Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, sipas pikes 2 të cituar si me poshte:

Nëse gjatë procedurave aplikuese për dhënien e një licence sipas këtij ligji ose gjatë një procedure në të cilën përfshihen interesa financiarë të një të licencuari, përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në çështje të tarifave, kryetari, anëtar i bordit dhe/ose personeli teknik gjendet në një situatë konflikti interesi, përveç atyre të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, por që përfshihet në përcaktimet e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, ai nuk merr pjesë në vendimarrjen përkatëse.

ERE, gjate vitit 2017, lidhur me pranimet e reja, ka pasur parasysh të dy Ligjet e mësipërme.

ERE- në përcaktimin e pagave është bazuar në një fushë të gjere legjislacioni e cila ka patur parasysh se personeli i saj trajtohet në kushtet e nepunesit civil.

Ky Legjislacion është renditur si vijon:

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

24

Enti Rregullator i Energjisë**Auditim Performance për vitin 2017**

- Ligji nr. 9584, datë 11.07.2006, "Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", i perditësuar me Ligjin nr. 9845, datë 17.12.2007, Vendim i GJK 9/2007, Ligj nr.115/2013, Ligj nr. 58/2014 dhe Ligji nr. 16/2015.
- Vendimi nr. 589 i Këshillit të Ministrave, datë 17.07.2013, për disa ndryshime në vendimin nr. 545, dt 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, gjykatën e lartë, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të këshillit të ministrave, kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit".
- Vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" të ndryshuar me VKM nr.621, date 8.07.2010, VKM nr.551, date 11.08.2011, VKM nr.690, date 9.10.2012, VKM nr.610, date 24.07.2013, VKM nr. 859, date 21.10.2015, VKM nr. 202, date 15.03.2017.
- VKM nr. 187 datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit".
- VKM nr. 524, datë 16.08.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit" të ndryshuar, Lidhja nr. 2, Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar.
- Ligji nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar me Ligjet nr. 9832, datë 12.11.2007, nr. 10307, datë 22.07.2010, neni 26 ciklet dhe titujt e studimeve universitare dhe neni 99/1 dhe 99/2 .
- Vendimi nr. 475, datë 13.07.2007 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratës së presidentit, kuvendit dhe komisionit qendror të zgjedhjeve".
- Udhëzimi nr. 1, datë 18.04.2008 për "Zbatimin e vendimeve nr. 475, datë 13.07.2007 i ndryshuar nr. 476, datë 18.07.2007 i ndryshuar dhe nr. 478, datë 18.07.2007 i ndryshuar të këshillit të ministrave" pika 12.
- Udhëzimi nr. 01, datë 16.03.2012 për Zbatimin e vendimit nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave.
- Vendim nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".

Audites Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

25

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

- Vendim nr. 339, datë 03.05.2017 ‘Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi’, pika 1 “Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 24 000 lekë.”
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, kontributet në përqindje në tabelën sipas pikës 10.3.
- VKM nr. 77, datë 28.01.2015 ‘Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor’.
- Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar me ligjin nr.85/2012, datë 18.09.2012 dhe Ligjin nr.45, datë 24.04.2014.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga të 10 zyrtarët (që janë subjekt i këtij detyrimi), sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji. Gjithashtu punonjës të ERE kanë marrë pjesë rregullisht në trajnimet e organizuar nga ILDKPKI.

Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s

Bazuar në Ligjin nr. 43/2015 "Per Sektorin e Energjisë Elektrike" neni 17, Financimi i ERE-s është përcaktuar që Burimet financiare të ERE-s përbëhen nga pagesat rregullatore dhe pagesat e licencave, të miratuara nga ERE. Drejtoria perkatese sektori kontabilitetit mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi kontabilitetin. Organizon mbajtjen e një database për të pasqyruar dhe zhvilluar më tej punën e departamentit. Përdor programet baze kompjuterike. Organizon mbajtjen e kontabilitetit sipas ligjit dhe është përgjegjës për trajtimin kontabël të informacionit që i paraqet Kryetarit, Bordit dhe institucioneve të tjera të interesuara. Është përgjegjës për përgatitjen e informacionit financiar zyrtar për arsye publikimi.

Ne rekomandojme perdorimin e programeve financiare kompjuterike për të rritur efikasësinë në punën e departamentit.

ERE bazuar në metodologjinë e miratuar nga Bordi, sipas pikës 4, të nenit të mësipërm llogarit dhe percakton pagesen rregullatore për çdo Operator të Licensuar. Keta të fundit janë të detyruar të bëjnë pagesen brenda 30 diteve nga data e marjes njoftim, në të kundërt duhet të penalizohen sipas nenit 107, të Ligjit nr.43/2015.

Buxheti i ERE-s miratohet nga bordi dhe ERE ka autonomi në përdorimin e buxhetit të tij.

Në fushën e administrimit të burimeve financiare është zbatuar Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për “ Prokurimet Publike”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

Kjo Drejtori ka hartuar Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2017 së bashku me Shenimet shpjeguese të cilat janë pranuar dhe firmosur nga Kryetari e ERE-s në cilësinë e Administratorit të saj.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

26

Enti Rregullator i Energjisë**Auditim Performance për vitin 2017**

Kjo Drejtori ka zbatuar afatet kohore në lidhje me kryerjen e prokurimeve të fondeve publike, në përputhje me ligjin e prokurimeve dhe akteve të tjera nen ligjore.

Gjithashtu, është kryer inventarizimi i pasurisë që ERE ka në administrim. Inventarizimi i asetëve të institucionit për vitin 2017 sipas Urdhërit nr. 63, datë 29.12.2017 “Mbi ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të ERE-s për vitin 2017” si dhe krijimin, mbajtjen dhe ndjekjen e vijimësisë së dosjes financiare-ligjore të inventarëve për vitin 2017.

Struktura e shpenzimeve financiare të realizuara nga ERE-s për vitin 2017 paraqitet si vijon:

- 69% janë perdorur për pagat dhe sigurimet e punonjësve;
- 14% janë perdorur për shpenzime udhetimesh e dietash të personelit;
- 11% janë perdorur për investime në blerjen e dy automjeteve;
- 6% janë perdorur për blerje dhe shërbime në ndihme të aktivitetit.

Prokurimi për blerjet

Baza ligjore mbi të cilën zhvillohen procedurat e prokurimit për mallra e shërbime për plotësimin e nevojave të ERE-s janë:

- Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”
- Udhëzimi i APP-së nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”
- Udhëzimi i APP-së nr.5, datë 14.04.2017 “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik”.
- Udhëzimi i APP-së nr.7, datë 22.05.2015 “Për veprimet e Njesisë së Prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik”.
- Udhëzimi i APP-së nr.3, datë 09.05.2017 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik”.
- Udhëzimi i APP-së nr.2, datë 27.01.2015 “Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrin të Realizimeve të Prokurimit Publik.

Në bazë të nenit 57 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar, me Urdhër të Kryetarit të ERE-s nr. 2, datë 04.01.2017 është ngritur Njësia e Prokurimeve për zhvillimin e procedurave të prokurimit për plotësimin e nevojave të ERE-s me mallra e shërbime për vitin 2017. Gjithashtu me Urdhërin nr.1, datë 04.01.2017 është ngritur Komisioni i Blerjeve të Vogla për zhvillimin e procedurave me vlerë të vogël me fond limit deri në 800.000 lekë pa TVSH.

Gjatë vitit 2017 janë realizuar 43 procedura prokurimi, nga të cilat:

- 34 procedura prokurimi me vlerë të vogël për mallra e shërbime me objekt si: Blerje artikuj kancelarie, Blerje bojëra për printera, Blerje letër A4, Blerje ujë i pjshëm, Shërbim interneti, Shërbim i ruajtjes me roje private, Shërbim riparim kondicionerësh, Mirëmbajtje e automjeteve, Siguracion kasko e TPL për automjetet, Shërbim pritje zyrtare etj.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

27

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

- 6 procedura prokurimi negocim pa shpallje paraprake, kryesisht shtesë kontrate në masën 20% të kontratës fillestare për plotësimin e nevojave të fillim vitit.
- 2 procedura të hapura prokurimi me objekt: Blerje 2 automjete, dhe Blerje bileta udhëtimit të transportit ajor.
- 1 procedurë Kërkesë për propozim me objekt: Blerje karburanti për automjetet e ERE-s.

Në bazë të Udhëzimit të APP-së Nr.2 datë 27.01.2015 "Për hartimin e Regjistrimit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrimit të Realizimeve të Prokurimit Publik, brenda datës 20 të çdo 4 mujori (pra në janar, maj, shtator) është dërguar pranë APP-së Regjistri i Realizimit të procedurave të prokurimit. Gjithashtu me miratimin e buxhetit nga ana e Bordit të ERE-s, është dërguar në APP dhe Regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2017.

Veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s gjatë vitit 2017 është audituar nga një grup audituesish ligjor bazuar në Ligjin nr. 10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar".

Personeli i finances u trajnuar për krijimin e dosjes ligjore të pagave të punonjësve të ERE-s për arsye të implementimit të sistemit HRMIS (sistemi i menaxhimit të informacionit të burimeve njerëzore për krijimin e regjistrimit qëndror të personelit me informacion mbi strukturën, organizimin dhe sistemin e pagave). Megjithatë trajnimi i stafit u bë perfshirja në këtë sistem nuk u realizua për shkak se ERE është një person juridik publik, i pavarur nga çdo institucion tjetër publik ose privat (neni 10 pika1).

Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë

Ky sektor kryen detyrat që kanë të bëjnë me veprimtarinë dhe marrëdhëniet që ERE ka me institucionet homologe jashtë vendit, me institucionet ku aderon, si dhe me organizma të ndryshme ndërkombëtare për probleme të caktuara, në përputhje me porositë që merr prej Kryetarit të Bordit të Komisionerëve. Ky sektor drejtohet nga Shefi i Sektorit, i cili raporton në çdo kohë tek Kryetari për realizimin e detyrave të ngarkuara dhe para Bordit kur e thërret.

Specialisti i Informacionit dhe Teknologjisë së Shërbimit të Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë i raporton përgjegjësit të sektorit, merr udhëzime e detyra prej tij, prej Drejtorit të drejtorisë, Kryetarit të Bordit, kur konsiderohet e arsyeshme nga ky i fundit. Specialisti kryen detyrat instalim dhe mirembajtje të rrjetit, përditësimne faqes elektronike të ERE-s.

Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Kjo Drejtori ka dy sektore:

1. Sektori i Legjislacionit; Përgjegjës dhe specialist
2. Sektori i Mbrojtjes Konsumatorit dhe Mardhenieve me Publikun dhe specialist.

Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, vepron si përfaqësues ligjor i ERE-s; përgatit vendimet dhe urdhërat e ERE-s në konformitet me legjislacionin që është në fuqi. Përgatit konferenca shtypi dhe drejton komunikimet zyrtare me publikun; boton në gazetën zyrtare të gjitha vendimet dhe urdhrat e ERE-s konform kërkesave dhe detyrimeve të përcaktuara në ligj.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

28

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

Në bashkëpunim me drejtorite e tjera merr pjesë në përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe veprimtarive të ERE- s.

Evidenton në një regjistër të veçante, të gjitha ankesat e paraqitura nga konsumatorët, personat e licensuar dhe institucionet e ndryshme. Në bashkëpunim me drejtoritë, i shqyrton këto ankesa, përgatit përgjigjet në vartësi të zgjidhjeve të mundshme konform ligjit duke respektuar afatet kohore të përcaktuara në të.

Kuadri Rregullator Sekondar

Një pjesë e veprimtarisë së kesaj Drejtorie është edhe hartimi i legjislacionit sekondar që përbën edhe kuadrin rregullator në Sektorin e Energjisë Elektrike. Hartimi dhe rishikimi i akteve nënligjore në bashkëpunim me Drejtorite e tjera si dhe me Kryetarin dhe Antaret e Bordit, është bërë në çdo rast duke konsultuar gjerësisht palët e treta që kanë patur interes të drejtëpërdrejtë mbi këto vendimmarrje. Në çdo rast fillimi i procedurave për shqyrtimin e një akti nënligjor nga ana e ERE-s është njoftuar në mediane dhe shkruar për ti dhënë mundësi njohjeje publikut me të por edhe të përcjellë komente apo sugjerime mbi përmbajtjen. Zhvillimi i seancave dëgjimore me prezencën e palëve që kanë shfaqur interes për dokumentat në proces përpunimi nga ERE, të cilat në çdo rast janë bërë publike për palët përmes publikimit të tyre në faqen elektronike të ERE-s, është një fazë e procesit të miratimit të akteve që është respektuar me seriozitet e në shumë raste janë organizuar disa seanca dëgjimore me qëllim ballafaqimin e propozimeve të ndryshme mbi këto akte nga palët e interesuara. Po ashtu edhe finalizimi i procesit të miratimit të një akti, garanton transparencën e vendimmarrjeve të ERE-s përmes mbledhjeve vendimmarrëse të cilat janë të hapura për publikun. Në çdo rast aktet e miratuara nga ERE janë konsultuar me Autoritetin e Konkurrencës, Ministrinë përgjegjëse për energjinë, si dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë. Në miratimin e këtyre akteve është mbajtur në konsideratë opinioni i palëve si më sipër, si një garanci më shumë në plotësimin dhe mbrojtjen shumëplanëshe të interesave të aktorëve të tregut të energjisë elektrike por mbi të gjitha interesave të konsumatorëve. Janë 214 vendimmarrje të Bordit të ERE përgjatë vitit 2017, ndër të cilat 58 prej tyre kanë të bëjnë me ndjekjen e procedurave të parashikura në ligj me qëllim miratimin e kuadrit ligjor në zbatim të legjislacionit në fuqi në sektorin e energjisë elektrike por edhe atë të gazit natyror. Ndër këto vendimmarrje përmendim miratimin e një sërë aktesh të rëndësishme në funksion të operimit të saktë dhe eficient të sektorit të energjisë:

- Mbi miratimin e “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”;
- Mbi miratimin e “Udhëzimit mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”;
- Për miratimin e “Rregullores mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit, kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”;
- “Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të ankandëve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Europën Jug – Lindore (SEE CAO)”;
- Mbi miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”;

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

- Mbi miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”;
- Mbi miratimin e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”;
- Mbi miratimin e Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike”;
- Mbi miratimin e “Kodit të Transmetimit”;
- Mbi miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal;
- Mbi miratimin e “Rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike”;
- Mbi miratimin e “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”;
- Mbi miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”;
- Mbi Miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike”;

Hartimi dhe rishikimi i akteve nënligjore nga ana e ERE-s, bëhet sipas rastit me iniciativën e saj ose me kërkesë të palëve në zbatim të detyrimeve që ligji ngarkon për secilin.

Rrishikimi në ndryshim i vendimeve apo Akteve të ERE-s

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2017, krahas akteve të nxjerra në kuadër të legjislationit sekondar, ka nxjerrë dhe akte për të ndryshuar apo modifikuar akte të nxjerra më parë. Përmendim këtu akte si:

- Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 75, datë 26.5.2017, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 25, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 169, datë 31.10.2016, “Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”;
- Rrëzimin e kërkesës së Shoqërisë OST sh.a. për rishikimin dhe korrigjimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 52, datë 06.04.2017 “Mbi lënien në fuqi të Vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017”.

Të tjera vendimmarrje të rëndësishme të Bordit të ERE përgjatë vitit 2017 kanë qenë ato të lidhura me procesin e ndarjes së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, çertifikimit të OST, apo miratimit të operatorit të gazit Albgaz sha. Si më poshtë listojmë disa nga këto vendimmarrje të rëndësishme, puna për miratimin e të cilave është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë si dhe konsulencën aktive të USAID:

- Mbi miratimin përfundimtar të Çertifikimit të OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 9, pika 6 të Direktivës 72/2009FC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

30

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

- Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”;
- Miratimin e “Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë”;
- Miratimin paraprak të Çertifikimit të Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror Albgaz sh.a.;
- Mbi licencimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a.”, në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
- Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror”, Albgaz sh.a.

Një ndër detyrat që i ngarkon ERE-s “Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të Energjisë”, është edhe dokumentimi në një regjistër të veçantë të vendimeve të bordit të ERE dhe Urdhrave të Kryetarit. Regjistri i Vendimeve të ERE përditësohet edhe me botimin e secilit vendim në Fletoren Zyrtare. Në fund të çdo viti kalendarik këto regjistra printohen dhe i bashkëlidhen dosjes së arkivës së Drejtorisë Juridike në të cilën ruhen respektivisht vendimet dhe urdhrat e ERE-s. Janë 63 urdhëra të përpiluar nga Sektori i legjislacionit të cilat lidhen me zbatimin e rekomandimeve të Kryetarit të ERE-s për të organizuar seanca dëgjimore, seanca teknike, për të ngritur grupe pune monitorimi apo grupe pune me qëllim kryerjen e procedurave të prokurimeve.

Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar disa seanca dëgjimore, teknike ose jo, të organizuara nga ERE në zbatim të neneve 27 dhe 29 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis operatorëve të licencuar të tregut energjistik apo edhe seanca diskutimesh me palët e interesuara, në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Përgjatë vitit 2017, në ERE janë zhvilluar 23 seanca dëgjimore me diskutime me palët e interesuara në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe atij nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. dhe janë zhvilluar 12 seanca dëgjimore, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis operatorëve të licencuar të tregut energjistik.

Hartimi i Kontratave apo Marrëveshjeve Tip në ndihmë të Operatoreve të sektorit

Në zbatim të parashikimeve të nenit 20 gërma “h” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, për shkak të detyrimit me të cilin e ngarkon ky ligj ERE-n në cilësinë e rregullatorit të sektorit, janë miratuar një sërë kontratash apo marrëveshjesh TIP të cilat gjenerojnë detyrime për palët nënshkruese brenda kornizave të parashikimeve të ligjit. Më poshtë listojmë kontratat TIP apo marrëveshjet e miratuara nga ERE si detyrim i parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

- Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe Furnizuesit të energjisë elektrike;
- Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe Furnizuesit të energjisë elektrike;
- Mbi miratimin e Kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2017-31.12.2017;

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

- Miratimi i Kontratës për shit-blejje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti-KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal-OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2017;
- Miratimi i Draft-Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Tregun e Energjisë Elektrike;
- Miratimi i kontratës së shërbimit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a.

Sektori i Legjislacionit në zbatim të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të Energjisë”, miratuar me vendimin nr. 141, datë 24.12.2008, ndër të tjera ka për detyrë të marrë pjesë në proceset gjyqësore ku ERE është palë apo është thirrur me cilësinë e personit të tretë nga gjykata. ERE ka qenë palë e paditur në disa procese gjyqësore të iniciuara në vitet 2011-2012 nga shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. në lidhje me vendimmarrje të ERE-s të cilat datojnë në vitet 2010-2011, e për rrjedhojë vetë objekti i kërkimit i pretenduar nga pala zëvendësuese paditëse OSHEE sh.a., ka humbur aktualitetin. Bëhet fjalë për vendimmarrjet e ERE-s në lidhje me klauzola të Kontratës së furnizimit për klientët familjarë në vitet 2011-2012, apo marrëveshje të subjekteve të licencuara OSHEE-OST, etj, të cilat pikërisht për shkak të vendimmarrjeve të reja, zëvendësuese, në vitet në vijim, kanë humbur aktualitetin. Shpallja e pavlefshme e këtyre vendimmarrjeve nuk prodhon asnjë efekt mbi palët, pikërisht për shkaqet e sipërcituara. Këto gjykime, kanë përfunduar me vendim të formës së prerë në gjykatën e apelit, pas rrëzimit të padive nga gjykata kompetente.

Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Marrëdhëniet me Publikun

Ky sektor trajton dhe zgjidh të gjitha ankesat dhe konfliktet direkte që lindin nga marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike apo gazit natyror dhe konsumatorëve, si dhe midis të Licënsuarve, duke pasur si qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në aspektin individual dhe mbrojtjen e interesave të tyre në tërësi nga abuzimet e aktorëve dominant në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

ERE në zbatim të Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ushtron autoritetin dhe përgjegjësinë e tij në drejtim të zbatimit të masave më efektive për garantimin e mbrojtjes së klienteve të energjisë elektrike, për të pasur tarifa që reflektojnë kostot e drejta dhe të argumentuara për një shërbim furnizimi me energji elektrike të pandërprerë dhe brenda standardeve të cilësisë së furnizimit.

Mbrojtja e Konsumatorëve është e orientuar edhe në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet klientëve të energjisë elektrike dhe të licencuarve, sikurse përcaktohet në nenin 24, të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenin 98, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Roli i ERE-s në veprimtarinë e mbrojtjes së konsumatorit, gjatë vitit 2017, gjithashtu ka konsistuar edhe në hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe monitorimit të zbatimit nga Furnizuesi i Shërbimit Universal të akteve nënligjore të tilla si Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë (etj).

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

32

Enti Rregullator i Energjisë**Auditim Performance për vitin 2017**

Sektori i Mbrojtjes së konsumatorëve përgatit rekomandime dhe asiston në hartimin e akteve ligjore dhe legjislacionin sekondar të ERE-s lidhur me çështjet e mbrojtjes së konsumatorit.

Gjate 2017 jane hartuar disa akte nënligjore, të tilla si:

- Kushtet e përgjithshme të Kontratës së Shërbimit të Furnizimit për Klientët Fundorë.
- Rregullorja “Mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”.
- Rregullorja “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.
- Rregullorja “Për parametrat e cilësisë së furnizimit dhe performanës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”.
- Rregullorja për “Metodologjinë e llogaritjes së rimbursimit të Dëmit Ekonomik nga Operatori i Sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”.
- “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.
- Rregullorja “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”.
- Rregullores mbi “Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Gaz Natyror për Klientët Fundorë”.
- Rregullorja “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”.

Ky sektor gjithashtu kryen sondazhe për të ekzaminuar dobishmërinë e shërbimeve të kompanisë kundrejt furnizuesit dhe kryesisht lidhur me vazhdimësinë e furnizimit, treguesit të standarteve të garantuara dhe cilësisë së furnizimit, aktivitetit të furnizuesit për transparencën ndaj klientëve. Informon konsumatorët për të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe për mundësinë që ata kanë për të kërkuar informacionin e nevojshëm dhe rrugën e zgjidhjes së problemeve.

Përgatit dhe organizon seancat dëgjimore si dhe konferencat për shtyp, siguron transparencën dhe kujdeset për pjesëmarrjen e publikut dhe të grupeve të interesit në këtë proces. Kujdeset dhe bashkëpunon me Shoqatat e Konsumatorëve dhe të përfaqësuesve kryesor të përdoruesve dhe mban kontakte të vazhdueshme me ta si dhe me median.

Konkluzion:

Ne kemi shpjeguar ne menyre te permbledhur funksionimin dhe kryerjen e procedurave nga strukturat e ERE-s dhe japim një siguri te arsyeshme lidhur me zbatueshmerine dhe respektimin e rregullave te percaktuara nga Legjislacioni perkates.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

33

Enti Rregullator i Energjisë

Auditim Performance për vitin 2017

Në vazhdim po shprehim disa rekomandime;

Rekomandime

Enti Rregullator i Energjisë në bazë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, është rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor. Ndryshimet në kuadrin ligjor janë reflektuar edhe në kuadrin rregullator nëpërmjet hartimit të akteve nënligjore të nevojshme, duke mbajtur parasysh që këto akte të jenë në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Europian në fushën e energjisë, për të bërë të mundur krijimin e një tregu konkurrues, eficient, që rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në vend dhe e integron atë në tregun rajonal. Për këtë qëllim ERE ka vendosur një bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë, Minsitrinë Përgjegjëse për Energjinë, dhe Autoritetin e Konkurrencës lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator në sektorin e energjisë, si dhe për çështje të tjera të rëndësishme të këtij sektori.

Mbrojtja e konsumatorëve përbën një aspekt shumë të rëndësishëm të punës së Entit Rregullator të Energjisë jo vetëm në drejtim të trajtimit të ankesave të konsumatorëve por edhe në kuadër të sigurimit të shërbimeve që lidhen me furnizimin e klientëve Universal me çmime të drejta që reflektojnë kostot në sistem.

Çertifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, në kuadër të vendimmarrjeve të ERE-s, shënon gjithashtu një proces me mjaft rëndësi në kuadrin rregullator, por mbi të gjitha në implementimin e kërkesave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Duke konsideruar zhvillimet e tregut të energjisë dhe rëndësinë e implementimit të ligjeve 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, veprimtaria e ERE-s në vijim duhet të fokusohet në mënyrë të vecantë në drejtim të:

- Miratimit të tarifave të reja duke i kushtuar vëmendje të veçantë, nga njëra anë, mbrojtjes së konsumatorëve për tarifa dhe çmime sa më të drejta e të përballueshme dhe nga ana tjetër, rritjes së cilësisë së shërbimit dhe performancës së kompanive.
- Nxitja e krijimit të një tregu të brendshëm dhe hapjen efektive të tregut për të gjithë klientët dhe furnizuesit, në veçanti, në kuadër të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, duke siguruar shërbime të drejta, të sigurt dhe të argumentuara për klientët dhe përdoruesit e sistemit energjetik në vend, si dhe mbështetja e investime strategjike dhe teknologjike, të cilat rrisin konkurrencën dhe përmirësojnë nivelin e shërbimeve në tregun e energjisë elektrike.
- Në funksion të plotësisë të kuadrit rregullator përkatës të ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, bashkëpunimi me të gjithë aktorët, e tregut të energjisë në procesin e hartimit të akteve nënligjore është një element shumë i rëndësishëm në kuadër të krijimit të kushteve të nevojshme për nxitjen e investimeve për prodhimin e energjisë, jo vetëm nga burimet hidrike, por edhe nga burime të tjera si era, dielli, biomasa etj., duke bërë kështu të mundur rritjen e diversifikimit të burimeve të

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

34

Enti Rregullator i Energjisë**Auditim Performance për vitin 2017**

energjisë, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji në vend, si dhe uljen e shkallës së lartë të riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

- *Në kuadër të ushtrimit të kompetencave lidhur me miratimin e planit të investimeve të Operatorëve të rritjes një vëmendje të veçantë duhet ti kushtohet rritjes së investimeve, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së furnizimit të konsumatorit me energji elektrike.*
- *Në vijim të punës për mbrojtjen e konsumatorit është me mjaft rëndësi hartimi dhe përmirësimi i një sërë aktesh nënligjore të sektorit të mbrojtjes së konsumatorit, të cilat në funksion të ligjit të ri të sektorit, i pajisin palët e interesit me të drejta të plotësuar, por edhe i vendosin përpara detyrimeve të reja.*
- *Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve tekniko ekonomik në mënyrë të veçantë të OSHEE sh.a, i ecurisë së arkëtimeve, dhe humbjeve është një element i rëndësishëm duke konsideruar ndikimin e drejtpërdrejtë në performancën e kompanisë, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe shlyerjen e pagesave ndaj palëve të treta, Monitorimi në vijim i treguesve tekniko ekonomik të shoqërive të ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik (OST KESH dhe OSHEE) si edhe Monitorimi i zbatimit të planit të Investimeve (OST, OSHEE).*
- *Bashkëpunimi me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë si në kuadër të projektit TAP, ashtu edhe për të përfituar nga eksperiencia e rregullatoreve rajonale në sektorin e gazit natyror dhe sektorin e shpërndarjes duhet të jete një nga objektivat në vijim të veprimtarisë së ERE-s.*
- *Monitorimi i Albagazit, të certifikuar si operator i transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror përbën një hap tjetër të rëndësishëm për plotësimin e kuadrit të legjislacionit sekondar, në përputhje me direktivat dhe rregulloret përkatëse të BE-së.*
- *Përsa i takon procesit të protokollimit dhe arkivimit të korrespondencës së institucionit, duke parë edhe zhvillimet teknologjike rekomandojmë dixhitalizimin e gjithë procesit të protokoll arkives si një element që do të ndihmonte në rritjen e efikasitetit të këtij institucioni.*
- *Duke patur parasysh rëndësinë dhe zhvillimet e sektorit të energjisë, në mënyrë që ERE të zhvillohet si një institucion i pavarur me kapacitete të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme për të përballur sfidat e sektorit është e rëndësishme shtimi i kapaciteteve në strukturën e ERE, si dhe forcimi i profesionalizmit dhe pavarësisë operationale të stafit të entit (nisur nga zgjerimi i tregut me gazin e lengshëm dhe prodhimit të energjisë me burime të tjera jo hidrike).*
- *Duke konsideruar nenin 107- Gjohat dhe Penalitet të rëndësishëm për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin sugjerojmë zbatimin e tij në rastet e mosrespektimit të ligjit.*

**Grupi i Audituesve Ligjore**

Ludmilla PALUKA

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr. 55

Aida MALOKU

35